

1 E hënë, 13 janar 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Mirë se keni ardhur të gjithë. Shpresoj që të keni
13 pushuar gjatë pushimeve të dimrit.

14 Për procesverbal, dëshiroj të them që të akuzuarit janë
15 të gjithë të pranishëm sot.

16 Përpara sesa të fillojmë me dëshmitarin e ditës së sotme,
17 ka disa çështje paraprake që do të trajtojmë.

18 Së pari, Trupi Gjykses do të nxjerrë vendimin mbi
19 kërkesën e Mbrojtjes së Veselit, Selimit dhe Krasniqit për
20 autorizim për apelimin e vendimit të Trupit Gjykses që është
21 F02787.

22 Më 16 dhjetor 2024, Trupi Gjykses nxori vendimin e vet
23 për mocionin e Prokurorisë për pranimin e dëshmisë së
24 Dëshmitarit 04826, 04874 dhe 04875 në pajtim me rregullat 138,
25 149 dhe 154 dhe kërkesat lidhur me to. Vendimi mori numrin e

1 parashtrimit të protokolluar F2787 dhe do të përmendet, do të
2 referohet si vendimi përkatës.

3 Më datë 20 dhjetori 2024, Mbrojtjet e Veselit, Selimit
4 dhe Krasniqit kërkuan autorizim për apelim të vendimit në
5 fjalë në parashtrimin F02812.

6 Më 8 janar 2025, Prokuroria u përgjigj duke parashtruar
7 protokollimin F02819.

8 Ndërsa Ekipet e Mbrojtjes nuk u përgjigjën.

9 Mbrojtja parashtron një çështje për autorizim,
10 përkatësisht, që Trupi Gjykues ka gabuar në konstatimin e vet
11 që asgjë në kuadrin ligjor të Dhomave të Specializuar apo në
12 Urdhrin për Zhvillimin e Procedurave i ndalon seancat
13 përgatitore me dëshmitarët ekspertë ose parandalon palën
14 thirrëse që të nxjerrë opinione eksperte nga dëshmitarët
15 ekspertë lidhur me dokumentet të cilat nuk janë komentuar në
16 raportin përkatës të ekspertit.

17 Mbrojtja argumenton që çështja e paraqitur përmbush
18 testin për certifikim ose autorizim sepse: së pari, ajo rrjedh
19 nga vendimi në fjalë, është mjaftueshëm specifike dhe e
20 identifikueshme dhe nuk çon në mospajtueshmëri; së dyti, ajo
21 ka ndikim mbi zhvillimin e drejtë të procedurave dhe
22 zhvillimin me shpejtësi të procedurave dhe rezultatin e Trupit
23 Gjykues dhe; së treti, zgjidhja e menjëhershme nga Gjykata e
24 Apelit mund të çojë përpara materialisht këtë proces gjyqësor.

25 Mbrojtja më tej parashtron që ZPS-ja synon që pyesë

1 dëshmitarin për të komentuar mbi seancat përgatitore mbi
2 çështje të reja të cilat kanë dalë që janë çështje shtesë dhe
3 nuk kanë lidhje me raportet fillestare të dëshmitarëve. Sipas
4 Mbrojtjes, kjo do të çonte në krijimin e deklaratave shtesë të
5 dëshmitarëve ose "raportime" të cilat shkojnë përtej asaj që
6 është thënë në shënimet përgatitore, të cilat nuk duhet që të
7 pranohen sipas rregullit 149.

8 ZPS-ja përgjigjet se kjo çështje e ngritur nga Mbrojtja
9 nuk është konkrete, nuk është diskrete dhe e identifikueshme.
10 ZPS-ja më tej argumenton që çështja në fjalë nuk ka ndikim mbi
11 autorizimin për justifikimin e tij. E për pasojë ZPS-ja
12 parashtron që kërkesa duhet të hidhet poshtë.

13 Trupi Gjykses kujton dhe po ashtu i referohet ligjit të
14 zbatueshëm sa i takon standardit juridik për apelim, siç
15 parashikohet në pjesët përkatëse të vendimeve të tij.

16 Trupi Gjykses vëren, se në vendimin në fjalë ka
17 konstatuar që rregulli 149 është *lex specialis* për pranimin e
18 raporteve të ekspertëve. Trupi Gjykses gjithashtu ka
19 konstatuar, se në përputhje me praktikën përkatëse dhe
20 jurisprudencën përkatëse, asgjë në kornizën ligjore të Dhomave
21 të Specializuara të Kosovës ose në Urdhrin për Zhvillimin e
22 Procedurave parandalon palën thirrëse nga nxjerrja e mendimit
23 ose opinionit ekspert ose dëshmitarëve ekspertë ose
24 dokumenteve të cilat janë komentuar prej tyre në raporte të
25 mëhershme të ekspertëve. Trupi Gjykses më tej konstaton se,

1 siç edhe në rastin e dëshmitarëve, qëllimi i seancave
2 përgatitore është kryesisht që të ndihmojë për përgatitjen e
3 dëshmitarëve për të dhënë dëshmi dhe për të vlerësuar aftësinë
4 e dëshmitarit në fjalë për të dhënë dëshmi relevante dhe të
5 besueshme sa i takon fakteve dhe rrethanave përkatëse
6 çështjes.

7 Trupi Gjykses konstaton, gjithashtu, që çështja e ngritur
8 për autorizim, nuk nxjerr asgjë të re, në të kundërtën
9 Mbrojtja thjesht përsërit kundërshtimet e saj të mëparshme sa
10 i takon kundërshtimit të seancave përgatitore me dëshmitarët
11 si dhe argumente të pashtuara në përgjigjet në mocionin e
12 ZPS-së, siç shpjegohet nga Trupi Gjykses.

13 Trupi Gjykses, për pasojë, konstaton se çështja e ngritur
14 nga Mbrojtja është thjesht një mospajtueshmëri dhe asgjë
15 tjetër dhe nuk ka të bëjë fare me konstatimet e Trupit
16 Gjykses.

17 Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk
18 ka vërtetuar se çështja në fjalë përbën një temë diskrete ose
19 të veçantë e cila ka dalë nga vendimi në fjalë.

20 Për rrjedhojë, kërkesat për autorizim ose për testin për
21 autorizim të cilat përcaktohen në nenin 45(2) dhe rregullën
22 77(2) nuk janë trajtuar. Mbrojtja kërkon autorizimin për
23 apelimin e F2812 dhe si rezultat kjo kërkesë rrëzohet.

24 Tani dua që t'i kërkoj ZPS-së në qoftë se ju dëshironi që
25 t'i përgjigjeni këtij mocioni?

1 Z. PACE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Dhe
2 dëshirojmë që të jemi në seancë të hapur për këtë.

3 Mbrojtja mund dhe duhet të kishte ngritur kundërshtimet
4 të cilat kanë të bëjnë me relevancën e Dëshmitarit 04500
5 përpara sesa të ishte nxjerrë ose të ishte parashtruar
6 parashtrimi i protokolluar F08216, që e ka konstatuar që
7 deklarata sipas rregullës 144 është e pranueshme.

8 Më 2 janar 2025, Mbrojtja e Veselit tha që nuk
9 kundërshton mocionin e ZPS-së për të pranuar deklaratën e
10 Dëshmitarit 04500 sipas rregullës 154, duke përfshirë këtu dhe
11 pjesëzat që janë kundërshtuar nga Mbrojtja e Veselit.

12 Në çdo rast, provat e kundërshtuara nuk duhen të
13 përjashtohen nga deklarata e Dëshmitarit 04500 sepse ato janë
14 relevante për akuzat e ngritura në Aktakuzë, përbëjnë pjesët
15 përbërëse të dëshmisë së Dëshmitarit 04500 dhe kanë vlerë
16 provuese dhe nuk zhbëjnë efektet paragjyquese. Gjatë kësaj
17 kohe deklarata e rregullës 154 përtej periudhës së Aktakuzës,
18 është relevante sipas parashtrimeve tona sepse dëshmon
19 marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të identifikuar të UÇK-së,
20 veprimeve të tyre sa i takon marrëdhëniet me viktimave dhe
21 krimeve të cilat janë të akuzuara në Aktakuzë, si dhe
22 përpjekjeve përpara të frikësuar dhe për të diskretituar
23 dëshmitarë.

24 Për pasojë, dëshmia është një dëshmi e cila përcakton
25 faktet dhe rrethanat të cilat ngrihen në Aktakuzë, duke

1 përfshirë këtu edhe ofrimin e kontekstit dhe krijimin e
2 synimit dhe të modelit të sjelljes së të akuzuarve. Kjo është
3 në pajtim me vendimin e mëparshëm të dëshmitarit, për
4 shembull, me parashtrimin F01700, paragrafi 43.

5 Trupi Gjykses më herët ka konstatuar që dëshmia relevante
6 dhe provat provuese është e pranueshme dhe mund të
7 përjashtohet vetëm atëherë kur demonstrohet padrejtësi e
8 lidhur me vlerën e dëshmisë si, për shembull, paaftësia për të
9 kundërshtuar në mënyrë efektive dhe në mënyrë të drejtë. Dhe
10 këtu më konkretisht po i referohem parashtrimin F01623,
11 paragrafi 36. Mbrojtja e Veselit nuk ka demonstruar që
12 ekziston një padrejtësi.

13 Pjesa e mocionit të Veselit që pretendon paragjykim dhe
14 cenim përqendrohet tek pjesët e kufizuara të kundërshtuara të
15 dëshmisë së këtij dëshmitari, përkatësisht, identifikimit të
16 personave të caktuar si anëtarë të SHIK-ut. Mbrojtja pretendon
17 që identifikimi është spekulativ. Megjithatë, së pari,
18 Mbrojtja shpjegon se kjo bazë e njohurive në marrëdhënie me
19 personin diskuton dëshminë e kundërshtuar, kështu që
20 identifikimi i tij nuk është i karakterizuar dhe nuk është i
21 përshkruar drejt si spekulativ. Edhe po të ishte kështu në
22 fakt rasti, Trupi Gjykses në mënyrë të përsëritur ka
23 konstatuar se spekulimi nuk është arsye në vetvete për të
24 përjashtuar dëshminë sipas rregullës 154. Dhe për këtë arsye,
25 në qoftë se Mbrojtja e Veselit dëshiron që të bëjë pyetje dhe

1 dëshiron që të sqarojë çështjet përkatëse, mund t'ia bëjë ato
2 kur të vijë dëshmitari.

3 Mbrojtja e Veselit a ka ndonjë gjë për të thënë?

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dëshiroj që të
5 dëgjojmë një herë Mbrojtësin e Viktimave pastaj do shprehemi
6 ne.

7 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në
8 seancë private në mënyrë të tillë që të diskutojmë një tjetër
9 element që ka të bëjë me interesat që ne mbrojmë, pra, me
10 interesat e viktimave në këtë lëndë gjyqësore.

11 [Seancë private]

12 [Seancë private teksti i fshirë]

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,
16 të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
18 vazhdoni, Avokate.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Së pari, sa i takon parashtimeve
20 të ZPS-së konkretisht që argumentet duhet që të ishin ngritur
21 në kundërpërgjigjen e Mbrojtjes sipas aplikimit për rregullën
22 154. Ndërkohë që kjo është korrekte, pra, për aq kohë sa që
23 mosngritja e çështjes në fazën e procedurës, sigurisht, ky
24 është një element që duhet të respektohet, por nga ana tjetër
25 kemi të bëjmë me një përpara e cila është relevante. Dhe për

1 këtë arsye mund të ngrihet në çdo moment të procedurës.

2 Në parashtrimin tonë, kjo dëshmi e këtij dëshmitari është
3 e papranueshme, argumentet janë të papranueshme dhe sipas nesh
4 këto janë element të cilët mund të trajtohen në këtë pjesë ose
5 në këtë pikë të procesit gjyqësor.

6 Së dyti, sa i takon argumentit që kjo është një pjesë e
7 pandashme e dëshmisë së dëshmitarit. Ne parashtrojmë, të
8 nderuar Gjykatës, që qëndrimi është thjesht, qëndrimi ynë
9 është thjesht i kundërt me atë se çfarë tha Prokuroria. Ky
10 dëshmitar jep dy dëshmi qartazi të ndryshme nga njëra-tjetra
11 në intervistën e ZPS-së. Në një aspekt ose në një dëshmi ai i
12 referohet incidentit që ka ndodhur gjatë konfliktit dhe në
13 dëshminë tjetër, një pjesë e dëshmisë së tij ka të bëjë me
14 incidentit i cili ka ndodhur pas konfliktit. Është incidenti
15 që ka ndodhur pasi ka ndodhur konflikti dhe neve parashtrojmë
16 që kjo është diçka komplet e ndryshme dhe është një deklaratë
17 e cila nuk duhet të pranohet.

18 Të nderuar Gjykatës, në parashtrimet e shkruara të cilat
19 trajtojnë testin ose aspektet ligjore sa i takon dëshmive që
20 bien jashtë objektit kohor të Aktakuzës, ne themi që kjo pjesë
21 e dëshmisë, pra, pjesa e dytë e dëshmisë së dëshmitarit shkon
22 përtej kohës së përcaktuar në Aktakuzë për të akuzuarin. Pika
23 nistore është ligji dhe në ligj përcaktohet sesi do bëhet
24 zbatimi i paragrafit 12 dhe qëndrimi automatik është që dëshmi
25 që shkojnë përtej kuadrit kohor të Aktakuzës duhet të jenë të

1 papranueshme me përjashtim të rasteve kur Prokuroria tregon që
2 përmbushen kushtet ose kriteret për pranueshmërinë.

3 Pra, në këtë aspekt, barra e provës i takon Prokurorisë
4 dhe Prokuroria nuk ka dëshmuar që janë përmbushur kriteret për
5 pranueshmërinë për pjesën e dytë të dëshmitarit. Qëndrimi ynë
6 është që Prokuroria nuk e ka bërë detyrën e vet sa i takon
7 përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë për pjesën e dytë
8 të dëshmisë së dëshmitarit.

9 Ne thjesht kemi një konstatim të vagullt që ka një lidhje
10 me Aktakuzën, pra, pjesa e dytë e dëshmisë së dëshmitarit ka
11 lidhje me Aktakuzën. Megjithatë nuk është thënë se cila është
12 kjo lidhje konkretisht.

13 Po ashtu, sigurisht, që ka cenim të identifikueshëm që do
14 të shkaktohej në qoftë se ju do të vendosni që të pranohej e
15 gjithë dëshmia e dëshmitarit sepse do të ngrihej paragjykim
16 ndaj dëshmitarëve. Dhe, mbi këtë bazë, ne parashtrojmë që
17 Trupi Gjykses duhet që të shikojë vlerën provuese dhe
18 relevancën e këtij materiali dhe, sipas parashtrimit tonë, as
19 vlera provuese dhe as relevanca nuk janë të pranishëm.

20 Së fundi, më lejoni të them që dëshmitari është
21 spekulativ. Sigurisht, domethënë, dëshmitë spekulative në
22 vetvete nuk mund të përbëjnë bazë për dëshmi për t'u
23 përjashtuar. Por nga ana tjetër, fakti që kjo dëshmi është
24 spekulative është shumë e rëndësishme për të mos u marrë
25 parasysh kërkesa e Prokurorisë.

1 Thelbi i çështjes, sa i takon spekulimit është në qoftë
2 se ata -- e di që jemi në seancë të hapur kështu që do të
3 tregohem e kujdesshme. Megjithatë është e rëndësishme që të
4 konsiderohet që ata persona të cilët kanë qenë përgjegjës për
5 këtë incident kanë punuar për një organizatë, e cila dihet me
6 emër. Ai jep një bazë për identifikimin e personave. Kjo është
7 e saktë. Megjithatë nuk jepet asnjë bazë njohurish për
8 prezumimin që këta persona i takojnë organizatës së përcaktuar
9 me emër. Ky pretendim është tërësisht spekulativ për këtë
10 arsye.

11 Së fundi, të nderuar Gjykatës, sa i takon aspektit që u
12 ngrit nga kolegja ime, Mbrojtësja e Viktimave. Ndërkohë që
13 mund të ndodhë në një pikë që ne do të vijmë në pjesën e
14 vendimmarrjes prej jush, edhe mendoj që në qoftë se ju do ta
15 pranoni këtë pretendim të Mbrojtëses së Viktimave, ka të bëjë
16 me zhdëmtimin, në qoftë se do të jepet një vendim fajësie. Nuk
17 ka pikë vlere që të dëgjohet dëshmia për këtë pjesë të
18 dëshmisë së dëshmitarit. Pra, ne parashtrojmë që ju nuk duhet
19 që të shqyrtoni pranueshmërinë e dëshmisë në këtë fazë.

20 Dhe, më thonë kolegët që ka një gabim në transkript, në
21 rreshtin 10, në faqen 8, pra, nuk duhet të thuhet që "ne
22 kërkojmë të mos pranohet", por "ne kërkojmë të pranohet". Ju
23 kërkoj ndjesë e thashë gabim. Edhe një herë "ne kërkojmë të
24 mos pranohet", ky është versioni i saktë. Megjithatë, në qoftë
25 se nuk isha e qartë mund të më thoni sepse mund t'jua shpjegoj

1 më tej.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është në
3 rregull, s'ka problem.

4 Ndonjë palë tjetër, ndonjë person tjetër dëshiron të
5 thotë diçka?

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo. Por në parim, neve i
7 mbështesim parashtrimet juridike të cilat u thanë nga znj.
8 Rowan.

9 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe ne bëjmë të njëjtë gjë.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne e mbështesim parashtrimet
11 juridike të bëra nga kolegja.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, të
14 nderuar Gjykatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, patjetër.

16 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Dua që t'ju kujtoj të
17 gjithëve që ne jemi të detyruar që të parashtrojmë deklaratën
18 tona për dëmin në fund të gjykimit, jo gjatë procesit të
19 zhdëmtimit, siç tha kolegja, por në fund fare të gjykimit, kjo
20 është përcaktuar nga procedura.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Pasi dëgjuam palët dhe pjesëmarrësit, Trupi Gjykses do të
23 do të japë një urdhër me gojë sa i takon dëshmisë së
24 Dëshmitarit 04500. Këtë do ta bëjmë përpara sesa të vijë të
25 japë dëshmi ky dëshmitar.

1 Ndërkohë që tani do të vazhdojmë me dëshminë e

2 Dëshmitarit të Prokurorisë 04875.

3 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, dua që t'ju
5 kërkojmë që të na ndihmoni sa i takon përgatitjes gjatë natës
6 për sa i takon këtij dëshmitari, kështu që do ju kërkoja që të
7 mund të na jepni këtë urdhrin me gojë tuajin sa më shpejt të
8 jetë e mundur për çështje përgatitore.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk jua
10 premtoj dot sepse do e kemi ditën shumë të zënë, megjithatë do
11 të shohim se çfarë mund të bëjmë.

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit.

13 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
15 Sekretarja e seancës tani do t'ju japë tekstin e deklaratës
16 solemne që duhet ta lexoni në pajtim me rregullën 149(5). Ju
17 lutem lexojeni me zë.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
19 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
20 solemnisht se do të jap të gjithë dëshminë time prej eksperti
21 me aq sa unë kam njohuri dhe do të jap konstatimet dhe
22 opinionet e mia me saktësi dhe plotësisht.

23 DËSHMITARI: WILLIAM GOODWIN

24 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju faleminderit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
2 ju. Mund të uleni.

3 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj e cila
4 parashikoj që të zgjasë përafërsisht një ditë. Sikurse mund ta
5 dini, Prokuroria do t'ju bëjë e para pyetje, më pas do t'ju
6 bëjë pyetje Mbrojtësi i Viktimave. Dhe pasi të kenë përfunduar
7 këto dy palë, atëherë Ekipet e Mbrojtjes do të kenë mundësinë
8 që t'ju bëjnë pyetje edhe anëtarët e Trupit Gjykses mund t'ju
9 bëjnë pyetje.

10 Prokuroria ka vlerësuar që i duhet një orë për pyetjet
11 tuaja. Ndërkohë që Mbrojtjet kanë vlerësuar që i duhet 4.5 orë
12 për t'ju marrë në pyetje. Si në çdo rast tjetër, neve
13 shpresojmë që palët do të jenë, do të përdorin mirë kohën dhe
14 dua që t'ju informoj gjithashtu që Trupi Gjykses do të lejojë
15 pyetje plotësuese në qoftë se përmbushen kushtet për këtë gjë.

16 Dëshmitar, ju lutem mundohuni që t'i jepni përgjigje
17 qartë dhe me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni një
18 pyetje lirisht mund t'i kërkonit avokatit përkatës që ta
19 shpjegojë apo t'jua shtjellojë më mirë pyetjen.

20 Po ashtu, ju lutem na thoni se cila është baza e
21 njohurive dhe rrethanave për të cilat juve do pyeteni. Në rast
22 se ZPS-ja do ju kërkojë që të bëni disa korigjime të bëra në
23 deklaratat e mëhershme tuajat, ju kujtojmë që ju duhet të
24 thoni për procesverbal dhe për të gjitha palët, që deklaratat
25 tuaja, së bashku me korigjimet, pasqyrojnë saktësisht

1 deklaratën e dëshmitarit.

2 Ju lutem dëgjojini me kujdes pyetjet, bëni një pauzë prej
3 pesë sekondash në mënyrë të tillë që t'i lini kohë të
4 mjaftueshme përkthyesve për t'ju ndjekur.

5 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi përpara Trupit Gjykues,
6 nuk lejohet që të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë
7 suaj jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se ndokush vjen për
8 t'ju bërë pyetje lidhur me atë çfarë ju do të thoni përpara
9 Trupit Gjykues, duhet të na njoftoni menjëherë lidhur me këtë.

10 Ju lutem mos flisni më në qoftë se ju kërkoj të mos
11 flisni më, gjithashtu mos flisni më në qoftë se më shihni që
12 ngre dorën. Kjo do të thotë që unë duhet t'ju jap disa
13 udhëzime.

14 Nëse e ndjeni të nevojshme për të bërë një pushim, ju
15 lutem na e thoni këtë gjë dhe ne do të bëjmë organizimet e
16 nevojshme.

17 Për ta ditur, duhet t'ju them që do të bëjmë rreth dhjetë
18 minuta në orën 10.00 dhe prej orës 10.10 do të vazhdojmë deri
19 në orën 11.00. Në orën 11.00 kemi 30 minuta pushim dhe pas
20 orës 11.30 do të vazhdojmë në orën 1.00. Nga ora 1.00 deri në
21 orën 2.30 kemi pushimin e drekës dhe në qoftë se do jetë e
22 nevojshme do të vazhdojmë nga ora 2.30 deri në orën 4.30.

23 A keni ndonjë pyetje lidhur me sqarimet që ju dhashë,
24 Dëshmitar?

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo, nuk kam.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Do të fillojmë me pyetjet e Prokurorit. Ju lutem
3 dëgjojeni me vëmendje Prokurorin. Prokuroria është e ulur në
4 të majtën tuaj.

5 Mund të vazhdoni, z. Pace.

6 Pyetje nga z. Pace:

7 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

8 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

9 PË. Mirëmëngjes.

10 PY. Jemi takuar dhe më herët, po dua që të prezantohemi
11 përsëri për procesverbal. Unë jam James Pace, që jam prokuror
12 me Prokurorinë. Dhe unë do t'ju bëj pyetje gjatë orës në
13 vijim.

14 Ju lutem më thoni si quheni?

15 PË. Unë quhem William Holger Goodwin.

16 PY. Kur keni lindur?

17 PË. Kam lindur më datë 25 maj 1969.

18 Z. PACE: [Përkthim] Do ju kërkoja Sekretarisë që të
19 tregoni në ekran disa dokumente dhe dua t'ju them që ato nuk
20 duhet të transmetohen për publikun.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
22 përsërisni edhe një herë numrin?

23 Z. PACE: [Përkthim] Po. Është dokumenti 103392-103400. Ju
24 lutem ta paraqisni në ekran këtë dokument dhe është dokumenti
25 i ekspertit, i dëshmitarit ekspert.

1 PY. A e shikoni një dokument përpara në ekran, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. A është biografia juaj kjo?

4 PË. Po.

5 PY. Përmbajtja a është e saktë, mesa dini ju?

6 PË. Përmbajtja në përgjithësi është e saktë. Ka disa probleme
7 të vogla, ndryshime të vogla në biografi të cilën unë i kam
8 bërë dy ose tre vite më përpara, megjithatë hollësitë në
9 përgjithësi janë të sakta.

10 PY. A keni ndonjë gjë për të shtuar lidhur me këtë?

11 PË. Jo, nuk është se ka ndonjë gjë me rëndësi për të shtuar.

12 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne kërkojmë që
13 të pranohet biografia e dëshmitarit në pajtim me vendimin
14 F02787, ju keni, ju vendosni për sa i takon pranimit të
15 raporteve të ekspertëve pasi të jenë shtjelluar, pra, pasi të
16 jenë trajtuar pyetjet nga palët, ne mund të merremi me
17 pranimin e dokumenteve të tjera më vonë, megjithatë do të doja
18 që t'ju kërkoja që të caktoni një numër provizor prove për
19 momentin.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, ju
21 lutem caktojini një numër provizor.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, në rregull.

23 Dokumenti do të marrë numrin provizor P01950. Aktualisht
24 dokumenti klasifikohet si konfidencial.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Mund të vazhdoni.

2 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

3 Dhe në vend të tij do të kërkoja që të paraqisni dokumentin

4 103373-103387.

5 PY. Ndërkohë që shfaqet dokumenti, Dëshmitar, dua t'ju them

6 që në këtë sallë gjyqi jemi në një situatë jo shumë të

7 zakontë, domethënë, ne të dy flasim dhe komunikojmë me njëri-

8 tjetrin në anglisht, kështu që do ju kërkoja që të bënit një

9 pauzë të respektojmë njëri-tjetrin ndërkohë që flasim në

10 mënyrë të tillë që të kapet nga përkthyesit gjithçka që ne

11 themi.

12 Dëshmitar, në ekran përpara keni në shqip, domethënë,

13 dokumenti në shqip është në të majtë ndërkohë që në anglisht

14 është në të djathtë, a e shikoni këtë dokument?

15 PË. Po.

16 PY. A e keni përgatitur ju këtë raport të datës 22 shtator

17 2021?

18 PË. Po, unë e kam përgatitur.

19 Z. PACE: [Përkthim] Le t'i mbajmë raportet në ekran në

20 anglisht, ndërkohë që hiqni nga ekrani dokumentin në shqip dhe

21 në vend të dokumentit në shqip do ju kërkoja që të paraqisni

22 dokumentin 102472-102482.

23 PY. Në të majtë në ekran ne lexojmë që është një letër

24 udhëzimesh, letër udhëzimesh që mban datën 30 korrik 2021. A

25 është kjo letra e udhëzimeve mbështetur në të cilën ju keni

1 përgatitur raportin që është në të djathtë të ekranit,

2 Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. A ju kujtohet që ju janë dhënë disa dokumente së bashku
5 me këtë letër udhëzimesh?

6 PË. Po.

7 PY. A është e saktë që kjo letër udhëzimesh përfshin çështje
8 të përgjithshme që kanë të bëjnë me ADN-në, po gjithashtu edhe
9 pyetje specifike apo konkrete në lidhje me dokumente që ju
10 kemi dhënë përveç kësaj letra udhëzimesh?

11 PË. Po.

12 PY. A ju kujtohet që keni rishikuar dokumentin që ju kemi
13 dhënë së bashku me letrën e udhëzimit dhe që keni bërë shënime
14 konkrete në këtë dokument?

15 PË. Po.

16 PY. Raporti i ekspertit që kemi në ekran a përfshin opinionin
17 e pavarur tuajin lidhur me çështjet dhe pyetjet të cilat ju
18 kemi parashtruar ne?

19 PË. Po.

20 PY. A ju kujtohet që kohët e fundit ju është dhënë mundësia
21 që të rishikoni dhe të jepni sqarime apo korrigjime në qoftë
22 se kishit lidhur me raportin e ekspertit që kemi përpara në
23 ekran?

24 PË. Po, më kujtohet.

25 PY. A ju kujtohet që keni bërë disa sqarime lidhur me këtë

1 raport?

2 PË. Po, më kujtohet.

3 PY. A ju kujtohet që këto sqarime dhe këto shpjegime janë
4 përfshirë në një shënim të cilin më pas jua kemi lexuar?

5 PË. Po, më kujtohet.

6 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim letrën e udhëzimeve, në
7 të majtë të dokumentit. Dhe në raport, që është në të djathtë
8 të raportit, pra, të ekspertit, do i kërkoja Sekretares që të
9 kalojmë tek faqja 103379 dhe do ju kërkoja që ta zmadhoni
10 paragrafin në të majtë të tekstit kryesor.

11 PY. Dhe tani do lexoj paragrafin e fundit që mund ta shikoni
12 dhe në ekran. Ku lexon si në vijim:

13 "Kam bërë një llogaritje dhe kam bërë një vlerësim të
14 gjasave të rastit të gjasave që mund të jetë 216,411 kur
15 kombinohet me mundësinë paraprake të shkallës 1/3000 që jep
16 një mundësi të lidhjes familjare siç është përshkruar në
17 raport në nivelin 98.63 për qind. Do të thoja që duke izoluar
18 këtë, kjo është dëshmi e dobët e identifikimit."

19 Tani Dëshmitar, a ka diçka që dëshironi të korrigjoni apo
20 të qartësoni lidhur me këtë?

21 PË. Bazuar në diskutimin tonë dhe rishikimin e saj, termi "i
22 dobët", pra, "shumë i dobët" mund të rishikohet dhe të quhet
23 si "i moderuar".

24 PY. A mund t'ia shpjegoni Gjykatësve, shkurtimisht, se çfarë
25 do të thotë kjo kur thoni "i dobët" dhe ta ndryshoni si "i

1 moderuar”?

2 PË. Kjo është çështje vlerësimi, gjykimi, bazohet në
3 renditjen, për aq sa është e mundur, të mundësisë, shkallës së
4 mundësisë që është dhënë nga rrjeti i mjekësisë mjeko-ligjore,
5 instituteve të mjekësisë, rrjeti i Instituteve të Mjekësisë
6 Mjeko-ligjore Evropiane dhe, domethënë, kjo është më shumë e
7 moderuar sesa e dobët.

8 PY. Në të njëjtën pyetje në të njëjtën faqe, do t’i referohem
9 poshtëshënimit 7 në fund të faqes, fjalia e parafundit në këtë
10 shënim lexon:

11 “Nuk është bërë ndonjë ndryshim apo korrigjim sa i përket
12 nënstrukturës së popullsisë.”

13 Dëshmitar, ka diçka që dëshironi të korrigjoni lidhur me
14 këtë pjesë të veçantë?

15 PË. Kur bëhen llogaritjet kanë një numër supozimesh të
16 caktuara që përfshihen në përllogaritjen e bërë. Dhe kur bëhet
17 kjo punë, e kam bërë aq afër sa është e mundur me atë që kam
18 menduar se ishin llogaritjet fillestare të bëra. Nuk di
19 saktësisht se si e kanë bërë ata në atë kohë, por unë besoj që
20 e kam përdorur nënstrukturën e popullsisë në atë kohë. Jam i
21 sigurtë që e kemi -- do të diskutojmë këtë pjesë gjatë ditës
22 së sotme, por në llogaritjet, përllogaritjen e tanishme që
23 kemi tani të nënstrukturës këto nuk janë përdorur.

24 PY. Dhe faktori i nënstrukturës së popullsisë në përgjithësi
25 çfarë ndikimi ka në rezultate?

1 PË. Përfshirja e nënstrukturës së popullsisë të redukton,
2 zvogëlon, pra, mundësinë, gjasat e mundshme dhe për rrjedhojë
3 edhe mundësinë, probabilitetin e identitetit.

4 PY. Ky zvogëlim i racës dhe i probabilitetit në përgjithësi
5 është zvogëlimi domethënës i rëndësishëm i madh apo jo?

6 PË. Kjo varet pjesërisht në pjesët, në copëzat e ADN-së që
7 janë bashkëndarë. Ndikimi është më i madh në pjesët e ADN-së
8 që janë të rralla brenda popullsisë dhe më pak në ato pjesë të
9 ADN-së që janë më të zakonshme, të përgjithshme brenda një
10 popullsie të caktuar.

11 Si rregull i përgjithshëm ka udhëzimet e përgjithshme,
12 pra, nënstruktura e popullsisë zvogëlohet, mendoj, në 216.000
13 sipas rendit 10 në 20. Në këtë rast përfshirja e nënstrukturës
14 së popullsisë e zvogëlon këtë vlerë të caktuar në 15.000, që
15 është qartësisht shumë më e ulët.

16 PY. Sipas përvojës suaj, ky korrigjim për nënstrukturën e
17 popullsisë në përgjithësi është i përfshirë në raportet e
18 identifikimit?

19 PË. Në përgjithësi, kur bëhet identifikimi, kur bëhen
20 raportet e identifikimit përfshirja e nënstrukturës nuk është
21 që zbatohet në mënyrë të rregullt. Varet shumë nga laboratorit,
22 rrethanat dhe puna e zhvilluar.

23 Z. PACE: [Përkthim] Në të njëjtin raport, kalojmë në
24 faqen 103384. Dhe aty do shohim nëntitullin e fundit dhe
25 paragrafin.

1 PY. Këtu shohim, ai që është kodi, shohim kodin për
2 dokumentin tonë ERN dhe përshkruhet që raporti i ADN-së për
3 personin që e kemi në ekran. Jemi në seancë të hapur. Dhe nuk
4 do ta lexojmë emrin e personit në fjalë. Në raportin tuaj
5 thuhet:

6 "Profili i ADN-së është i kriptuar që e kufizon mundësinë
7 për rishikim të plotë. Megjithatë, bazuar në pjesëtarët e
8 familjes që janë të disponueshëm dhe lokocitet që përputhen,
9 gjasat e përputhjes dhe probabiliteti i identitetit duken të
10 arsyeshme."

11 Pyetja ime është a dëshironi të ndryshoni apo korrigjoni
12 diçka në këtë pjesë?

13 PË. Pa informacione të tjera shtesë, nuk kam asgjë për të
14 ndryshuar në këtë pjesë.

15 PY. Ju kujtohet kur jemi takuar javën e kaluar keni përmendur
16 një letër, një raport që bazohet në simulime dhe ku pasqyronte
17 gjasa tipike të ndryshme?

18 PË. Po, më kujtohet.

19 PY. Dhe bazuar në informacionin në këtë raport që këto
20 simulime ju ndihmojnë që të pohoni, të jepni pohimet e tuaja
21 lidhur me pjesëtarët e familjes që janë të disponueshme dhe që
22 përputhen me të dhënat e tyre?

23 PË. Po.

24 PY. Në çfarë mënyre ju ndihmon kjo?

25 PË. Duke bërë simulimet, ne mund të vlerësojmë gjasat tipike

1 të mundshme që mund të presim të shohim nga të dhënat e
2 familjes, të dhënat e ndryshme të familjes, nga pema e
3 familjes, pra, nuk është një hartë në kuptimin e saktë të saj,
4 por jep një informacion tregues sa i përket gjasave që mund të
5 presim nga testet e ndryshme, pra, rezultatet e ndryshme.
6 PY. Më korrigjoni në qoftë se e kam gabim, por mund të themi,
7 për shembull, që personat e testuar këtu, për shembull,
8 bashkëshortja, djali, vajza e të ndjerit e kanë një gjasë,
9 mundësi, ka diçka, ka një gjasë të caktuar që pritet nga ata,
10 pra, a është kjo ajo që po thoni?

11 PË. Po. Presim një gamë të caktuar të gjasave të përputhjes
12 me të afërmit të cilët janë -- mbi të cilët janë bërë teste.

13 Z. PACE: [Përkthim] Tani mund ta heqim këtë raport nga
14 ekрани. Dhe do të doja që të shfaqim dokumentin 111160 deri në
15 111162 dhe të shohim faqen e parë, ju lutem. Faleminderit.
16 Kalojmë në faqen e fundit, ju lutem.

17 PY. Dëshmitar, e shihni që është një raport ndryshe nga ai
18 për të cilin folëm deri tani. A e keni përgatitur ju raportin
19 e 6 marsit 2023?

20 PË. Po.

21 PY. A e keni përgatitur këtë raport pas marrjes së letrës së
22 udhëzimeve nga ZPS-ja?

23 PË. Po.

24 Z. PACE: [Përkthim] Tani mund ta heqim versionin në shqip
25 dhe mbajmë versionin anglisht dhe të shfaqim në ekran

- 1 gjithashtu krahas tij dokumentin 111165 deri në 111169.
- 2 PY. Këtu shohim në anën e majtë të ekranit është letra e
3 udhëzimeve që ju është drejtuar juve më datë 15 shkurt 2023.
4 Dhe mbi këtë bazë ju keni përgatitur raportin që është në anën
5 e djathtë të ekranit?
- 6 PË. E saktë.
- 7 PY. Ju kujtohet që ju janë dorëzuar juve bashkë me këtë letër
8 të udhëzimeve një sërë dokumentesh?
- 9 PË. Po.
- 10 PY. A është e saktë që kjo letër me udhëzime përmban pyetje
11 konkrete lidhur me një dokument që ka të bëjë me ADN-në dhe
12 raportin e përditësuar?
- 13 PË. E saktë.
- 14 PY. A ju kujtohet që keni rishikuar raportin e përditësuar që
15 ju është dhënë dhe të cilit i jeni referuar në këtë raport të
16 ekspertit?
- 17 PË. Po.
- 18 PY. Raporti i ekspertit tani që kemi në ekran a përmban
19 mendimin tuaj të pavarur lidhur me çështjet që janë trajtuar
20 aty?
- 21 PË. Po.
- 22 PY. A ju kujtohet së fundi që ju është dhënë mundësia të
23 rishikoni këtë raport dhe të jepni qartësime apo të bëni
24 korrigjime dhe keni pohuar që nuk kishit asgjë për të shtuar?
- 25 PË. Po.

1 PY. Përveç korrigjimeve që u diskutuan në raportin paraprak,
2 a janë informacionet që keni dhënë në të dy raportet e
3 ekspertit të sakta dhe të vërteta për aq sa keni dijeni dhe
4 besoni?

5 PË. Po.

6 PY. Përveç, duke pasur parasysh korrigjimet që diskutohen në
7 të raportet, këto raporte a pasqyrojnë në mënyrë të saktë atë
8 që ju do të thonit nëse merreni në pyetje lidhur me këtë?

9 PË. Po.

10 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
11 pranimin e këtyre dy letrave të udhëzimeve dhe raportet e
12 ekspertit. Meqenëse Trupi Gjykses do të marrë vendim mbi
13 pranimin e tyre si në prova më vonë, kërkojmë që t'ju jepet
14 një numër provizor për këto katër dokumente në tërësi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më duhet një
16 numër provizor për dokumentin 103373 deri në 103387 që është
17 raporti i parë i shtatorit 2021.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,
19 raporti do të marrë numrin MFI, numrin provizor P01951.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pastaj letra
21 me udhëzime për këtë raport që është 102472 deri në 102482.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Numri provizor do të
23 jetë P01952. Klasifikimi do të jetë konfidencial për të dy.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pastaj
25 dokumenti 111160 deri në 111162.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin
2 provizor P01953.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pastaj 111165
4 deri në 111169.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin
6 provizor P01954.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
8 Z. Pace, mund të vazhdoni.

9 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Në këtë fazë, ZPS-ja
10 dorëzon si provë materialin burimor që lidhet me këto raporte
11 ekspertësh. ERN-të përkatëse për këtë material burimor janë,
12 gjenden në Shtojcën 1 të shënimit përgatitor të dëshmitarit,
13 që është 124392-124406.

14 Dhe kuptoj që lidhur me këtë Trupi Gjykses do të marrë
15 një vendim për pranimin e tyre si prova më vonë pas dhënies,
16 plotësimit, përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit ekspert. Do
17 të merremi me këtë në fund të marrjes në pyetje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo mjafton
19 për neve përveçse në qoftë se ka ndonjë kundërshtim. Nuk ka
20 kundërshtime.

21 Vazhdoni.

22 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Tani mund të heqim
23 dokumentet që kemi në ekran dhe do të doja të shfaqim në ekran
24 dokumentin U015-4164 deri në U015-4614. Dhe bashkë me këtë
25 dokument do të doja të shfaqim raportin e parë të ekspertit

1 tani, i cili tani mban numrin provizor P01951 dhe të kalojmë
2 në faqen 103378.

3 PY. Dëshmitar, tani në anën e majtë kemi raportin tuaj të
4 ekspertit, të parë, dhe në qoftë se shikoni në krye të faqes
5 kemi numrin e referencës U015 deri në -4164. Dhe për t'ju
6 orientuar, ky është dokumenti që shfaqet në anën e djathtë të
7 ekranit në ekran.

8 Tani do të shkoj pak më poshtë në të njëjtën faqe të
9 raportit tuaj. Në fakt janë dy paragrafët e fundit dhe do të
10 lexoj këtë që ju thoni në raportin tuaj lidhur me dokumentin
11 që është akoma në anën e djathtë tuaj në ekran. Dhe ju thoni
12 si në vijim:

13 "Megjithatë, disa elemente të raportit janë të pazakonta.
14 Profilet e viktimave dhe anëtarëve të familjes janë të koduara
15 dhe kështu që ne nuk mund të shohim cilat lokuse janë testuar
16 dhe as identitetin e aleleve. Si i tillë është -- nuk është e
17 mundur që të rikontrollohen analizat. Kur bëhet përlllogaritja
18 e rracius së gjasave, një bazë të të dhënash referencë do të
19 ishte përdorur për të bërë vlerësimin e domethënies së aleleve
20 të ndara që gjenden të dy palët. Ky informacion nuk është i
21 përfshirë në raport, dhe për rrjedhojë nuk mund të bëj komente
22 lidhur me saktësinë e tij."

23 Dëshmitar, a e kam të drejtë kur kuptoj që informacioni
24 në këtë material, do të thotë që ju nuk ishit -- nuk jeni në
25 gjendje, nuk ishit në gjendje të kontrollit përlllogaritjet e

1 ICMP-së?

2 PË. E saktë.

3 PY. Dhe sipas njohurisë suaj, cila mund të ketë qenë arsyeja
4 apo arsytet për kodimin e profileve që ju përmendët në këtë
5 pjesë?

6 PË. Besoj që mund të jetë për mbrojtjen e të dhënave, që këto
7 profile të mos përdoren për ndonjë arsye tjetër, përveçse për
8 këtë identifikim konkret këtu.

9 PY. Dhe përveç kësaj çështje për të cilën sapo folëm, bazuar
10 në ekspertizën tuaj, a keni ndonjë shqetësim lidhur me
11 saktësinë e raportit që është në anën e djathtë në ekran?

12 PË. Sa i takon analizës apo rezultateve, këto duket të jenë
13 në përputhje me gjasat që priten nga kjo lloj grupimi i
14 familjes.

15 PY. Faleminderit.

16 Z. PACE: [Përkthim] Mund të heqim dokumentin në anën e
17 djathtë dhe të mbajmë raportin këtu, raportin e ekspertit. Dhe
18 do të kërkoj që të shfaqim në ekran ngjitur SPOE0072678-
19 0072750 RED dhe do të kalojmë në faqen që përfundon me 72691.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Thjesht e konfirmojmë
21 Prokurorin është RED, nuk është RED2, por RED.

22 Z. PACE: [Përkthim] RED. Faqja është 72691.

23 Në raportin e ekspertit në anën e majtë të ekranit, që
24 është i njëjti që përmendëm më herët, kalojmë tek faqja,
25 fillimisht kalojmë tek faqja 103881. Dhe në qoftë se mund të

1 zmadhojmë pjesën e fundit të faqes, po.

2 PY. Edhe këtu, Dëshmitar, për t'ju orientuar në anën e majtë
3 të ekranit keni raportin tuaj të ekspertit dhe me shkronja të
4 zeza në fund të dokumentit kemi numrin e referencës të
5 përdorur nga ne, SPOE0072678, ky është dokumenti që është në
6 anën e djathtë të ekranit.

7 Z. PACE: [Përkthim] Tani do të kalojmë në faqen vijuese
8 të raportit të ekspertit ku ju diskutoni këtë dokument.

9 PY. Dhe thoni, kjo është pyetja dhe përgjigja e dytë në
10 ekran, ku lexon si në vijim:

11 "Informacionet në këtë raport a e mbështesin përfundimin
12 e arritur në këtë raport?

13 Përgjigje:

14 "Të dhënat janë për pjesën më të madhe të tyre të
15 kriptuara, nuk është e mundur që të vlerësohen tërësisht
16 përfundimet. Duke supozuar që të njëjtat alele janë kriptuar
17 me të njëjtin kod përfundimi i lidhjes familjare është,
18 përputhet me të dhënat".

19 Dëshmitar, a mund ta shpjegoni çfarë doni të thoni kur
20 thoni: "Po supozojmë që të njëjtat alele janë kriptuar me të
21 njëjtin kod përfundimi i lidhjes familjari është, përputhet me
22 datat"?

23 PË. Po. I njëjti numër është përdorur për të njëjtit alele.
24 Pra, në qoftë se keni të njëjtët alele, i njëjti numër është
25 përdorur në gjithë procesin e kriptimit.

1 PY. Në rregull. Shqyrtojmë dokumentin pak më hollësisht tani.

2 Po i referohem raportit të ADN-së, pra, në anën e djathtë të
3 ekranit.

4 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se mund të zmadhojmë pak
5 tani.

6 PY. Në pjesën e sipërme të majës së këtij dokumenti thuhet,
7 shohim referencën D3S1358? A është kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Pastaj, më poshtë, shohim Alele 1, Alele 2 dhe pastaj
10 07.4, pastaj dhe 08.9, është kështu?

11 PË. E saktë.

12 PY. Fillojmë këtu. A mund të na shpjegoni për çfarë bëhet
13 fjalë kur përmenden këto informacione që sapo përmenda?

14 PË. Së pari, emri D3S1358 është emri i rajonit të ADN-së që
15 është testuar, pra, është një rajon i gjinomës i veçantë dhe
16 një çift përsëritës i shkurtër që është testuar. Ne presim që
17 individi i testuar të ketë dy alele. Një alele është versioni
18 i ADN-së në një vend të caktuar dhe ne -- dhe që e kemi
19 ndryshe dhe në këtë rast, për shembull, 8105426, kemi një
20 alele me kodin 07.4 dhe 08.9. Këto nuk janë emra normal që
21 përdoren për alele dhe për këtë e dinë që janë kriptuar.

22 Por ne presim në këtë rast, kemi një numër të caktuar të
23 afërmish, familjarë, pra, poshtë kësaj, pra, kemi djalin, dy
24 vajzat që është më lehtë të shikohen dhe pritshmëria është që
25 djali dhe vajzat të kenë të paktën një të njërit prej aleleve nga

1 kampioni apo mostra e marrë nga babai.

2 Pra, alelen 1, 07.4, e shohim që gjendet edhe tek djali
3 që është i dyti më poshtë dhe vajza që është e treta më
4 poshtë. Dhe pastaj në qoftë se shohim alelen 08.9, kjo gjendet
5 në vajzën e dytë. Vëllai gjithashtu ka dhe ai të përbashkët
6 08.9. Kjo është -- nuk është kur merremi me binjakë, nuk është
7 gjithmonë kaq e qartë sepse mund të jetë edhe rastësi që të
8 trashëgojmë ADN të ndryshme nga prindërit tanë. Por është më e
9 lehta për të shikuar lidhjen e drejtpërdrejtë qoftë ose prind
10 ose fëmijë dhe mund të presim që njëra prej aleleve të
11 prindërve të gjendet në profilin e fëmijëve.

12 PY. Dhe në fakt deri tani kemi trajtuar alelet e kampionit
13 8105426. Kemi gjithashtu dhe, më korrigjoni në qoftë se
14 gabohem, kodin, të themi për alelet e bashkëshortes?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe personat që ishte bashkëshortja e viktimës dhe kemi
17 numrin 09.5 dhe 09.5 si shënimet e para.

18 Ju e përmendët në përgjigjen tuaj që duhet, mund të
19 presim dhe këtu që alelja e njërit prej prindërve të gjendet
20 në njërin prej fëmijëve.

21 PË. Saktë.

22 PY. Në qoftë se shohim atë të djalit, kemi 07.4 që vjen nga
23 babai. Dhe 09.5 që vjen nga bashkëshortja e cila ka dy kopje
24 të 09.5. Të njëjta vlejné edhe për vajzën e parë dhe vajzën e
25 dytë. Sepse bashkëshortja ka dy alelet që janë të njëjtat dhe

1 të gjithë fëmijët kanë të njëjtën alele.

2 PY. Faleminderit. Mbajmë raportin në anën e majtë. Heqim
3 raportin në anën e djathtë të ekranit që është raporti i ADN-
4 së.

5 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem shfaqni në ekran dokumentin
6 073685 deri në 073786 RED dhe po i referohem tani konkretisht
7 vetëm RED. Në këtë dokument kalojmë në faqen 073700.

8 Faleminderit. Dhe në raportin e ekspertit në anën e majtë,
9 kalojmë në faqen 103384. Dhe në qoftë se mund të shkojmë pak
10 më poshtë në raport. Faleminderit.

11 PY. Edhe këtu, z. Dëshmitar, në qoftë se shohim numrin 1(i)
12 pyetja e parafundit në faqe është referenca me shkronja të
13 zeza, dokumenti jonë pra. Lidhur me këtë pikë të raportit
14 tuaj, ju keni thënë si në vijim:

15 "Duke qenë që pjesa më e madhe e informacionit është e
16 kriptuar apo redaktuar është e vështirë të thuhet nëse
17 përfundimet mbështeten nga informacioni. Është e qartë që
18 profili i paraqitur në raport (P073700) (faqe 16) tregon të
19 dhëna vetëm për shtatë STR që është shembulli i një profili të
20 pjesshëm që nuk është i pazakonshëm kur bëhen analizat e
21 kampionëve të eshtrave.

22 "Megjithatë, mundësia, shkalla e gjasave dhe
23 probabiliteti i ndërlidhjes familjare është jashtëzakonisht e
24 lartë, veçanërisht kur duke qenë se ato bazohen në shtatë
25 loci. Dhe do të rekomandoja një rivlerësim të profileve jo të

1 kriptuara që të bëhen, të vihen në dispozicion.”

2 Pra, Dëshmitar, në anën e djathtë tani të ekranit mund të
3 shihni që këtu bëhet fjalë për redaktimet e Gjykatës, kutitë
4 me ngjyrë të zezë dhe mund të zmadhojmë pak ekranin, mund të
5 shohim që aty kemi kodin me E, në mënyrë që të jeni.

6 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë tani, përveç, në vend të
7 këtij versioni në anën e djathtë të ekranit, do të doja që të
8 shfaqnim dokumentin 073658 deri në 073786 RED2 dhe të kalojmë
9 në të njëjtën faqe që është 073700. Faleminderit.

10 PY. Edhe këtu, Dëshmitar, ajo që shihet në anën e djathtë të
11 ekranit është i njëjti dokument që pamë më parë, i njëjti
12 dokument të cilit i referoheni në raportin tuaj, por këtu
13 është më pak i redaktuar. Dhe, në fakt, këtu kemi mundësi të
14 shohim më shumë informacione. E shihni ndryshimin mes këtij
15 versioni dhe atij që patë më parë?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe në veçanti, në versionin që keni tani në ekran mund
18 të shohim tipet e marrëdhënieve familjare të personave të
19 testuar. Në mes të ekranit shohim nënë, baba, bashkëshorte,
20 vajzë, djalë. A mund të na thoni nëse informacionet shtesë
21 tani që po shihni - pra, siç thashë më herët, nëna, babai,
22 bashkëshortja, vajza, djali - kanë ndonjë ndikim në vlerësimin
23 tuaj, në raportin tuaj?

24 PË. Kanë. Në këtë rast të veçantë kemi të dhëna të plota.

25 Kemi nënën dhe babain të cilët bashkë me personin e zhdukur

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 35

1 mund të rrisin jashtëzakonisht gjasat. Kemi vajzën bashkë me -
2 - për më tepër kemi djalin dhe vajzën bashkë me bashkëshorten.
3 Pra, bashkërisht, mund të presim që secili prej tyre të japë,
4 të nxjerrim gjasa, shkallën e gjasave të lartë për secilin
5 prej tyre.

6 PY. Faleminderit.

7 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje për këtë dëshmitar.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Përpara që të fillojmë, do të marrim, bëjmë një pushim dhjetë
10 minutash meqenëse siç e thashë më herët.

11 Ju lutem shoqërojeni dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit.

12 Do bëjmë dhjetë minuta pushim përpara që të fillojmë.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në qoftë se

15 mund të kontrolloj, të verifikoj me juve përpara që të bëjmë

1 pushimin, që do të ndihmonte dhe për të bërë pyetjet e mia dhe
2 të gjitha Ekipet e Mbrojtjes do t'i ndihmonte, qëndrimi im sa
3 i përket konfidencialitetit. Të gjithë ata personat që janë të
4 lidhur, që kanë të bëjnë me kampionet apo mostrat e ADN-së
5 janë publikë në Aktakuzën. Dhe në rrethana të tilla, ne kemi
6 vazhduar me supozime dhe kemi vepruar me supozimin që këto
7 raportet e ADN-së do të emërohen dhe referencat e kampionëve
8 do të përmenden, pra, këto janë viktima publike në këtë rast.
9 Dhe nuk është e qartë për neve nëse ndonjëri prej këtyre
10 raporteve që kanë të bëjnë me viktimat publike të këtyre, në
11 këto rrethana do të jenë konfidenciale apo jo.

12 Dhe, së dyti, raportet e ekspertit, letrat e udhëzimit,
13 CV-ja, mbajnë edhe pse mbajnë raporte konfidenciale siç është
14 numri i telefonit, natyrisht, që duhet të redaktohet, nuk ka
15 arsye që këto të jenë konfidenciale. Mund të jetë thjesht që
16 versionet e redaktuara të sigurohen.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurori
18 dëshiron të flasë?

19 Z. PACE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Sa i takon
20 përmendjes së viktimave, neve na duhet të bëjmë një
21 riveifikim tjetër. Besoj se viktimat e renditura në pjesën B
22 të versionit publik të Aktakuzës së Ndryshuar janë redaktuar
23 për pjesën më të madhe edhe pse viktimat nuk janë të
24 predisponueshme për publikun, ne po merremi me çështje shumë
25 të ndjeshme këtu që ka të bëjë me identifikimin e viktimave

1 konkrete, marrëdhëniet familjare. Dhe mendoj siç është
2 vërtetuar nga mënyra se si kemi vepruar deri tani, nuk ka
3 nevojë që të përmenden emrat gjatë kohës që po veprojmë, po
4 trajtojmë këtë çështje. Kjo do të shkaktonte dëm të
5 panevojshëm apo stres dhe të ketë ndikim negativ, ndikim
6 psikologjik negativ dhe të dëmshëm për viktimat dhe familjet e
7 viktimave.

8 Sa i takon klasifikimit të dokumenteve, kjo është mënyra
9 sesi kemi vepruar deri tani. Dokumenti ashtu si publik ose
10 konfidencial. Nëse më vonë ka urdhër që të përgatitet një
11 version i redaktuar publik, do të bëjmë një gjë të tillë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
13 Do ta shqyrtojmë këtë dhe të japim një përgjigje përpara se të
14 rifillojmë.

15 Do marrim dhjetë minuta pushim tani.

16 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

17 --- Seanca rifillon në orën 10.11

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
19 dëshmitarin në sallë, ju lutem.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Përpara se të fillojmë, a mund të
21 na sqaroni pak ju lutem lidhur me konfidencialitetin?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast, ju
23 lutem, sepse nuk ju dëgjoj.

24 Vazhdoni.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Jo, vetëm na sqaroni pak lidhur me

1 emrat dhe konfidencialitetin e dokumenteve si do procedojmë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për momentin
3 vazhdojmë siç kemi bërë deri tani. Të mos i përmendim emrat.
4 Raporti do të redaktohet, do të bëhet publik si dhe letra me
5 udhëzime do të redaktohet dhe do të jetë publike. Por,
6 sidoqoftë, ka emra që nuk duhet t'i themi me zë, të afërmit,
7 për shembull, që kanë dhënë mostrat, më mirë të mos i
8 përmendim.

9 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Atëherë duke marrë parasysh këtë,
10 dy nga 26 viktimat e mundshme janë të redaktuara. Dhe këta do
11 t'i përmend. Por në këto rrethana, pra, në rrethanat kur
12 anëtarët e familjes janë të identifikueshëm atëherë këto
13 dokumente nuk duhet të jenë publike, por të paktën të
14 përmendim emrin e letërnjoftimit të mundshëm në përputhje me
15 rregullën 120. Por të paktën për individët që janë publikë,
16 unë, të paktën, gjykoj që duhet t'i përmendim emrat.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni diçka
18 për të thënë?

19 Z. PACE: [Përkthim] E thamë edhe përpara pushimit, ne e
20 kundërshtojmë këtë. Arsyja pse nuk e bëjmë këtë publike është
21 se një viktimë e caktuar apo një dëshmitar ka masa mbrojtëse
22 në sallën e gjyqit. Po ashtu është dhe pasoja psikologjike që
23 mund të ketë kjo tek viktimat, te dëshmitarët edhe të afërmit
24 që duhet t'i mbrojmë. Atëherë unë s'e kuptojmë pse të mos
25 vazhdojmë siç e kishim bërë deri tani.

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 39

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po e
2 kuptoj pse i mëshoni kaq shumë punës së emrave, ne vetë e kemi
3 të qartë këtë informacion, kjo mjafton.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në çdo gjykim, ne duhet të
5 sigurohemi që informacionet të jenë publike.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne këtë e
7 dimë. Dhe përpigemi ta bëjmë. Por në këtë rast, nuk jemi të
8 bindur që informacioni duhet të jetë publik. Ky është vendimi
9 im për të gjitha emrat.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në rregull atëherë.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
13 uleni.

14 Dëshmitar, do vazhdojmë. Mbrojtja e z. Veseli, që është
15 ulur në të djathtën tuaj, do të fillojë me pyetjet.

16 Znj. Rowan, fjala është për ju.

17 Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan:

18 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

19 PY. Mirëmëngjesi. Unë quhem Kerrie Rowan dhe do ju bëj pyetje
20 për të pandehurin e dytë në këtë lëndë gjyqësore.

21 PË. Mirëmëngjesi.

22 PY. Do kujdesemi shumë me shpejtësinë sepse do flasim
23 anglisht.

24 Unë fillimisht do të doja t'ju tregoja se çfarë drejtimi
25 do të ndjek për pyetjet e mia. Unë dua të trajtoj në

1 përgjithësi disa tema me ju.

2 Fillimisht në natyrën e kufizuar të udhëzimeve që keni
3 marrë prej Prokurorisë, çfarë bëtë dhe çfarë nuk bëtë në bazë
4 të udhëzimeve. Do të doja të shihnim në terma më të
5 përgjithshëm pak mbetjet e skeletit dhe profilizimin e ADN-së.
6 Së treti, do të doja të eksploronim së bashku të dhënat që na
7 keni dhënë ju në këtë çështje dhe ndikimi që kanë pasur këto
8 të dhëna të kufizuara. Dhe do të doja të diskutonim disa
9 aspekte që burojnë nga këto të dhëna. Pra, këto janë temat e
10 përgjithshme që dua të trajtojmë së bashku.

11 PË. Në rregull.

12 PY. A është e vërtetë që fillimisht në korrik të 2021-shit
13 ZPS-ja ju dha disa udhëzime për këtë çështje?

14 PË. Po.

15 PY. Para korrikut 2021, ju nuk kishit kurrfarë përfshirje me
16 çështjet që trajton ky raport, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Nuk keni qenë i përfshirë as në analizime të ADN-së, as
19 në procese kampionimi?

20 PË. Po.

21 PY. Nuk keni qenë i përfshirë në krijimin e raporteve që ju
22 lexuat në bazë të udhëzimeve?

23 PË. Saktë.

24 PY. Nëse shohim të dhënat që kemi në dispozicion dhe
25 deduksionet tuaja, këto janë deduksione që në thelb, në fakt,

1 janë deduksione, përfundime të të tjerëve dhe jo tuajat?

2 PË. Po. Janë të një organizate tjetër.

3 PY. Po ndonjëherë mund ta identifikojmë kush e ka bërë
4 raportin, ndonjëherë jo?

5 PË. Po.

6 PY. A është e vërtetë që ju nuk keni folur me personat që i
7 kanë krijuar këto raporte?

8 PË. Po.

9 PY. As nuk ua ka kërkuar Prokuroria këtë gjë?

10 PË. As ma kanë kërkuar as ua kërkoval.

11 PY. Në rregull. Siç e bëmë dhe para një çasti, a mund të
12 themi që është e vërtetë se kur shohim gamën e raporteve që
13 kemi, disa prej këtyre raporteve janë të vështira të
14 identifikohen, pra, është e vështirë të identifikohet kush
15 është autori i raporteve, por ndonjëherë dhe është i mundur.
16 Kemi raste, pra, që mund ta identifikojmë kush e ka përgatitur
17 një raport?

18 PË. Në bazë të informacionit që më është dhënë, po, kështu
19 është.

20 PY. Shpresoj se e kam kuptuar drejt, po më duket se ju kanë
21 kërkuar të shihnit 26 raporte që lidhen me kampionimin ADN?

22 PË. E keni numëruar mbase më mirë se unë, po nuk po e
23 kontestoj.

24 PY. Mund ta kundërshtoj cilido në qoftë se ka informacione të
25 tjera. A është e vërtetë që këto raporte që keni rishikuar ju,

1 me përjashtim të njërit syresh, pra, ky është raporti që ju
2 për të cilin keni përgatitur një raport të dytë, të gjithë
3 raportet e tjera burimin e kishin nga ICMP-ja?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe në të gjitha këto raporte konkluzionet për arsye të
6 ndryshme në raporte të ndryshme, pra, këto raporte citonin një
7 përputhje të identitetit me personat që lidhen me këtë çështje
8 gjyqësore?

9 PË. Po.

10 PY. Tani të shohim atë letrën me udhëzimet përkatëse.

11 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Më duket se ka marrë numrin
12 provizor 1952. Nuk duhet të jetë publik ky material në bazë të
13 vendimit që mori Trupi Gjyqësor.

14 PY. Z. Dëshmitar, kjo është letra që patë edhe më herët. Kjo
15 është një letër me udhëzime që u është dërguar nga një palë në
16 një çështje gjyqësore për një ekspert dhe aty përcaktohet se
17 çfarë kërkon kjo palë nga eksperti?

18 PË. Po.

19 PY. Është një dokument që ju udhëzoi ju në cilësinë tuaj si
20 ekspert t'u përgjigjeni disa pyetjeve dhe të kryeni disa
21 analiza në bazë të udhëzimeve që ju kërkoi pala thirrëse?

22 PË. Po.

23 PY. Kjo ka qenë letra origjinale që keni marrë ju e cila
24 përmbante udhëzimet e Prokurorisë?

25 PË. Besoj se po.

1 PY. Të sqarojmë fillimisht që nuk do t'ju bëj asnjë pyetje
2 lidhur me raportet e ADN-së që kanë qenë objekt i letrës së
3 dytë me udhëzime dhe raportit tuaj të dytë.

4 PË. E kuptova.

5 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shkojmë në Shtojcën 1, ju lutem,
6 ku gjenden dhe pyetjet konkrete. Në PDF është faqja 3.
7 Faleminderit.

8 PY. Shohim çfarë ju ka kërkuar Prokuroria fillimisht, pra,
9 ajo ka kërkuar të jepni disa përkufizime të terminologjisë
10 shkencore që gjendet në materialin përkatës, materialin që
11 analizuat?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe shohim që ju kanë bërë edhe disa pyetje të
14 përgjithshme lidhur me mënyrën sesi ndihmon analizimi i ADN-së
15 për të përcaktuar identitetin e një personi por në terma të
16 përgjithshëm?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe shohim që ju kanë bërë dhe disa pyetje të
19 përgjithshme lidhur me mënyrën sesi ndihmuan analizimi i ADN-
20 së për të përcaktuar identitetin e një personi por në terma të
21 përgjithshëm?

22 PË. Po.

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shohim më poshtë në faqe.

24 PY. Në raport ka disa pyetje më të fokusuara lidhur me disa
25 raporte të ADN-së për të cilat ju do të bëni analizën

1 përkatëse?

2 PË. Po.

3 PY. Ju është dhënë material nga Prokuroria dhe ne mund ta
4 shohim në krye të faqes, numrat ERN janë numra të gjatë, ne u
5 themi numra ERN. Për shembull, IT-04-84bis, ky i përket një
6 dokumenti të Prokurorisë të cilin ju e analizuat, kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Pra, Prokuroria ju ka dhënë disa të dhëna që t'i kishit
9 si bazë për punën tuaj dhe shohim që të dhënat në fakt janë
10 pasqyruar dhe në këtë shtojcë?

11 PË. Po.

12 PY. A pajtoheni me mua që kur shohim pyetjet e Prokurorisë,
13 Prokuroria ju ka kërkuar që të keni qenë të fokusuar në
14 përgjigjet tuaja? Ju janë bërë pyetje konkrete për dokumente
15 konkretë dhe të dhënat janë bazuar në raport?

16 PË. Po, pyetjet ishin goxha precize.

17 PY. Pra, nuk mund të themi që ka pasur pyetje të përgjithshme
18 në këtë shtojcë me përjashtim të faktit, me përjashtim të
19 pyetjes çfarë është analiza e ADN-së?

20 PË. Jo.

21 PY. Ju i ndoqët udhëzimet në këtë letër dhe raporti që
22 përgatitët ju në fakt ishin përgjigje për pyetjet e tyre dhe
23 asgjë më shumë, a ishte ky udhëzimi që morët ju?

24 PË. Korrekt.

25 PY. Fokusohe mi pak tek ato që nuk ju ka kërkuar Prokuroria,

1 shohim letrën e zezë me këto udhëzime.

2 Pra, Prokuroria nuk jua ka kërkuar të bëni analizë të re
3 nga e para të këtyre deduksioneve, përfundimeve apo gjetjeve
4 mund të themi, nuk ju është kërkuar të bëni analizë nga e
5 para?

6 PË. Çfarë doni të thoni ju një "analizë të re"?

7 PY. Po. Për shembull, nuk ju është kërkuar ta bëni dhe një
8 herë punën nga zeroja, t'i analizonit dhe një herë këto
9 profile të ADN-së dhe të nxirrnit ju përfundimet tuaja se
10 çfarë do të ishte probabiliteti i një përputhjeje?

11 PË. Nga pikëpamja praktike, jo, nuk më është kërkuar.

12 PY. Pra, nuk ju është kërkuar ta bëni dhe një herë analizën
13 nga e para?

14 PË. Mendoj, nëse në disa pyetje e kam dhënë një opinion
15 matematikor. Konkretisht nuk më kujtohet se për cilat pyetje.

16 PY. Po. E keni bërë për disa raporte në fakt, disa nga
17 shifrat, për shembull, nuk ishin përkthyer në përqindje
18 probabiliteti dhe ju keni dhënë një shpjegim lidhur me këto.
19 Por, në fakt, unë e kisha më shumë fjalën tek analiza, juve
20 nuk ju është kërkuar të analizoni edhe një herë këto gjetje.
21 Është a s'është e mundur është tjetër gjë, por ama nuk ju
22 është bërë kjo pyetje?

23 PË. Që të sigurohem që po e kuptoj siç duhet, e keni fjalën
24 për profilin e ADN-ve?

25 PY. Po.

1 PË. Jo, jo, nuk kam bërë asnjëherë rishikim të analizës. Unë
2 kam analizuar gjetjet.

3 PY. Atëherë ne do të trajtojmë pastaj nëse kishin mundësi apo
4 nuk kishit mundësi ta bënit ju këtë gjë.

5 Pra, juve nuk ju është kërkuar të konfirmoni saktësinë
6 apo vërtetësinë e të dhënave në këto raporte. Në thelb nuk ju
7 është kërkuar?

8 PË. Jo.

9 PY. Nuk ju është kërkuar të konfirmoni nëse metodika,
10 metodologjia që është ndjekur përputhet me standardet normale
11 sipas mendimit tuaj?

12 PË. Jo, nuk më kërkuar të komentoj lidhur me metodologjinë.

13 PY. Nuk ju është bërë pyetje në përgjithësi të evidentonit
14 ndonjë shqetësim, mangësi, dobësi, që ju në fakt si ekspert e
15 kishit mundësinë ta bënit?

16 PË. Jo, nuk më është kërkuar.

17 PY. Besoj se është përmendur tashmë por ju keni pasur një
18 seancë përgatitore me Prokurorinë javën e kaluar, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Keni folur me disa persona nga ekipi i Prokurorisë për të
21 folur lidhur me dëshminë e sotme?

22 PË. Po.

23 PY. Në takimin tuaj që e patët në Zoom, ju ngritët një
24 shqetësim me Prokurorinë dhe me të drejtë dhe folët për
25 statusin tuaj si dëshmitar në këtë lëndë gjyqësore. Ju

1 kujtohet?

2 PË. Po, më kujtohet.

3 PY. Dhe ju i kishit shpjeguar Prokurorisë se në Britani ku
4 është juridiksioni, nëse e kuptoj unë drejt, ku punoni ju ose
5 ku qëndroni?

6 PË. Qëndroj në Britani, jetoj në Britani.

7 PY. Sikurse e informuat Prokurorinë ju, në Britani do të
8 konsideroheshit ekspert i gjykatës?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe ju kërkuat sqarim a do të ishit në të njëjtin
11 pozicion dhe këtu?

12 PË. Po.

13 PY. Sepse në Britaninë e Madhe kur jep një aktekspertizë,
14 bashkëngjitur aktekspertizës është dhe një deklaratë e
15 ekspertit të cilën e nënshkruajnë të gjithë ekspertët dhe
16 ofron një lloj garancie që deklarata apo analiza është bërë në
17 mënyrë të pavarur dhe të paanshme?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe ju i kërkuat Prokurorisë me të drejtë që kjo të
20 vlente dhe sot?

21 PË. Po.

22 PY. Mesa e kuptoni ju, domethënë, jeni i vetmi ekspert për
23 ADN-në që do të thërrasë Prokuroria në këtë lëndë gjyqësore?

24 PË. Po, kështu e kam kuptuar dhe unë.

25 PY. Të flasim pak tani për të dhënat e ADN-së për mbetjet

1 skeletore.

2 PË. Në rregull.

3 PY. Metodologjia për ADN për mbetjet skeletore duke marrë

4 parasysh të dhënat, a mund të themi ne që të gjitha

5 kampionimet që janë përdorur në këto raporte, pra, të gjitha

6 këto mostra burojnë nga mostrat e eshtrave që janë nxjerrë

7 gjatë proceseve të zhvarrimeve mesa keni kuptuar ju?

8 PË. Kështu e kam kuptuar unë.

9 PY. Pra, ajo që keni bërë ju apo që keni parë në këto raporte
10 janë mbetjet skeletore nga zhvarrimet?

11 PË. Po.

12 PY. Disa raporte ka dhe disa fotografi të eshtrave që janë
13 përdorur për këtë analizë, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Edhe kryesisht gjenden poshtë në të majtë të raporteve?

16 PË. Po.

17 PY. A është e mundshme për shkak të larmisë së madhe të
18 informacioneve që kemi marrë që ne nuk e dimë metodologjinë që
19 është përdorur në procesin e analizës së këtyre eshtrave?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe duke qenë se nuk e kemi fare këtë informacion, ju në
22 cilësinë tuaj si ekspert, nuk jeni në gjendje të komentoni
23 lidhur me cilësinë apo përshtatshmërinë e metodologjisë që
24 është përdorur për nxjerrjen e profileve të ADN-së nga këto
25 kampionime skeletore?

1 PË. Është e drejtë. Nuk kam pasur ndonjë -- nuk kam pasur
2 njohuri cila ka qenë metodika që është përdorur.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast, ju
4 lutem. Po flisni shumë shpejt dhe po flisni njëkohësisht.

5 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po. Ju kërkoj ndjesë.

6 PY. Ky është paralajmërimi i parë, z. Dëshmitar, që duhet të
7 ngadalësojmë. Po jam e sigurtë që është faji im.

8 Duke mos pasur këtë informacion, i takon që ju nuk jeni
9 në pozicion të konfirmoni se procesi i ADN-së plotëson
10 standardet, që sipas jush janë standarde të kënaqshme?

11 PË. Detyrimet apo kushtet për nxjerrjen e ADN-së është që
12 ADN-ja të vijë nga një burim i vetëm. Dhe kur kemi një
13 profilizim atëherë ne mund të dalim në përfundimin që është
14 rikuperuar ADN-ja.

15 PY. Po ne s'i kemi ama profilet në këtë rast?

16 PË. Po kemi profile ose versione të koduara të profileve.

17 PY. Kemi versione të koduara të vendeve të caktuara brenda
18 profilit, por nuk e kemi profilin bruto?

19 PË. Jo, nuk e kemi profilin bruto në mënyrë që të bëjmë
20 interpretime. Është e saktë.

21 PY. Tani, duke marrë parasysh që ADN-ja ka dalë nga eshtrat e
22 zhvarrosura, a pajtoheni me mua që është një detyrë goxha e
23 vështirë kjo?

24 PË. Varet nga eshtra, nga pjesë e skeletit. Varet nga kushtet
25 apo nga gjendja në të cilën ka qenë eshtra kur është

1 rikuperuar. Edhe sigurisht që është një proces shumë i
2 vështirë. Është shumë e thjeshtë është të bëhet me gjak, por
3 mund të merret mostër ADN-je dhe nga eshtrat, te eshtrat që
4 nuk janë të dëmtuara shumë nga kushtet mjedisore, por ama në
5 këto raste kërkohet më shumë kohë.

6 PY. Dhe ju nuk e dini se në ç'gjendje kanë qenë këto eshtrat
7 kur mbërritën në laborator, sepse nuk e kemi këtë informacion?

8 PË. Jo, nuk e kam këtë informacion.

9 PY. A pajtoheni me mua që kur merremi me kampionime të
10 eshtrave dhe me nxjerrjen, marrjen e materialit, pra, ADN-në
11 në rrethana të tilla është një rrezik i madh kontaminimi apo
12 dëmtimi?

13 PË. Edhe një herë, varet në ç'kushte janë eshtrat. Një pjesë
14 e mirë e eshtrave kanë sasi ADN-je edhe në këto kushte dëmtimi
15 i kampionimit është po aq i lartë sa në kushte të tjera kur
16 nxirret, kur merret materiali për ADN-në.

17 PY. A pajtoheni me mua, pra, që arsyeja pse është kjo një
18 detyrë delikate është se ADN-ja që mund të merret në këto
19 raste është shumë e kufizuar, prandaj kur ke një sasi shumë të
20 vogël materialit për ADN-në. Duke pasur material kaq të vogël
21 rreziku afër mendsh është shumë i lartë që mund të humbasësh
22 materialit?

23 PË. Po, e drejtë.

24 PY. Pra, kur ke shumë pak ADN, shkencëtarët, teknikët e
25 laboratorëve, duhet të jenë shumë të kujdesshëm, madje duhet

1 të shtojnë kujdesin për t'i mbrojtur materialet nga
2 kontaminimi?

3 PË. Jo. Mendoj që kujdesi duhet të jetë njësoj në të gjitha
4 rastet, në të gjitha kampionimet, në të gjitha mostrat pra.
5 Edhe me rastet e referencës, që përdoren për referencë. Pra,
6 sigurisht, që duhet që të merren masa për të mos lejuar
7 kontaminimin e mostrës.

8 PY. Sigurisht. Kjo duhet të jetë njësoj në të gjitha rastet,
9 por duhet të ketë masa veçanërisht të mira kur ka kampionime
10 të këtij lloji?

11 PË. Po.

12 PY. Kur flasim për kontaminimin apo dëmtimin e mostrave, për
13 shembull, në një laborator kontaminimi mund të jetë kontaminim
14 i mostrës që po analizohet edhe mund të jetë një kontaminim që
15 mund ta bëj pa dashje një pjesëtar i ekipit. Ekzistojnë forma
16 të ndryshme kontaminimi që mund të ndodhin dhe duhet parë se
17 cilat janë masat për të mos e lejuar që kjo të ndodhë në një
18 laborator.

19 PË. Po, pajtohem. Dhe kjo vlen në të gjitha rastet.

20 PY. Po. Po a është e vërtetë që në disa laboratorë ka masa të
21 ndryshme apo protokoll të caktuar për të mbrojtur mostrat nga
22 kontaminimi, domethënë, jo të gjithë laboratorët kanë të
23 gjithë të njëjtat protokolle?

24 PË. Kanë ngjashmëri. Po sigurisht që çdo laborator ka
25 protokollin e vet.

1 PY. Për shembull, në Britani, në raste të tilla një masë do
2 të ishte kjo, në momentin që merret materiali për ADN-në, kjo
3 mostër krahasohet me mostrën e fundit që ka parë gjashtë muajt
4 e fundit laboratorit për të siguruar që kampionimi i ri nuk
5 është kontaminuar nga mostrat e tjera që janë përdorur gjashtë
6 muajt e fundit. Kjo është një masë krejt normale, rutinë.

7 PË. Po. Gjashtë muaj është periudhë me vlerë.

8 PY. Ndonjëherë kjo ndodh edhe për të krahasuar me personelin,
9 krahas personeli me njëri-tjetrin?

10 PË. Po. Dhe për ta krahasuar me personelin.

11 PY. Sepse ndonjëherë edhe teknikët e laboratorëve mund të
12 kontaminojnë mostrat?

13 PË. Po.

14 PY. Ama në këtë rast ne nuk e dimë çfarë protokolli ka pasur
15 për të mos lejuar kontaminimin?

16 PË. Nuk mund të flas në lidhje me këtë.

17 PY. Sepse ne nuk e dinim se ku kanë qenë dhe ju nuk mund të
18 komentoni dhe të thoni që kanë qenë të mjaftueshme masat që
19 janë marrë?

20 PË. Saktë.

21 PY. Flasim tani për eshtrat. Për bashkimin e eshtrave, pra, a
22 pajtoheni me mua që ndonjëherë eshtrat mund të jenë gjetur
23 bashkë, mund të jenë zhvendosur bashkë apo mund të jenë
24 ruajtur bashkë apo ka ndonjë përkufizim më të saktë lidhur me
25 këtë?

1 PË. "Bashkimi" është thjesht një term shumë më i sofistikuar
2 për të thënë bashkimi i eshtrave.

3 PY. Po. Domethënë, nuk po flasim bashkimi i eshtrave nga më
4 shumë se një trup?

5 PË. Po.

6 PY. A pajtoheni me mua që kur ka bashkim eshtrash ekziston
7 rreziku i kontaminimit?

8 PË. Mundësia për kontaminim ekziston, megjithatë do të them
9 që mundësia e kontaminimit është shumë e vogël duke pasur
10 parasysh procedurat apo duke pasur parasysh gjithashtu edhe të
11 gjitha që bën laboratorin në mënyrë të tillë që të sigurohet që
12 të mos ketë ndërhyrje kontaminim të këtyre eshtrave.

13 PY. Sa i takon praktikës më të mirë për trajtimin e eshtrave,
14 a pajtoheni me mua që praktikën më të mirë për sa i takon
15 kampionimit të ADN-së një është është që ti eshtrën si
16 kampion duhet ta dërgosh në një laborator tjetër në ndryshëm
17 nga laboratorin që bën analizë ADN-je në të përditshmen e vet?
18 Domethënë, a është kjo një praktikë e mirë në mënyrë të tillë
19 që të mund të reduktohet, të ulët rreziku për kontaminim?

20 PË. Unë nuk mendoj që çdo laborator duhet të çojë një eshtër
21 kampionin e ADN-së, për shembull, në një laborator tjetër. Për
22 shembull, në qoftë se unë do shikoj praktikën e Mbretërisë së
23 Bashkuar, ajo çfarë ndodh është që në një skenë krimi,
24 domethënë, merren kampionët dhe kampionët përpunohen në dhoma
25 të ndryshme të një laboratorin, domethënë, në vende të ndryshme

1 të laboratorit dhe jo domosdoshmërisht në laboratorë të

2 ndryshëm. Nuk është kërkesë kjo.

3 PY. Jo, nuk thashë që është kërkesë. Po thashë që është

4 praktikë e mirë në një botë ideale.

5 PË. Në një botë ideale, mbase po.

6 PY. Në një botë ideale, a pajtoheni me mua që kur bëhet fjalë

7 për bashkimin ose përzierjen e eshtrave a do jetë e mundur që

8 të identifikohen kampionë që mund të vijnë nga dy persona të

9 ndryshëm të vdekur, domethënë, në qoftë se bëhet fjalë për dy

10 eshtra këmbësh a është e mundur, për shembull, që këto eshtra

11 mund të vijnë nga dy persona që kanë vdekur dhe në qoftë se do

12 i referohemi një skenari të tillë, a është praktikë sipas

13 jush, domethënë, praktika e mirë a është që këto dy kocka ose

14 dy eshtra të dërgohen në dy laboratorë të ndryshëm?

15 PË. Me thënë të drejtën më duket sikur është specifikim i

16 tepërt. Nuk është e nevojshme që të çohen në laboratorë të

17 ndryshëm, sipas meje. Atëherë mbështetur në përpunimin e

18 kampionëve që vijnë nga vendi i krimit, thashë, domethënë, që

19 trajtimi i materialit të ADN-së mjafton që të bëhet në dy

20 vende të ndryshme brenda një laboratorit.

21 PY. Kur flasim për kontaminim, pra, për çfarë flasim ne për

22 kontaminim është që materiali i ADN-së që ne nxjerrim, kur

23 flasim për kontaminim ky material ndoshta mund të përzihet me

24 një tjetër kampion ADN-je të një personi tjetër. A pajtoheni

25 ju me mua lidhur me këtë?

1 PË. Po.

2 PY. Kur bëhet përzierja, pra, mund të shikojmë përzierjen e
3 kampionit të ADN-së me një, dy ose një numër X të caktuar të
4 kampionëve të tjerë, domethënë, ekziston si mundësi kjo, apo
5 jo?

6 PË. Po.

7 PY. Nuk është e pazakontë që laboratorët të merren apo të
8 trajtojnë kampionë të përzierë në të përditshmen e tyre, apo
9 jo?

10 PË. Laboratorët që përpunojnë kampionë nga vendet e krimit
11 mund të shohin raste të përzierjeve të materialit ADN.

12 PY. Atëherë le të marrim rastin e vendit të krimit. Për
13 shembull, në qoftë se do të ndodhte një krim në Mbretërinë e
14 Bashkuar dhe në qoftë se, për shembull, në vendin e krimit ka
15 mbetur një kapele bejsbolli që mund të përdoret, për shembull,
16 për kampionim ADN-je është kjo si mundësi që të bëhet,
17 domethënë, kampionimi i ADN-së nga një objekt i tillë?

18 PË. Po.

19 PY. Megjithatë nga ana tjetër një kapele bejsbolli mund të
20 mbahet nga disa persona, nuk është e thënë që të mbahet nga
21 një, kështu që mund të kemi një përzierje të materialit për
22 analizë ADN-je, apo jo?

23 PË. Mund të jetë e mundur.

24 PY. Atëherë në një vend të tillë, kjo është situata që mund
25 të ndodhë në një vend krimi, kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Po profilet e ADN-së në këtë skenar a mund të
3 kontaminohen dhe mund të merren, për shembull, nga dikush
4 tjetër, nga eshtrat e dikujt tjetër?

5 PË. Po, nga një burim tjetër ADN-je.

6 PY. Dhe për këtë arsye laboratorët duhet të kenë procedura,
7 duhet të kenë protokolle në mënyrë të tillë që të trajtojnë
8 përzierjet e eshtrave ose të materialit ADN?

9 PË. Laboratorët duhet të jenë në gjendje që të identifikojnë
10 rastet e përzierjeve të materialit të ADN-së.

11 PY. Sapo më thanë që duhet që të flas më ngadalë. Do të
12 mundohem që të flas më ngadalë.

13 Atëherë dhe një herë, procedurat që ekzistojnë për sa i
14 takon përzierjes së materialit të ADN-së ndryshojnë në
15 Mbretërinë e Bashkuar. Megjithatë në kontekstin kriminal, që
16 ne përmendëm më përpara, në Mbretërinë e Bashkuar kur jepni
17 rezultatet, profilet e përzierra asnjëherë nuk përjashtohen.
18 Por gjithmonë përfshihen në një mjedis kriminal brenda
19 rezultateve?

20 PË. Në qoftë se janë marrë në profile të përzierra do të
21 raportohen profilet e përzierra.

22 PY. Po. Domethënë, në laboratorë të caktuar në qoftë se
23 indikatorët nuk i përmbushin kritere të caktuara, atëherë
24 laboratori nuk i konsideron dëshminë, për shembull, e miksimit
25 ose përzierjes në qoftë se nuk përmbushen kriteret, a mund ta

1 them kështu?

2 PË. Është pak e vështirë që të bie dakord me një përkufizim
3 të tillë.

4 PY. Mirë. A është e mundur që në qoftë se do shikosh
5 profilet, në qoftë se ti nuk ke qasje në EPG, domethënë,
6 profilin e ADN-së, domethënë, në qoftë se nuk ke qasje në
7 profilin e ADN-së, ju nuk tregoni dot ose një ekspert nuk
8 thotë dot se si është trajtuar një rast përzierjeje materiali
9 për kampionim ADN-je?

10 Pra, në këtë rast ne nuk e dimë përzierjen, nuk e dimë në
11 qoftë se ka ndodhur përzierja se nuk e kemi profilin e ADN-së
12 dhe ne nuk e dimë në qoftë se profilet për të cilat ne po
13 trajtojmë janë përzierë me një material tjetër apo jo. Këtë
14 nuk e përjashtojmë dot, apo jo?

15 PË. Jo, në këtë skenar jo, në qoftë se nuk ka prova në
16 profilin që ka pasur përzierje të materialit të ADN-së kjo
17 mund të jetë situata. Në qoftë se kampionët janë përjashtuar,
18 domethënë, nga kampionët është përjashtuar që nuk ka pasur
19 përzierje mund të ndodhë kështu.

20 PY. Atëherë i takon që nuk mund të përjashtohet tërësisht
21 mundësia që profilet e ADN-së janë të tilla që nuk përfshijnë
22 përzierje të materialit të ADN-së, kontaminimit të tyre?

23 PË. Pra, unë besoj raportet që bëhet fjalë për profile me një
24 burim të vetëm, sikurse e thashë dhe më përpara, nuk kemi parë
25 profile të ADN-së bazë.

1 PY. Pra, është e drejtë të thuhet që ju prezumoni që ka qenë
2 kështu, po nuk e konfirmoni dot që është 100 për qind e
3 vërtetë, apo jo?

4 PË. Unë nuk kam parë profile të ADN-së, kështu që nuk mund të
5 komentoj dot lidhur me këtë.

6 PY. Atëherë le të flasim pak për profilet e ADN-së, se besoj
7 që ky është elementi më i rëndësishëm për t'u diskutuar.
8 Atëherë dua që ta trajtojmë pak këtë në më tepër hollësi
9 përpara sesa të diskutojmë për raportet tuaja.

10 A mund të na thoni çfarë kuptimi ka EPG-ja?

11 PË. EPG-ja është elektroferogramë.

12 PY. Elektroferograma është profili ADN, apo jo, domethënë,
13 profili bazë ose bruto i ADN-së, apo jo?

14 PË. Po. Është rezultati shkencor i ADN-së është plotë.

15 PY. Tani sa i takon EPG-së, çfarë është EPG-ja apo çfarë
16 formati ka, domethënë, paraqitja është kështu si grafik me
17 pika të larta e të ulëta, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Atëherë kjo kurba me ulje dhe ngritje, pasqyron
20 sekuencimin që rezulton pas ADN-së, a është kështu?

21 PË. Po. Vjen nga amplifikimi i ADN-së në pika të ndryshme ose
22 në vende të ndryshme, në pjesëza të ndryshme të ADN-së.

23 PY. Dhe kjo del duke përdorur, domethënë, PCR-të, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Pra, i takon që EPG-ja jep zona të ndryshme të ADN-së dhe

1 me ngjyra të ndryshme, apo jo?

2 PË. Po. Pjesë të ndryshme të ADN-së, sikurse përcaktohen nga
3 gjenet në vende të ndryshme të cilat bëhen të diferencuara ose
4 jepen të ndryshme sa i takon madhësisë së tyre dhe ngjyrës ose
5 kombinimit të madhësisë edhe ngjyrës.

6 PY. Kur ju keni këtë EPG-në si profilizim i ADN-së, si
7 shkencëtar, ju keni mundësinë që të shqyrtoni të gjithë
8 profilin e ADN-së ose të gjitha gjenet e ndryshme ku janë
9 pozicionuar ato në ADN dhe sesi janë ato të ndryshme nga
10 njëra-tjetra, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Në pyetjen tjetër do ju kërkoj të na jepni disa sqarime
13 për përkufizimin në mënyrë të tillë që të kuptojmë të gjithë
14 situatën.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Megjithatë për këtë do të doja që
16 t'i kërkoja Sekretares së pari që të na paraqesë një raport
17 ekspertit që është prova P854 dhe do i kërkoja Sekretares që të
18 mos e transmetojë për publikun këtë material.

19 PY. Ju kërkoj ndjesë, do kalojmë, do shohim dy dokumente, një
20 ose dy dokumente. Domethënë, dokumentet do të duhet që të
21 paraqiten në mënyrë digjitale. Ju kërkoj ndjesë, na duhet që
22 të presim Sekretaren.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po flisni mbi
24 njëri-tjetrin. Po flisni në të njëjtën kohë. Ju lutem bëni një
25 pauzë të shkurtër përpara sesa të jepni përgjigje pyetjes dhe

1 flisni më ngadalë për t'ju kapur plotësisht.

2 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në faqen 197 të dokumentit që kemi
3 në ekran.

4 PY. Z. Goodwin, sa për t'ju sqaruar, ne do të shikojmë një
5 përmbledhje të një prej raporteve që ju keni shqyrtuar, keni
6 vlerësuar gjatë punës tuaj. Po ashtu duhet të them që ky është
7 një prej raporteve që ka qenë pjesë e raportit shtesë të
8 ekspertit që keni marrë nga Prokuroria.

9 PË. Në rregull.

10 PY. Atëherë do shikojmë pak identitetin e mundur që ke
11 identifikuar dhe gjithashtu do të shikojmë edhe të dhëna të
12 tjera të ICMP.

13 Atëherë, z. Goodwin, ju keni parë një raport tjetër më
14 përpara, do të doja t'ju pyesja në qoftë se ky është një
15 raport standard, domethënë, pamja është e një raporti standard
16 që e keni parë për të bërë punën tuaj si ekspert?

17 PË. Po.

18 PY. Pjesa më e madhe e faqeve ka të njëjtën pamje, kanë të
19 njëjtin grafik ose të njëjtën skemë?

20 PË. Po.

21 PY. Këto janë rezultatet e pretenduara të ADN-së nga testimi?

22 PË. Po.

23 PY. A mund të thoni që ju mund të thoni, mund të na e tregoni
24 që duke parë këtë raport mënyra sesi është dhënë informacioni,
25 si është paraqitur informacioni që në qoftë se kemi të bëjmë

1 me një teknikë ADN-je testimi ose STR-je?

2 PË. Po, është një profil tipik për përcaktimin e ADN-së.

3 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Tani le të kalojmë, znj.

4 Sekretare, në fund të në majtë, ju lutem zmadhojeni këtë
5 pjesë.

6 PY. Atëherë kjo është një pjesë të cilën ju e diskutuat edhe
7 me Prokurorin, por mbase e kaluat shumë shpejt këtë. Atëherë
8 pjesa e materialit e vendosjes së materialit gjenetik në ADN
9 është një, domethënë, këto *locus* kanë të bëjnë me vendin, me
10 pozicionimin e gjeneve, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Domethënë, gjenet janë të vendosura në vende të ndryshme,
13 apo jo, të kromozomeve?

14 PË. Po.

15 PY. Atëherë në qoftë se do shikojmë këtë raport që keni
16 përpara, ne shohim atëherë gjenet sipas vendosje së tyre. Për
17 shembull, në qoftë se do të shikojmë në fillim fare ku thuhet
18 D3S1358, pra, jepen disa numra, domethënë, këto janë gjenet
19 sipas vendosjes së tyre të cilat janë analizuar, kështu, apo
20 jo?

21 Ju lutem, bëni një shënim, Asistentja do t'ju japë diçka
22 për të shkruar. Ju lutem a do të bëni një shënim te D3S1358.
23 Dhe vendosni një L për *loci* ose për gjenet për vendin e tyre.
24 Kur bëhet testimi sipas marrëdhënies, shkencëtarët shohin
25 vetëm koleksione specifike të gjeneve sipas funksionimit të

1 tyre, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe ka një arsye për këtë, sepse njerëzit kanë, le të
4 themi, të dhëna identike të shumta sa i takon ADN-së.

5 Megjithatë për këtë arsye është e rëndësishme që të bëhet
6 marrëdhënia e gjeneve në mënyrë të tillë që të identifikohet
7 ADN-ja përkatëse e personit, a është kështu, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Nuk e kemi të gjithë ekranin po bëhet për 16 gjene
10 pozicionimit të tyre, pra, për të bërë të mundur marrëdhëniet
11 e tyre?

12 E shikoni këtë?

13 PË. Po.

14 PY. Po këtu, për shembull, shikojmë dhe AKMG X, Y që ka të
15 bëjë me seksin, përcaktimin e gjinisë ose të seksit të
16 personit të vdekur?

17 PË. Po.

18 PY. Ju lutem bëni një shënim aty për sa i takon gjinisë.

19 PË. Po.

20 PY. Do ju kërkoja gjithashtu që të bëni shënimet përkatëse në
21 mënyrë të tillë që t'i kuptojmë edhe t'i kemi të qarta dhe në
22 të ardhmen.

23 PË. [Shënon]

24 PY. Tani, Dëshmitar, alelet janë gjenet sipas pozicionit të
25 tyre të cilat janë të analizuara si pjesë e testimi të

1 marrëdhënies, alelet janë forma të ndryshme të cilat ne mund
2 t'i shikojmë në versione të ndryshme të gjeneve në vende të
3 ndryshme, apo jo?

4 PË. Alelet janë variante të ndryshëm të një pjese, një copëze
5 të caktuar të ADN-së që ne po analizojmë.

6 PY. Në rregull. Po shikojmë një pjesëz të ADN-së dhe një
7 pjesë e ADN-së ka gjene sipas pozicionimit të tyre të
8 ndryshme, kjo është tipike për këtë, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Po këtu çfarë po shohim, domethënë, a mund ta thoni çfarë
11 lloj alelesh ka ky person, a na thua që çfarë lloj alelesh ka
12 personi në gjenet sipas pozicionimit të tyre?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. A mund të rrethoni te TH01, alelin 1, alelin 2 në mënyrë
15 të tillë që ta kemi të qartë?

16 PË. [Shënon]

17 PY. Shumë faleminderit. Dhe ju lutem vendosni germën A
18 përbri.

19 PË. [Shënon]

20 PY. Shumë faleminderit. Atëherë alelet mund të maten, kështu,
21 Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Sikurse e thamë edhe më përpara, mënyra e zakonshme e
24 matjes së aleleve është që të shikohet lartësia e tyre në
25 profilin e ADN-së ose me EPG, apo jo?

1 PË. Ne bëjmë përcaktimin e tyre mbështetur në gjatësinë që
2 përcaktohet në qoftë se do të shikojmë EPG-në.

3 PY. Po.

4 PË. Po, domethënë, duhet të mbështetemi te *software* që bën
5 analizën e EPG.

6 PY. Domethënë, *software* që bën funksionimin ose operimin e
7 EPG-së, kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Atëherë STR-të janë pjesëza të shkurtra të ADN-së që
10 përsëritin veten? Pra, këto janë pjesëza të ADN-së që
11 përsërisin veten?

12 PË. Po, e keni të saktë. Këto janë.

13 PY. Pra, kur shikojmë ADN-në dhe kur shikojmë, për shembull,
14 STR-të që dalin tek 4, domethënë, a shikojmë STR-të tek
15 nënndarja e katërt këtu, apo jo?

16 PË. Me përjashtimin e D, e Penta D dhe Penta E, pastaj kemi
17 shumëfishim ose përsëritjen e tyre me 5.

18 PY. Pra, Penta D është e pesta, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, baza shumëzohet me katër, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Këto të dyja janë shumëfishimi me 5?

23 PË. Po.

24 PY. Kur flitet për alelet. Alelet në testimin e ADN-së
25 pasqyrohen në mënyrë tradicionale numerikisht, domethënë, me

1 shifra, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Kur shihet rezultati, për shembull, për caktimin e
4 aleleve të cilat rrjedhin nga testimi i PCR-së janë numra të
5 plotë ose numra të plotë me .2. Kjo është ajo çfarë ti pretë
6 të shohësh, apo jo?

7 PË. Po, zakonisht, domethënë, janë numra të tërë që mund të
8 jenë me një pikë që mund të jenë .1, .2, .3. e të tjerë.

9 PY. A pajtoheni me mua, ekspert, që zakonisht ajo çfarë
10 prisni që të shihni janë, pra, shifra të plotë .2, domethënë,
11 më e zakonshme që të jenë shifra, disa shifra .2, a është
12 kështu?

13 PË. Jo, nuk pajtohem me këtë. Sepse varet nga pozicionimi i
14 gjeneve. Për shembull, në qoftë se do shikojmë *locos* ose
15 gjenin TH është 9.3. Kështu që nuk është, domethënë, mund të
16 jetë .3, nuk mund të jetë domosdoshmërisht .2.

17 PY. Këtë shembull do ta merrja pak unë në fakt më pas. Shumë
18 mirë që morët këtë shembull. Por ajo çfarë dua të them unë
19 është që ndonjëherë ju shikoni dhe .1 dhe .3. Dhe, për
20 shembull, në rastin në fjalë kemi një shifër që përfundon me
21 .3. Domethënë, pavarësisht që nuk është e zakonshme, pra, mund
22 të kemi numra të cilët përfundojnë me .1 dhe .3, pavarësisht
23 që më e zakonshme është përfundimi me .2.

24 A pajtoheni me mua që kur shikojmë caktimet e aleleve,
25 ajo çfarë pritet që të shikohet në rezultate janë shifra të

1 plota ose shifra të plota me .2, por mund të ndodhë gjithashtu
2 që këto alele të përfundojnë me .1 ose me .3, megjithëse nuk
3 janë shumë të shpeshta?

4 PË. Po.

5 PY. Megjithatë nuk pritet zakonisht që të shikosh ndonjë
6 shifër që përfundon me shifra të tjera?

7 PË. Mund të ndodhë që të përfundojë dhe me .4, domethënë, tek
8 Penta E përsëritja mund të jetë dhe .4.

9 PY. Por nuk mund të ndodhë më tej. Shumë rrallë mund të
10 ndodhë me ndonjë shifër tjetër.

11 PË. Pra, kur të kemi kaluar tek pika .4, kemi përsëritjen e
12 plotë.

13 PY. Po. Domethënë, i takon që përtej pikës .4 nuk prisni që
14 të shikoni ndonjë përcaktim aleli që është me një shifër
15 tjetër edhe .4 dhe vetë është përjashtimore, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Atëherë personi duhet të ketë dy alele për çdo STR, një
18 për secilin prind dhe për këtë arsye, për shembull, kemi
19 alelin 1 dhe alelin 2. Njëri alel i takon njërit prind dhe
20 tjetri prindit tjetër, a është kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Për këtë arsye përdorim këtë analizë kur shohim ose
23 analizojmë testimin sipas marrëdhënieve sepse këto alele
24 vijjnë, pra, kemi dy alele njëri për njërin prind, tjetri për
25 tjetrin dhe prandaj bëhet analizimi për të parë në qoftë se

1 personat janë të lidhur apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Po shikoj kohën. Kështu që do mundohem që të trajtojme
4 edhe një temë tjetër së bashku përpara sesa të bëjmë pushimin.

5 Do flasim për testimin e miksuar. Pra, kur bëhet ADN-ja
6 për të konfirmuar ose jo marrëdhënien ose ekzistencën e
7 marrëdhënies midis personave, ju përmendët më përpara, që
8 përdoren laborator, që përdoren diçka që quhen *multiplex*
9 *testing* ose testimim *multiplex*, apo jo?

10 PË. Po, ne e quajmë atë *multiplex*, *multiplex*.

11 PY. Në rregull. Tani testimi *multiplex* janë disa testime që
12 bëhen, që bëjnë analizimin e materialit të ADN-së, a është
13 kështu apo jo?

14 PË. Po. Janë disa praimera PCR-je që përdorin disa gjene të
15 pozicionuara në vende të ndryshme të materialit gjenetik, për
16 shembull, njëri prej tyre që është i renditur këtu.

17 PY. Dhe pastaj bëhet testimi ose amplifikimi PCR i materialit
18 ADN?

19 PË. Po. Po do marrim ato pjesëza për të cilët ne jemi të
20 interesuar për ta analizuar.

21 PY. Ju thatë për pjesëzat që jeni të interesuar, pra,
22 zakonisht në qoftë se do shikojmë testimin sipas marrëdhënies,
23 dua që të shikohet profili dhe zakonisht merren 16 gjene sipas
24 pozicioneve të tyre?

25 PË. Sa për të qenë të qartë, ne shikojmë të gjithë profilin.

1 Nuk shikojmë të gjithë profilin por të gjithë gjenomën.

2 PY. Ju kërkoj ndjesë.

3 PË. Jo, thjesht sa për të qenë të qartë.

4 PY. Në rregull atëherë. Ne shohim 16 pozicionime të ndryshme
5 të gjeneve?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe në qoftë se do bëjmë testimin e marrëdhënies, atëherë
8 do të duhet të shikohen 16 gjene që pozicionohen në vende të
9 ndryshme, kështu?

10 PË. Në këtë rast, po.

11 PY. Por standardi është 16 gjene në pozicione të ndryshme?

12 PË. Ka qenë më përpara, në të shkuarën, ky ka qenë standardi.
13 Tani ka ndryshuar procedura. Por kanë kaluar mbi 15 vite që
14 atëherë, domethënë, në vitin 2000, në vitet 1990 kjo ka qenë
15 procedura më tepër.

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, besoj që ka
17 ardhur koha për të bërë pushimin tani.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ardhur
19 koha për të bërë pushimin, Dëshmitar. Ju lutem dilni nga salla
20 nën shoqërinë e Sekretares. Nuk duhet të flisni me askënd për
21 dëshminë tuaj, Dëshmitar.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
24 pushimin.

25 --- Pauza fillon në orën 10.59

1 --- Seanca rifillon në orën 11.30

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Lidhur me
3 kundërshtimin e Mbrojtjes së Veselit, për të mos pranuar disa
4 dëshmi të Dëshmitarit 4500, së pari çështja procedurale, sa i
5 përket çështjet procedurale, Mbrojtja duhet ta kishte ngritur
6 këtë kundërshtim në kohë të përgjigjes 154. Nuk e ka bërë këtë
7 dhe nuk ka treguar arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit
8 kohor. Përsërisim këtu se në parim palët pritet të përgjigjen
9 në kohë në afatet e caktuara, dhe kjo nuk ka ndodhur në këtë
10 rast.

11 Kërkesa është në fakt kërkesë për rivlerësim të vendimit
12 tonë F02816, kriteret dhe standardi i të cilit nuk është
13 zbatuar apo përmbushur nga Mbrojtja. Megjithatë, Trupi Gjykses
14 sipas kompetencës së tij pajtohet të marrë parasysh argumentet
15 e paraqitura me vonesë përpara tij nga Mbrojtja e Veselit.

16 Pjesa e provave të cilën Mbrojtja e z. Veseli kundërshton
17 është relevante dhe përmbush kriteret për pranim sipas
18 rregullës 154 dhe 138. Sa i takon relevancës, provat e
19 kundërshtuara tregojnë se mund të jetë një përpjekje për të
20 ndërhyrë në historinë, tregimin e dëshmitarit dhe të një
21 personi tjetër, [REDAKTUAR], të cilët ishin dëshmitarë të
22 krimeve që pretendohet të kenë ndodhur në këtë rast. Kjo, këto
23 prova janë relevante të paktën për vlerësimin e --
24 mbështetshmërisë dhe besueshmërisë së deklaratës së dhënë neve
25 lidhur me atë që i ka ndodhur [REDAKTUAR] dhe atyre për të

1 cilët thuhet që ai, me të cilët ai është marrë dhe me të cilët
2 është vrarë.

3 Sa i takon paragjykimin, baza për këtë është se individët
4 në fjalë ishin pjesë të SHIK-ut dhe mund të trajtohet në
5 marrjen në pyetje nga pala e kundërt.

6 Me këtë përfundon urdhri gojor.

7 Mund të sjellim dëshmitarin në sallë.

8 [Mikrofoni çaktivizuar].

9 Ka diçka -- znj. Rowan, sa kohë keni nevojë, pak a shumë?

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do të, ka mundësi t'i kërkoj
11 Trupit Gjykses kohë shtesë. Kolegët e mi, ndërkohë, nëse kjo
12 mund të ndihmojë, nuk do të përdorin të gjithë kohën që kanë
13 kërkuar.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
16 mund të uleni.

17 Dëshmitar, do vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtja e
18 Veselit.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

20 PY. Mirë se vini përsëri, z. Dëshmitar. Duke vazhduar aty ku
21 e lamë para pushimit, më duket që keni, shihni dokumentin në
22 ekran.

23 PË. E shoh.

24 PY. Shikojeni një herë përpara që të shkojmë më tej. Ju
25 kujtohet që përpara pushimit po shpjegonit, po shpjegonit

1 llojin e përcaktimeve të aleleve që pritej të gjenit në
2 raportin tuaj. Këto përcaktime të aleleve priten të gjendeshin
3 në numra të plotë.

4 Po të shohim këtë rresht, shohim me një përjashtim që
5 kemi numra të plotë. Është e saktë?

6 PË. Saktë.

7 PY. Dhe ju thatë që mund të prisnit që në një raport të tillë
8 kjo të ndodhë.

9 PË. Po.

10 PY. Dhe ju na nënvizuat faktin që përjashtimi në këtë është
11 TH01 dhe ne e kemi në 3.

12 PË. Saktë.

13 PY. Sa i takon numrave vetë, pra përveç pritshmërisë së
14 rezultateve të tilla, numrat e plotë, a është e saktë të themi
15 që kur shikojmë lokuset pritet që shifrat të jenë 10-plus?

16 PË. Po. Më falni, a mund ta përsërisni pyetjen?

17 PY. Ishte pyetja e bërë mbrapsht, ndoshta përveç pritjes së
18 numrave, prtishmërisë, pra, të numrave të plotë, pra llojit,
19 tipat e llojit të numrave që mund të presim janë numrat mbi
20 10, jo poshtë 10? A pajtoheni me këtë, zakonisht?

21 PË. Kjo varet nga lokusi.

22 PY. Për këtë lokus që po shohim tani e kam fjalën.

23 PË. Në qoftë se shohim tek këto, shohim që është 8-9 që nuk
24 është e pazakontë. Mund të shënoj këtë.

25 PY. Ju lutem bëjeni këtë gjë.

1 PË. Pra kemi 8 këtu, kemi 8 këtu, kemi 9 këtu. Dhe varet
2 shumë -- në të tretin kemi 9, pra është numër që është thjesht
3 pasqyrim i numrit të përsëritjes.

4 PY. Po.

5 PË. Në atë pjesë, në atë copëz të ADN-së dhe kjo varet nga
6 lokusi dhe sa shumë prej tyre ne shohim.

7 PY. Një shembull tjetër ndoshta është e treta. Pjesa e tretë.
8 Ku kemi D21S11. Dhe për këtë për këtë lokus pritet numri mbi
9 20 zakonisht. A është kështu?

10 PË. Tipikisht po.

11 PY. Pra, kur shohim rezultatet e këtij lokusi në veçanti
12 pritet që të shohim numrat mbi 20, është ajo që shohim këtu në
13 fakt?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe zakonisht kur kemi përjashtimin e D7 të cilit ju e
16 përmendët, por pajtoheni që pjesa më e madhe e këtyre, lokusit
17 që pritet është një shifër mbi 10?

18 PË. Ky është në përgjithësi, ky është profil tipik që presim,
19 nuk ka asgjë të pazakontë në këtë profil.

20 PY. Kjo ishte pyetja ime e radhës. Pra, duke parë këtë lloj
21 të shifrave, llojet e numrave, pra, pritet që rezultati në
22 këtë tabelë të jetë kështu, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe duke parë këtë raport a jeni në gjendje të deduktoni,
25 pra, që paketa e testit që është përdorur në, ka qenë

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 73

1 PowerPlex 16 duke parë lokusin me të cilin po merremi?

2 PË. Po.

3 PY. Por nuk mund ta dini a është e saktë, por është e
4 mundshme që të ketë qenë kështu?

5 PË. Është shumë e mundshme dhe kjo është, që ky është
6 shpjegimi i këtyre lokuseve, pra.

7 PY. Po.

8 PË. Dhe këto janë lokus që PowerPlex 16 ka analizuar.

9 PY. Saktë.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Tani përpara se shkojmë më tej në
11 këtë raport, së pari do të doja që të ruajmë atë për
12 procedurë, ndoshta harrova ta bëj një gjë të tillë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është, po e
14 dorëzoni, pra, si provë dhe ne do të vendosim në lidhje me
15 këtë më vonë. A mund të --

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Raporti shoqërues, nëse raporti
17 shoqërues pranohet në ato rrethana do të kërkojmë në atë rast,
18 do të kërkojmë që të dorëzojmë si provë edhe kopjen e shënuar.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
20 përsërisni numrin, ju lutem?

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ky është ekstrakti P854, faqja
22 197, por unë thjesht po kërkoj që të shënohet, t'i jepet numër
23 provizor fotografisë së bërë në këtë pjesë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Numri është -
25 - mund t'i jepni një numër provizor, znj. Sekretare,

1 dokumentit P854, faqe 197.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet e bëra nga
3 Dëshmitari 4875 në faqen 197, prova materiale P00854, do të
4 regjistrohen me numrin e -- do t'ju jepet numri provizor
5 2D0035. Klasifikimi konfidencial. Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
7 vazhdoni.

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Përpara se të heqim këtë ekran, a
9 mund të shfaqim, të shohim më qartë pjesën e djathtë poshtë të
10 tekstit? Në fund të faqes. Në qoftë se mund të zmadhojmë
11 pjesën e shkruar në fund të faqes.

12 PY. Z. Dëshmitar, kjo është thjesht për të konfirmuar që
13 është një prej raporteve që shikuat më herët, i cili thatë që
14 jepte, mbështeste në mënyrë të moderuar konstatimet e bëra.
15 PË. E saktë.

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mund ta heqim nga ekranin. Kërkoj
17 ndjesë.

18 PY. Z. Dëshmitar, u aludua në disa raste informacioneve të
19 cilat nuk i keni ju, do të doja të merresha me këtë pak, por
20 konkretisht impakti që ka kjo dhe kufizimet që kjo kishte në
21 mundësinë tuaj për të analizuar dhe komentuar në tërësinë e
22 dokumenteve që ju janë dhënë.

23 Duke u kthyer tek këto EPG-të, që të jemi të qartë, a
24 është e saktë që ju nuk keni një profil ADN-je të plotë që
25 njihet si EPG të ndonjërit prej kampioneve në këtë rast?

1 PË. E saktë. Nuk kam parë ndonjë EPG që lidhet me këto raste,
2 me këto çështje.

3 PY. Në të gjitha këto raste të gjithë, ajo që kemi ne është
4 një dokument i ngjashëm me atë që kemi parë në ekran. Që është
5 përmbledhja e raportit të testeve të bëra.

6 PË. E saktë.

7 PY. Dhe a është e saktë që ju e keni ngritur këtë çështje me
8 Prokurorinë në raportin tuaj, keni theksuar faktin që mungonte
9 EPG-ja në këtë rast, a është kështu?

10 PË. Nuk më kujtohen hollësitë, por besoj që është e arsyeshme
11 tani kështu.

12 PY. Është e saktë që kjo doli në pah menjëherë që kjo
13 mungonte, dhe Prokuroria e di që ky informacion mungonte dhe
14 ju i keni informuar Prokurorinë që ju prisni që ky informacion
15 të vihej në dispozicion tuaj.

16 PË. Nuk më kujtohen komunikimet, hollësitë e komunikimeve me
17 Prokurorinë lidhur me këtë pikë, nuk më kujtohen këto hollësi.

18 PY. Është në paragrafin 12.

19 PË. E pranoj këtë që thoni ju, por nuk më kujtohen hollësitë.

20 PY. Faqja 12, paragrafi 12, për ata që po na ndjekin, ju në
21 raportin tuaj i jeni referuar profileve të ADN-së si të
22 kriptuara. A pajtoheni që çështja e EPG-së apo profilit të
23 ADN-së nuk është çështje kriptimi, thjesht nuk i kemi ato
24 fare. Nuk kemi profilet e ADN-së apo EPG-të që i janë
25 nënshtruar enkriptimit.

1 PË. Nuk kemi profilet e ADN-së nga të cilat raportet janë
2 bazuar.

3 PY. Është çështje terminologjie. E kuptoj këtë. Nuk është
4 çështje, pra, që ato dosje në kompjuterin tuaj nuk kanë EPG-
5 të.

6 PË. Saktë.

7 PY. Ju nuk mund t'i deshifronit, pra që t'i bënit të
8 lexueshme, nuk i keni ato, thjesht nuk i keni.

9 PË. Nuk i kam.

10 PY. Dhe ato EPG dhe profilet janë diçka që një ekspert duhet
11 t'i ketë në -- t'i shohë në raportin e një kolegu tjetër
12 ekspert, apo jo?

13 PË. Kjo është raport i ndërlidhjes, pra tipikisht do t'i
14 shihja pak më me distancë, nuk do të prisja detyrimisht që ato
15 të ishin në raport, por do të ishin të disponueshme për
16 vlerësimin apo analizën.

17 PY. Do të prisni që ato të ishin në dispozicionin tuaj nëse
18 ju i kërkoni ato?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe ju do të prisnit që ato të bëhen, të vihen në
21 dispozicionin tuaj nëse kërkohen për të bërë analiza?

22 PË. Nëse i kërkuj, po.

23 PY. Tani sa i përket ndikimit të mungesës së këtyre
24 raporteve, pajtoheni me mua që -- se për shkak se nuk kishit
25 qasje në këto EPG, dhe nuk mund ta thoni sepse ju nuk i keni

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 77

1 analizuar ato, profilet e ADN-së ishin të nxjerra në mënyrë të
2 saktë?

3 PË. Nuk mund të komentoj apo të them nëse ato janë
4 interpretuar në mënyrë të saktë.

5 PY. Dhe nuk mund të konfirmoni apo të komentoni nëse bëhet
6 fjalë këtu për një burim të vetëm të ADN-së me të cilën jemi
7 marrë përpara për këtë arsye?

8 PË. Nuk pres që të jenë të përzier siç e thamë më herët.

9 PY. Dhe ju nuk mund të bëni një vlerësim të nivelit të
10 pasurisë apo cilësisë së kampionëve të ADN-së që janë nxjerrë.

11 PË. Nuk mundem.

12 PY. Dhe një herë në kontekstin, pra ishte raporti jua i dytë
13 që keni pasur, raporti vijues.

14 PË. Po.

15 PY. Kishit patur një telefonatë me ata lidhur me raportin i
16 cili --

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
18 përgjigjeni me po ose jo.

19 DËSHMITARI: Po.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

21 PY. Dhe në mars 2023, njëra prej gjërave që ju keni shpjeguar
22 atyre në atë kohë është se nuk ishit në gjendje të dëshmonit
23 lidhur me cilësinë e profileve të ADN-së të siguruara nga, të
24 prodhuara nga laboratorit në fjalë për raportin.

25 PË. E saktë.

1 PY. Dhe kjo është po ashtu e vërtetë për të gjitha, vlen për
2 të gjitha raportet?

3 PË. Po.

4 PY. Tani, lidhur me mungesën e EPG-së, pa këto ju nuk ishit
5 në gjendje të konfirmoni se ndonjëra prej përcaktimeve të
6 aleleve në rezultatet e testeve, në tabelat që pamë, janë të
7 sakta. Pajtoheni me këtë?

8 PË. Nuk mund ta verifikoj këtë pa EPG-të.

9 PY. Pra, që ta bëjmë më të qartë, ju shihni rezultatet e
10 testeve, por nuk jeni në gjendje të, t'i merrni ato rezultate
11 të testeve, të shkoni tek profili origjinal i ADN-së dhe të
12 verifikoni nëse ato janë të sakta? Pra, nuk mund të bëni
13 analizën, a është e saktë?

14 PË. E saktë.

15 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj këtë. Kjo është bërë, kjo
16 pyetje është bërë në forma të ndryshme, në mënyrë të
17 përsëritur. Dëshmitari ka shpjeguar që, pikëpamjen e tij dhe
18 pasojat apo ndikimin e kësaj.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kemi
20 dëgjuar këtë disa herë, kështu që mund të kalojmë tek pika
21 tjetër.

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

23 PY. Ju nuk mund të thoni, pra që pa këto -- pra nuk mund të
24 thoni se çdo [E pakuptueshme] të sakta apo jo?

25 PË. E saktë.

1 PY. Pra, ju nuk keni patur qasje në kriteret apo pragjet e
2 detektimit të aleleve të përdorura nga laboratorët, është e
3 saktë?

4 PË. E saktë.

5 PY. Tani, çfarë është, për çfarë bëhet fjalë kur flasim për
6 një prag të detektimit të aleleve?

7 PË. Është sasia, nëse po flasim për nivele më të lartë, të
8 elektroferogrameve. Është pika më e lartë pra, sasia më e
9 madhe që kemi për të arritur me qëllim që të pranojmë se
10 ekziston, si sasi më e lartë e mundshme e një artefakti.

11 PY. Pra, për secilën prej aleleve keni një nivel lartësie që
12 duhet të përmbushet përpara se ta merrni parasysh atë?

13 PË. E saktë.

14 PY. Dhe kjo, ky prag duhet të arrihet në mënyrë që të merren
15 parasysh për analiza.

16 PË. E saktë.

17 PY. Dhe neve nuk e dimë cili ka qenë ky prag që është
18 përdorur, nuk kemi qasje në këtë?

19 PË. Saktë.

20 PY. Dhe laboratorë të ndryshëm përdorin pragje të ndryshme?

21 PË. E saktë.

22 PY. Dhe ju, ne nuk e dimë cili prag është përdorur për këto
23 teste, në këto laboratorë, pajtoheni?

24 PË. Pajtohem.

25 PY. Dhe si e tillë në, që pozitën ku jeni ju po e them për

1 herë të tretë, ju nuk jeni në, nuk keni mundësi që të
2 konfirmoni apo jo saktësinë e pragut të aleleve të përdorur?

3 PË. E saktë.

4 PY. Dhe datat, të dhënat bruto që neve na mungojnë pra. E
5 para, këtyre të dhënave është e saktë, apo jo, është që juve
6 nuk ju është dhënë ndonjë, nuk ju është siguruar ndonjë nga
7 shënimet e bëra nga laboratorët që kanë punuar me këto
8 kampione. Është e saktë?

9 PË. E saktë.

10 PY. A ju është bërë pyetja, ju është dhënë juve ndonjë nga
11 shënimet e laboratorëve, shënimet punuese, informacioni që ju
12 prisni të gjenit në to?

13 PË. Ato zakonisht përmbajnë nxjerrjet që janë bërë,
14 metodologjia e përdorur, për shembull.

15 PY. Dhe ju e mblidhni këtë informacion nga ata?

16 PË. Po.

17 PY. Pajtoheni, pra, që standardi, si standard që shënimet e
18 laboratorëve shpesh përdoren, mund të jenë shpesh 7 apo 8
19 faqe?

20 PË. Kjo varet shumë --

21 PY. Ndryshon?

22 PË. Dhe varet shumë edhe nga ajo që po shqyrtojmë. Për
23 shembull, do të -- unë do prisja që ata të jenë sa më të saktë
24 edhe koncizë sepse është i njëjti proces që përsëritet në
25 mënyrë -- disa herë.

1 PY. Po, sepse mungesa e këtyre shënimeve, në mungesë të
2 këtyre shënimeve nuk mund të analizohet informacioni?

3 PË. Kjo e saktë.

4 PY. Ne -- pra, përveç kësaj, në punën që është bërë
5 shkencëtarët nuk merren vetëm me kampion të panjohur, merren
6 edhe me kampionë të familjeve, të familjarëve, duke shpresuar
7 që identifikojnë, me shpresën për të identifikuar një pjesëtar
8 të familjes?

9 PË. E saktë.

10 PY. Pra, në të dhënat kemi, përmendet edhe lidhjet familjare,
11 pjesëtarë të familjes që kanë dhënë kampion për t'u testuar?

12 PË. E saktë.

13 PY. Për t'u krahasuar me kampionët e panjohur?

14 PË. E saktë.

15 PY. Dhe sa i takon këtyre kampionëve ne nuk e dimë kur, ku
16 dhe si janë marrë? Nuk dimë asgjë për këta kampionë, se nga
17 vijnë ata?

18 PË. Nuk më është dhënë një informacion i tillë.

19 PY. Për pjesën më të madhe të raporteve që kemi shikuar, këto
20 nuk -- duke mos përfshirë katër raportet të cilat janë temë e
21 një -- që janë pjesë e një raporti eksperti më të madh, a vlen
22 ky dallim? Jam e vetëdijshme për personat që përfshihen këtu.

23 PË. Po.

24 PY. Pra, për këto raporte, përveç atyre katër raporteve të
25 tjera --

1 PË. Po.

2 PY. -- nuk dimë nëse duke parë dokumentet?

3 PË. Është e saktë.

4 PY. Pra, duke u marrë vetëm me ato dy kategori të
5 dokumenteve, brenda materialit që juve ju është dhënë, kemi
6 përmbledhje të raporteve, disa raporteve, në formatin që kemi
7 parë, dhe pastaj kemi atë që ndoshta mund ta quajmë si një
8 nënkategori e atyre, edhe kjo ka qenë pjesë e raportit të
9 ekspertit nënshkruar nga tre persona.

10 PË. Në rregull.

11 PY. A ju kujtohen raporti, a ju kujtohet raporti shtesë në
12 materialet që ju janë dhënë juve, që ju janë siguruar?

13 PË. Nuk më kujtohet.

14 PY. Ndoshta mund t'jua tregoj që t'ju ndihmojmë.

15 PË. Në rregull.

16 PY. Që t'ju kujtohet.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në
18 ekran atëherë dokumentin P855, ju lutem.

19 PY. Janë dy raporte në fakt.

20 PË. Në rregull.

21 PY. Janë së bashku në formatin PDF dhe janë dy raporte të
22 vitit 2004, të dyja të nënshkruara nga tre persona.

23 PË. Në rregull.

24 PY. Duke parë faqen e parë, ju kujtohet që keni parë këtë
25 raport eksperti në të dhënat që ju janë dhënë, si pjesë e

1 dokumenteve që ju janë dhënë?

2 PË. Kam, më kujtohet pak. Kjo ka ndodhur para shumë kohësh.

3 PY. Dhe arsyeja që bëjmë ne dallimin me këto raporte është
4 sepse informacioni, sepse ka më shumë informacion në
5 dispozicion, apo jo, lidhur me testet në raportet se sa ai që
6 ishte në dispozicion, informacion në dispozicion për raportet
7 e tjera dhe -- apo dëshironi që të, t'ju jepet më shumë kohë
8 që ta shikoni atë?

9 PË. Do të kisha nevojë ndoshta që gjatë pushimit të drekës të
10 më jepet mundësia ta shoh më nga afër dhe që të trajtoj këtë
11 çështje më vonë.

12 PY. Faleminderit.

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Znj. Sekretare, në qoftë se mund
14 ta shfaqim dokumentin U015-4164.

15 PY. Z. Goodwin, ndërkohë që kjo po shfaqet në ekran, kjo
16 është një prej tabelave të rezultateve që kemi shikuar sot në
17 mëngjes.

18 PË. Në rregull.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Dhe ndoshta mund të kemi raportin
20 e z. Goodwin në faqen 6, në ekranin e ndarë. As kjo nuk është
21 për shfaqje publike.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mund të na e jepni
23 numrin ERN të dokumentit të parë, ju lutem?

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] U015-4164. Faleminderit. Raporti
25 ka numrin provizor 1951. Në qoftë se mund të shfaqim faqen 6

1 të raportit në anën, në krahun e majtë, dhe të lëvizim më
2 poshtë që të shohim tërësinë e pyetjeve dhe përgjigjeve dhe
3 raportin në anën, në krahun e djathtë. Lëvizim pak me qëllim
4 që pjesa e parë e tabelës të jetë në qendër. Kështu,
5 faleminderit. Kërkoj ndjesë.

6 PY. Z. Goodwin, ky ishte njëri prej raporteve që ju jeni --
7 që juve ju është kërkuar të trajtoni, dhe ju janë bërë pyetje
8 konkrete lidhur me këtë.

9 PË. Saktë.

10 PY. Ne i shohim këto pyetje në anën e djathtë -- në anën e
11 majtë të ekranit. Tani kolegu im i Prokurorisë iu orientoi
12 juve tek këto përgjigje sot në mëngjes, sidomos tek pyetja
13 (iv). Do të doja të merresha pak më shumë në hollësi lidhur me
14 këtë. Juve u pyetët:

15 "Ky raport a duket se përmbush standardet relevante që
16 kërkohen për një dokumentacion të tillë -- apo përcaktim të
17 tillë?"

18 Dhe komenti juaj ishte se ka aspekte të pranishme që ju i
19 prisnit t'i shinit dhe thatë:

20 "Megjithatë, disa elemente të raportit janë të
21 debatueshme dhe profilet e viktimave dhe të pjesëtarëve të
22 familjes janë të enkriptuar, pra nuk mund të shohim lokuset që
23 janë testuar apo identitetin e aleleve, dhe si e tillë nuk
24 është e mundur të ribëhet analiza e tyre.

25 "Kur bëhet përlllogaritja e shkallës së gjasave, një

1 databazë e referencës, do të duhej të ishte përdorur për të
2 bërë vlerësimin e domethënies së aleleve që, të përbashkëta.
3 Ky informacion nuk është përfshirë në këtë raport dhe për
4 rrjedhojë nuk mund të komentojnë mbi saktësinë e tij.”

5 Është e saktë, pra, që në përgjigjen tuaj ndaj pyetjes së
6 Prokurorit lidhur me -- në raportin tuaj, ju nënvizuat tre
7 pika të cilat ju identifikoni si të pazakonta në këtë raport.
8 A është e saktë?

9 PË. Kjo është e saktë.

10 PY. Pra, kemi mungesën e profileve të ADN-së, mungesën e
11 lokuseve të caktuar dhe mungesën e informacionit lidhur me
12 databazën referencë.

13 PË. E saktë. E kam fjalën duke pasur parasysh natyrën e
14 programit të identifikimit, kuptoj që databaza referencë nuk
15 është këtu dhe mund të jetë për shkak se është, gjendej në një
16 marrëveshje, në një dokument marrëveshje gjithëpërfshirëse për
17 elementë të tjerë për të cilat pajtohem.

18 PY. Tani duke marrur, që të merremi me mungesën e lokuseve,
19 pozicionimeve pra në gen, dhe çfarë do të thotë me këtë, çfarë
20 kuptojmë me këtë. Nëse shikojmë raportin shohim në anën e
21 djathtë, pra menjëherë dallojmë se ky duket ndryshe nga
22 raporti i fundit që kemi parë dhe rreshti i parë për lokusin
23 në vend të numrave TH01, DS, DT, që po shihnim më herët, tani
24 kemi ICMP 1, 2, 3, 4, 5, 6. Është e saktë?

25 PË. Është e saktë.

1 PY. Tani rreshti ku është identiteti i lokuseve duhet të jetë
2 i pranishëm siç ishte i pranishëm në raportin e fundit që
3 pamë.

4 PË. Kjo do të ishte normale, po.

5 PY. Por ne nuk shohim asnjë nga ky informacion lidhur me
6 lokusin në këtë raport.

7 PË. E saktë.

8 PY. A është hequr, redaktuar, nuk është raportuar?

9 PË. E saktë.

10 PY. Shohim që ka 16 lokus që janë ekzaminuar.

11 PË. E saktë.

12 PY. Por thjesht nuk mund të dimë në mënyrë definitive cila
13 prej lokuseve që kemi shikuar është analizuar apo marrë
14 parasysh, sepse raporti nuk na e thotë neve këtë gjë.

15 PË. E saktë.

16 PY. Zakonisht ne pritet që të shohim lokusin në raport siç
17 është këtu, në mënyrë që ju të keni mundësi të analizoni në
18 tërësi rezultatet.

19 PË. Kjo do të ishte tipike.

20 PY. Dhe mungesa e lokuseve në këtë rast ju parandalon juve që
21 të bëni një rivlerësim apo vlerësim të vlefshmërisë apo
22 natyrës së këtyre konstatimeve. Është e saktë?

23 PË. E saktë.

24 PY. Tani do të doja të merresha me në këtë raport, do të
25 merresha me një pikë tjetër.

1 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në qoftë se mund të zmadhojmë pak,
2 ju lutem që të shohim në mënyrën më të qartë. Po shohim ICMP 1
3 deri në 6, ju lutem.

4 PY. Tani ju thatë lidhur, duke iu përgjigjur pyetjeve të
5 Prokurorisë pak më parë, shprehja që ju përdorët është që këto
6 nuk janë emra normalë që shohim të pasqyruar në alele.

7 PË. E saktë. Dhe përcaktimi i aleleve apo emrave, emërtimi i
8 përdorur, nuk është tipik.

9 PY. Do të doja që të, t'ju bëj disa pyetje më shumë lidhur me
10 këtë. Pra siç thatë ju, sipas mendimit tuaj, përcaktimi apo
11 emërtimi i aleleve është jonormal.

12 PË. E saktë.

13 PY. Që ta kuptojmë më qartë, atë që po shihnim më herët,
14 përcaktimi, emërtimi i aleleve janë këto numrat që po shohim,
15 4.5, 1.8, 1.6, 1.9, saktë?

16 PË. Saktë.

17 PY. Atëherë, emërtimi i aleleve që paraqiten në këtë raport
18 janë shumë të debatueshme dhe, dhe jo ajo që ju do të prisnit
19 për të, në një tabelë të përcaktimeve apo emërtimeve të
20 aleleve të tillë si kjo.

21 PË. E saktë.

22 PY. Tani shikojmë pak pse janë kaq të pazakonta. Janë të
23 pazakonta sepse siç e shpjeguat më herët pritet që të shihen
24 STR të përsëritura në mënyrë disa herë e 4, e pasqyruar si
25 numra të plotë, ndoshta me .2, dhe rrallëherë por disa herë,

1 si .1 -- a .1, a .3, dhe shumë rrallë a .4, asnjëherë a .4 në
2 fakt.

3 PË. E saktë.

4 PY. Mbi a .4.

5 PË. E saktë.

6 PY. Dhe kur kemi këtu, ajo që kemi këtu është a. 5, a. 8, a
7 .9, a .6, a .5, .9?

8 PË. E saktë.

9 PY. Pra, pjesa më e madhe e shifrave që shohim në ekran në
10 kolonën aty janë të pazakonta.

11 PË. E saktë.

12 PY. Arsyeja -- për këtë arsye, pra.

13 PË. Po.

14 PY. Do të doja të flisnim pak lidhur me këtë. Ju keni bërë
15 supozim që mund të jenë të koduara, saktë?

16 PË. Saktë.

17 PY. Pra këtë supozim se mund të jenë të koduara ju e keni
18 bërë se nuk i shpjegonit dot këto shifra, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Një shpjegim i mundshëm mund të ishte që mund të jenë të
21 koduara.

22 PË. Po.

23 PY. Por ama nuk e dini me siguri a janë të koduara apo jo.

24 PË. Nuk e di me siguri por nuk janë pjesë e një profili
25 normal STR.

1 PY. Shohim pjesën e parë, pra si pikënisje mund të themi që
2 ky nuk është një profil normal STR.

3 PË. Po.

4 PY. E pazakontë?

5 PË. Po.

6 PY. Nuk keni asnjë informacion për punën që është bërë,
7 metodologjinë në bazë të këtyre profileve, për t'ju ndihmuar
8 ju që të kuptoni pse është kaq e pazakontë?

9 PË. Pajtohem.

10 PY. Mund të jetë e koduar. Edhe të pajtohem që ky është
11 spekulim, se nuk e dimë me siguri. Por e zëmë se është e
12 koduar, ne nuk e dimë natyrën e kodimit?

13 PË. Jo.

14 PY. As çfarë nënkuptojnë shifrat e kodimit?

15 PË. Jo. Jo, në qoftë se nuk e çkodojmë.

16 PY. Por hajde e themi qorrazi, çfarë metodologjie është
17 përdorur për këtë?

18 PË. Jo, nuk mund të themi me siguri se cili është profili në
19 bazë.

20 PY. Pra ne mund të themi që ky raport në vetvete është shumë
21 i pazakontë dhe nuk e dimë pse është i pazakontë.

22 PË. Po.

23 PY. A keni parë ndonjëherë shifra të këtij lloji në raporte
24 të ngjashme?

25 PË. Jo, nuk i kam parë ndonjëherë.

1 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Që ta kuptojnë dhe personat që po
2 na ndjekin. E mbajmë pjesën e djathtë në ekran, dhe heqim për
3 një çast raportin edhe shohim edhe një herë në ekran provën
4 materiale P854 në faqen 197, përbri materialit ekzistues.
5 Zmadhojmë pjesën lart në të djathtë.

6 PY. Z. Dëshmitar, ky është raporti që pamë dhe më herët. Për
7 të cilin thatë se ka shifra --

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Dhe një herë majtas, ju lutem. Dhe
9 pak më djathtas. Që të shohim disa më shumë, disa pjesë më
10 shumë.

11 PY. Shohim të majtën, raporti që pamë më herët kishte llojet
12 e rezultateve që ju si rregull duhet t'i kishit. Dhe në të
13 majtë janë gjetjet që janë të pazakonta. Dhe është e qartë dhe
14 dallimi në fakt mes këtyre dy rezultateve.

15 PË. Po.

16 PY. Faleminderit.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Sekretares së seancës, hiqeni
18 raportin që është në të majtë që sapo pamë. Edhe nxjerrim
19 sërish raportin e z. Goodwin në faqen 11.

20 PY. Z. Dëshmitar, ndërkohë që presim materialin, a mund t'ju
21 pyes, gjatë seancën përgatitore i keni thënë Prokurorisë se me
22 sa keni kuptuar ju asokohe, ka qenë praktikë e KNKK-së të
23 kodonte materialet.

24 PË. Po.

25 PY. Por kur e keni mësuar këtë?

1 PË. Po kam punuar për 20 vjet në këtë fushë, dhe e di që e
2 kam bërë edhe në të shkuarën diçka të ngjashme.

3 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Presim pak të dali materiali në
4 faqen 11.

5 PY. A pajtoheni me mua kur që shohim raporte të këtij lloji,
6 si raporti në të djathtë ku ka përcaktime, alele të pazakonta,
7 pra, ekziston një arsye e vlefshme për të vendosur në
8 pikëpyetje rezultatet sepse janë nuk janë të zakonshme?

9 PË. Po, janë të pazakonta.

10 PY. Pra duke qenë të pazakonta, a nuk mendoni ju se duhet
11 shqyrtuar më tej pse janë këto përfundime?

12 PË. Të paktën do na ndihmonte të dinim çfarë lloj kodimi
13 është përdorur.

14 PY. Me siguri. Ose, mbase nuk është kodimi arsyeja pse
15 shfaqen kështu, sepse ne nuk e dimë këtë. Por, ju si ekspert
16 doni ta kuptoni si janë caktuar këto shifra?

17 PË. Po.

18 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Tani jemi në faqen 11 të raportit.

19 PY. Flasim pak për këtë. Raportet e kësaj natyre, si raportet
20 që ju keni parë, heqim katër raportet që folëm më herët. ZPS-
21 ja në udhëzimet e veta ju ka kërkuar siç mund ta shihni këtu
22 në fakt, e kemi në faqen 11. Keni emrat e viktimave këtu. Për
23 secilën viktimë ka një raport që është i ngjashëm me raportin
24 që po shohim tani në të djathtë të ekranit?

25 PË. Po.

1 PY. Ju janë bërë disa pyetje të përgjithshme fillimisht, që
2 vlejné për të gjitha raportet.

3 PË. Po.

4 PY. Dhe këto pyetje ishin, për shembull, nëse këto raporte
5 kanë respektuar standardet për një dokumentim të këtij lloji
6 dhe nëse këto raporte përmbajnë përfundime që mbështeten me
7 informacionet që përmenden në materialet në fjalë. Dhe mund ta
8 shohim në fund të faqes 11 në ekranin tonë, se ju i jeni
9 përgjigjur kësaj pyetje në mënyrë kolektive, për të gjitha
10 raportet të marra së bashku, kështu?

11 PË. Po.

12 PY. A është e vërtetë, pra, që përgjigja juaj vlen për të
13 gjitha raportet që janë të renditura për viktimat?

14 PË. Po.

15 PY. Po dhe për raportin në fakt që po shohim tani që nuk
16 është pjesë e listës, a pajtoheni?

17 PË. Po.

18 PY. Pra, të gjitha raportet që kishin këtë tabelën në faqen e
19 -- [Mikrofoni çaktivizuar].

20 Sa i takon pyetjes së parë, nëse këto raporte kanë
21 respektuar apo jo standardet në fuqi që nevojiten për
22 dokumentim të këtij lloji. Shohim pak përgjigjen tuaj. Një nga
23 konstatimet që keni bërë ju është që këto janë raporte
24 përmbledhëse. Pra, a kemi kuptuar ne drejt që në vetvete këto
25 nuk janë raporte, por një përmbledhje raportesh?

1 PË. Në fakt unë besoj që ky është raporti.

2 PY. Pra ju po thoni që kjo është një akt-ekspertizë, por
3 thjesht e shkurtër?

4 PË. Po.

5 PY. Ne mund të flasim dhe për dallime midis raportit të
6 thelluar si raporti që pamë në ekran, edhe një raporti të
7 shkurtuar.

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Megjithatë, shohim raportin në
9 faqen 12 çfarë keni thënë ju në një përgjigje tuajën.

10 PY. Çfarë keni thënë ju për raportet e marra së bashku. Ju
11 këtu keni thënë, keni përmendur tri elementë që keni
12 evidentuar në raporte që nuk janë standarde sipas mendimit
13 tuaj.

14 PË. Po, pajtohem.

15 PY. Shkurtimeisht, sepse kemi trajtuar tashmë pjesën më të
16 madhe. E para, ju keni thënë nuk është dhënë informacion mbi
17 metodologjinë për analizimin e mostrave.

18 Së dyti, profilet e ADN-së janë të koduara dhe kjo nuk të
19 lejon të rivlerësosh edhe një herë të dhënat dhe profilin e
20 ADN-së, dhe nuk është e mundur të bëhet rivlerësim
21 statistikor. Edhe një element tjetër që i paqartë është kush i
22 ka nënshkruar këto raporte. Është një nënshkrim por nuk i
23 atribuohet personit.

24 PË. Po.

25 PY. Pra, siç dhe thatë, këto tre elementë vlejné për të

1 gjitha raportet që janë si raporti që po shohim në të djathtë?

2 PË. Po.

3 PY. Mbi të gjitha, edhe më tej ju keni pasur dy shqetësime të
4 tjera. Një, fakti që përcaktimi i aleleve është shumë i
5 pazakontë, saktë?

6 PË. Unë po jua them me besim që kjo është për shkak të
7 kodimit dhe kodimi për mua është i pazakontë.

8 PY. Edhe gjithashtu është kodimi i pozicionimit të gjeneve.

9 PË. Po.

10 PY. Kështu që mund t'ia shtojmë edhe këto dy elementet.

11 PË. Por besoj që kodimin e kam përfshirë tek shqetësimet e
12 mia në pikën 2. Supozojmë se është kodim gjithmonë.

13 PY. Pra, kur keni thënë kodimi i profileve, ju nuk e keni
14 pasur fjalën për kodimin e EPG-ve?

15 PË. Jo, jo. E kam fjalën e të dhënave që shohim në raporte.

16 PY. Pra, mund të shtojmë këtu në listë edhe faktin që
17 mungojnë EPG-të?

18 PË. Po.

19 PY. Sa i takon raportit në fjalë, këtij raporti. E lëmë
20 mënjane raportet e marra së bashku dhe flasim për raportin
21 konkret që kemi në ekran.

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shohim faqen 6 të raportit tuaj.
23 Më intereson pyetja 3 këtu.

24 PY. Folëm dhe më herët që dhe ju iu janë bërë disa pyetje
25 konkrete për disa raporte, dhe më pas janë grupuar pyetjet.

1 PË. Po.

2 PY. Por një nga pyetjet që ju është bërë në këtë raport
3 është:

4 "Nëse informacioni që përmbahet në këtë raporte mbështet
5 përfundimet që gjenden në raport?"

6 Dhe unë dua të shikoj çfarë keni thënë ju. Shohim pjesën
7 e parë të përgjigjes suaj. Ju keni thënë:

8 "Sa i takon për aq sa mund ta interpretojmë raportin,
9 rezultatet mbështetin konkluzionet dhe përlllogaritja është e
10 saktë."

11 A mund ta themi në një formë tjetër, pra, nëse rezultatet
12 e përfshira në raport janë të sakta, atëherë përfundimet janë
13 të sakta?

14 PË. Sigurisht, kjo është logjike.

15 PY. Pra, duhet të -- ka një gjë në atë përgjigje ku ju keni
16 dashur ta thoni, ka një nëntekst ku keni dashur të thoni që
17 nuk mund të bëjmë verifikim.

18 PË. Po.

19 PY. Pra, ju vetë e keni thënë këtë nënkuptim, këtë nëntekst
20 kur keni thënë: "Me aq sa mund të interpretoj ..."

21 PË. Po.

22 PY. Pra, ana matematikore, përlllogaritja është bërë e saktë,
23 por ne nuk e dimë se çfarë është?

24 PË. Vlera fundore është e arsyeshme duke marrë parasysh
25 familjen që është analizuar, që është testuar. Pra, kjo

1 përllogaritje e testimit.

2 PY. Mirë. Ju thatë diçka të ngjashme dhe më herët lidhur me
3 këtë, kur thatë se si duhet të duken statistikat. Flasim pak
4 për këtë. Kur testohen anëtarët e familjes përkundrejt disa
5 kampionimeve të panjohura, ka disa rezultate që mund të dalin
6 si pasojë e kësaj.

7 PË. Po.

8 PY. Pra ju po flisni për rezultate që janë të arsyeshme apo
9 brenda gamës apo brenda asaj që konsiderohet e arsyeshme?

10 PË. Po.

11 PY. Pra, nuk është rezultat i pazakontë, por është një nga
12 rezultatet e mundshme që do të dilte në situata të tilla, pra
13 kur testohen anëtarët e familjes.

14 PË. Po.

15 PY. Ju keni thënë duke marrë parasysh formatin e raportit
16 përveç faktit që është bërë një verifikim i profileve, nuk
17 mund të bëhet shqyrtimi i mëtutjeshëm.

18 PË. Po.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në pyetjen 5, që nuk e shohim në
20 raport, ju lutem kalojmë në faqen tjetër. Faleminderit.

21 PY. Ju është bërë pyetje:

22 "Përfundimi në këtë raport ka probabilitet të lartë apo
23 të ulët se personi i vdekur është evidentuar saktë përmes
24 analizimit të ADN-së."

25 Ju keni dhënë përgjigjen tuaj që e keni në ekran në fakt,

1 dhe keni thënë:

2 "Do të përdorja këtë klasë si një mbështetje të fortë për
3 identifikimin."

4 Pra, a mund të themi që një konstatim me 99.949999 [Sipas
5 përkthimit] është një mbështetje shumë e fortë për verifikimin
6 e identitetit?

7 PË. Po.

8 PY. Por ju nuk jeni në gjendje të na thoni nëse ky raport,
9 kjo analizë në të vërtetë jep apo nuk jep mbështetje të fortë?

10 PË. Po.

11 PY. Besoj se përfunduar me raportin në të djathtë.

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju lutem e zëvendësojmë këtë
13 raport dhe vendosim në ekran materialin SPOE00072678 deri në
14 00072750 RED, më intereson faqja 14 në PDF. Është materiali që
15 përfundon me numrin 2691.

16 PY. Një raport që e pamë edhe sot paradite me Prokurorinë.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit, e zmadhojmë pak?
18 Faleminderit. Vendosim faqen 9 të raportit të dëshmitarit në
19 të majtë, ju lutem. Shkojmë në fund ku duket emri i viktimës.

20 PY. Edhe një herë ky është një nga raportet që e keni
21 analizuar në mënyrën individuale dhe jo të marra së bashku.

22 PË. Po.

23 PY. A është e vërtetë që në përfundimet e këtij raporti në
24 fjalë përmenden ngjarjet e mutilacionit? A mund të na
25 shpjegoni çfarë është mutilacioni?

1 PË. Po. Kjo është, rast mutilacioni në këtë kontekst është
2 kur STR-ja transmetohet nga prindi te fëmija dhe gjatë
3 procesit të transformimit bëhet një proces mutacioni. Ka një
4 ndryshim pra, dhe fëmija merr një variant pak më të ndryshëm
5 të aleles krahasuar me prindin.

6 PY. Në rregull. Do ju bëj dhe një herë pyetjen që ju bëra dhe
7 më herët. Ju ia keni shpjeguar Prokurorisë se ekzistojnë qasje
8 të ndryshme për të inkorporuar ngjarje mutacioni si në këtë
9 rast.

10 PË. Po.

11 PY. Kjo është në varësi të laborantit?

12 PË. Po, laboratori ka protokolle që duhen ndjekur, sigurisht.
13 Dhe këto dallohen nga një laborator tek tjetri.

14 PY. Ju nuk ju kanë thënë se çfarë protokolli është ndjekur
15 për të trajtuar këtë rast mutacioni?

16 PË. Jo.

17 PY. Pra, ju nuk e dini se në çfarë mënyre është trajtuar ky
18 mutacion dhe nëse standardi i ndjekur ka qenë i pranueshëm apo
19 i papranueshëm?

20 PË. Saktë.

21 PY. Për këtë raport ju kam bërë dhe nja dy pyetje të
22 përgjithshme njësoj si me raportet e tjera. A mund të supozoj
23 unë me të drejtë se pesë pikat që pamë më herët vlejné dhe për
24 këtë raport?

25 PË. Po.

1 PY. Ama ka një përjashtim, sepse në këtë rast kemi një
2 pozicionim gjenesh?

3 PË. Po.

4 PY. Ka dallim në fakt nga një raport tek tjetri sa i takon
5 gjeneve. Po më duket në fakt se 14 raporte nuk kanë fare
6 pozicionim të gjeneve.

7 PË. Në rregull.

8 PY. Shohim përcaktimin e aleleve si për kampionimin e
9 panjohur të referencës në krye, por edhe për anëtarët e
10 familjes që janë testuar. A pajtohem edhe për këtë raport që
11 raporti, që përcaktimet alele edhe në këtë raport janë shumë
12 të pazakonta, .9, .7, .9?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe dëshmia që keni dhënë lidhur me raportin që pamë më
15 herët vlejné edhe për këtë raport?

16 PË. Po.

17 PY. Faleminderit. Kjo pyetje që do bëj tani është për të
18 gjitha raportet për shkak të problematikës që evidentuam,
19 mungesës së informacionit. Për këtë raport njësoj si për
20 raportet e tjera ju nuk mund të konfirmoni saktësinë apo
21 besueshmërinë e këtyre përfundimeve.

22 PË. Po.

23 PY. Shohim një raport tjetër.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Një çast ju lutem, sa të marr
25 dosjen. Shohim materialin SPOE00291803, ju lutem.

1 PY. Z. Goodwin, nuk do t'i shohim të gjitha raportet një për
2 një, por dua të shohim dhe një tjetër së bashku që të jemi të
3 sigurt që i kemi eksploruar të gjitha aspektet që trajtojnë
4 këto raportet.

5 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mjafton kjo faqe. Faleminderit.

6 PY. Z. Goodwin, a është ky një nga raportet e tjera që keni
7 analizuar për punën tuaj?

8 PË. Po.

9 PY. A pajtoheni se sërish të gjitha mangësitë që keni
10 identifikuar në raportet e tjera vlejné dhe për këtë raport?

11 PË. Po.

12 PY. Po kemi dy aspekte të reja këtu dhe ky është një shembull
13 shumë i mirë në fakt. E para ne kemi pozicionimin e gjeneve të
14 koduar në krye.

15 PË. Po.

16 PY. Edhe e njëjta gjë edhe këtu alelet janë krejt të
17 pazakonta në tekstin e raportit.

18 PË. Po.

19 PY. Kjo është diçka që mund ta shihni gjatë pushimit të
20 drekës se nuk duam që t'i shohim të gjitha raportet. Mund ta
21 shqyrtoni, më falni. Por dua t'ju bëj këtë propozim. Të gjitha
22 raportet me përjashtim të katër raporteve që diskutuam, kanë
23 problematikat që diskutuam.

24 PË. Po.

25 PY. Nuk e di a mund të thoni po pa pasur mundësinë t'i

1 verifikoni?

2 PË. Shiko, unë mund t'ju them që ka një përcaktim alel krejt
3 të pazakontë dhe ekziston një protokoll edhe për kodimin,
4 kështu që është diçka që besoj se duhet të jetë ndjekur edhe
5 në këtë rast. Por unë sidoqoftë pajtohem me propozimin tuaj.

6 PY. Një pyetje tjetër e përgjithshme që ju është bërë për
7 këto raporte. Një e pamë. Tjetra është, nëse raportet
8 përmbajnë përfundime që mbështeten nga informacionet në këto
9 tekste?

10 PË. Po.

11 PY. E vendosim dhe një herë faqen 11 të raportit tuaj në rast
12 se doni që t'i referoheni.

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Është materiali me numër 1951.

14 PY. Thjesht për siguri ta keni nëse doni të shikoni një nga
15 përgjigjet tuaja.

16 PË. Në rregull.

17 PY. Shkurtimisht, nëse më lejoni të bëj një përmbledhje të
18 përgjigjes tuaj. Pra, ju keni thënë fillimisht, keni
19 përsëritur në fakt në përgjigjen tuaj, se profilet e ADN-së
20 janë të koduara dhe nuk mund të bëni një analizë të plotë.

21 PË. Po.

22 PY. Po ju keni thënë që përfundimet duken të përshtatshme dhe
23 të arsyeshme.

24 PË. Po.

25 PY. Kjo është një përgjigje e zbardhur në raportin tuaj,

1 pasqyruar në raportin tuaj. Po ta sqarojmë çfarë keni dash të
2 thoni ju me këtë përgjigje ndonëse në vetvete duket e qartë.

3 PË. Po.

4 PY. Pra, ju keni thënë që nuk e thoni me siguri që këto
5 gjetje janë të arsyeshme dhe në fakt janë të përshtatshme?

6 PË. Jo, nuk mund ta them këtë pa pasur të dhënat bazë që janë
7 përdorur për të kryer këto raporte.

8 PY. Po, saktë. Ju e keni thënë këtë dhe unë nuk synoj që ta
9 përsëris, informacionin që keni kërkuar për ta përdorur këtë.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, klienti doli
11 nga salla. Do na jepni dhjetë minuta kohë që të identifikojmë
12 cili është problemi?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
14 derisa të kthehet z. Veseli në sallë.

15 Bëjmë një pushim të shkurtër, mund të largoheni nga salla
16 bashkë me Asistenten ju lutem.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pak
19 minuta pushim, mos u largoni, ju lutem.

20 -- Pauza fillon në orën 12.24

21 -- Seanca rifillon në orën 12.31

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
23 silleni dëshmitarin në sallë, Sekretare.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më treguan që
25 thuajse kam mbërritur dy orëshin që më është dhënë. Me ç'kam

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 103

1 kuptuar nga kolegët, ekipet e tjera nuk do duhet që të
2 përdorin shumë nga koha e tyre, kështu që do ju kërkoja që të
3 mund të vazhdoja derisa të bëjmë pushimin e drekës.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
6 Dëshmitar, do vazhdojmë më tej me pyetjet e znj. Rowan.

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

8 PY. Faleminderit për durimin z. Goodwin.

9 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
10 kalojmë tek prova e Prokurorisë P854 në faqen 239.

11 PY. Z. Goodwin, nga ky koleksioni më i madh i dokumenteve unë
12 do kërkoja që ne të shikojmë një prej katër raporteve që është
13 pjesë e këtij, kësaj nënkategorie siç e kam quajtur. Dhe ky
14 është pjesë e raportit të ekspertit. Nuk e di në qoftë se po
15 më ndiqni, apo jo, në qoftë se ka kuptim për ju kjo, apo jo.
16 PË. Po.

17 PY. Në rregull. Tani le të shikojmë një përmbledhje të një
18 prej raporteve.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Duhet të jetë një tjetër tabelë në
20 fakt, jo kjo që kemi përpara. Ka numrin 239.

21 PY. Ky është një raport të cilin nuk e keni parë sot.

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Sërish, ky raport nuk duhet të
23 transmetohet për publikun.

24 PY. Atëherë, mund të shikoni numrat ose emrat e mundshëm të
25 identifikimit. Për shembull, mund të shihni katër identitete

1 të ndryshme të mundshme.

2 Qëllimi i tregimit të këtij dokumenti për ju, Dëshmitar,
3 është që dua të përforcoj dhe një herë dallimet midis këtij
4 raportit dhe tre raporteve që pamë deri tani. Domethënë, do
5 shkojmë përsëri tek pikat nga ku kemi filluar.

6 Nëse do shohim këtë raport, ju mund të shikoni pjesë e
7 gjeneve, pozicionimit të tyre. Po ashtu kemi dhe alele sipas
8 gamës që presim. Po ashtu kemi edhe rreshtin e dytë, që duhet
9 të jetë siç ishte dhe në raportet e tjera, dhe këtu shikojmë
10 shifra të gjata, të mëdhaja dhe nuk shikojmë me pikë një
11 shifër tjetër, domethënë nuk kemi me presje dhjetore?

12 Pra, siç mund ta shikojmë ky dokument dhe dy raportet e
13 tjera që kemi parë janë raporte të cilat kanë të njëjtën pamje
14 që ju do prisni të kishin këto raporte, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. Në rregull.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Tani le të kalojmë në fund fare të
18 këtij raporti. Do shikojmë diçka tjetër.

19 PY. Z. Goodwin, a pajtoheni me mua që një tjetër dallim midis
20 këtyre katër raporteve, krahasimisht me raportet e tjera është
21 që sikurse mund ta shikojmë në fund fare, domethënë, kemi
22 "Rishikimin", nënshkrimin dhe datën, pastaj kemi "Rishikimi i
23 përgjithshëm", nënshkrimi dhe data, dhe pastaj "Rishikimi
24 përfundimtar", "Rishikimi" dhe data. A është kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe në të gjitha raportet e tjera, domethënë, e kemi parë
2 vetëm një nënshkrim, a është e vërtetë kjo, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Besoj që është e saktë, do ta marr si të mirëgenë këtë.

4 PY. Në asnjërin prej këtyre raporteve identiteti i personave
5 që kanë nënshkruar për raportet nuk është i qartë, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Ndërkohë që në këtë rast ne kemi tre nënshkrime, dhe kjo
8 ka ndodhur në 2002. Sipas mendimit tuaj, a është bërë një
9 rishikim i një kolegu tjetër, nga një koleg tjetër?

10 PË. Kjo sugjeron që është bërë një rishikim nga një koleg
11 tjetër.

12 PY. Pra, në qoftë se do shikojmë një raport që ka më shumë se
13 sa një nënshkrim, atëherë i takon që ai është analizuar nga
14 një ekspert tjetër, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. A mund të na shpjegoni pak se çfarë do të thotë rishikim
17 nga një koleg tjetër?

18 PË. Rishikimi nga një koleg tjetër është një person, është
19 procesi ku një person i dytë në mënyrë të pavarur bën
20 kontrollin e rezultateve dhe vërteton që rezultatet janë të
21 sakta.

22 PY. Dhe kjo në fakt nuk ka ndodhur për raportet e tjera, por
23 vetëm për këtë raport, kështu?

24 PË. Të paktën kështu rezulton nga raportet.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mund ta heqim raportin nga ekrani.

1 Falënderoj Sekretaren.

2 PY. Tani do kalojmë tek raporti i ekspertit që e kemi
3 përmendur disa herë sot.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kështu që do i kërkoja Sekretares
5 të paraqesë në ekran provën P785 [Sipas përkthimit]. Përsëri
6 nuk është për ta parë publiku. Mund të kalojmë pak më poshtë.
7 PY. Atëherë, këtu shihet që kërkohet dëshmia. Domethënë, me
8 fjalë të tjera kjo është një lloj udhëzimi që i jepet
9 personave që kanë shkruar këtë raport. Për shembull këtu
10 thuhet që komisioni ndërkombëtar për personat e humbur duhet
11 që të japë dëshmi eksperti për sa i takon analizës së ADN-së,
12 mbështetur në të dhënat që janë dhënë nga UNMIK-u. Pajtoheni
13 ju me këtë, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do të kalojmë më poshtë në
16 dokument në mënyrë të tillë që t'ju rifreskojmë kujtesën
17 lidhur me pamjen e këtij raporti.

18 PY. Është e saktë apo jo, që në këtë raport jepen ca hollësi
19 lidhur me metodologjinë që është përdorur në këtë rast?

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të kalojmë pak më poshtë në faqe
21 për ta parë këtë.

22 PY. Pra është kjo pjesa, pjesa e dytë, metodologjia dhe
23 testimet e kryera. Kështu, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Domethënë, është e saktë që për këto katër raportet e

1 pavarura, ne kemi pak më shumë informacion sa i takon

2 metodologjisë së përdorur, a është kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Në fund të këtij raporti kemi nënshkrimet e tre personave

5 që janë përgjegjës për dhënien e këtij informacioni, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Pra, i takon meqë ju jeni në pozicion që të kuptoni pak

8 më mirë se çfarë pune është bërë lidhur me rezultatet e

9 testeve që janë dhënë dhe që keni parë.

10 PË. Po.

11 PY. Dhe rezultatet e këtyre testeve kanë qenë në gamën e

12 atyre çfarë keni pritur ju që të jenë, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Dua që të trajtojmë gjithashtu edhe disa prej mangësive

15 që ekzistojnë në këto raporte.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,

17 ju lutem kujdesuni me shpejtësinë, duhet të flisni më ngadalë.

18 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po, më thanë edhe kolegët.

19 Të kalojmë tek faqja 5 e këtij raporti.

20 PY. Z. Goodwin, neve na është kërkuar nga Trupi Gjykses që të

21 mos përdornim emrin e identiteteve këtu. Unë do të doja që të

22 drejtohem njërit prej këtyre identiteteve. Domethënë unë deri

23 tani po flisja për katër raporte që përmban paketa me

24 informacion, por ky është raporti i pestë.

25 PË. Po.

1 PY. A pajtoheni ju që ky kampion, dhe mund ta shikojmë, për
2 shembull, në fillim fare emrin e identitetit të mundshëm.

3 Mbase mund t'i referohemi kështu që kampioni i eshtrave ka
4 marrë numrin N.N.986. A pajtoheni ju me mua që për kampionin
5 N.N.986 nuk e kemi fare bazën e materialit, apo jo?

6 PË. Të paktën mbështetur në atë çfarë mund të shikoni në
7 ekran, këtë mund të them.

8 PY. Dhe ju nuk keni nga ta dini në qoftë se ka qenë kampioni
9 bazë, apo jo?

10 PË. Jo, nuk besoj se e kam.

11 PY. Dhe nga ky kampion nuk kemi informacion sa i takon llojit
12 të testimi të bërë, apo jo?

13 PË. Mbështetur në çfarë kam këtu, jo nuk mund ta them këtë
14 gjë.

15 PY. Nuk dimë se cilat janë alelet e përdorura ose cilat gjene
16 në pozicionet e tyre janë përdorur për të bërë analizën apo
17 jo?

18 PË. Po.

19 PY. Nuk dimë as natyrën dhe as numrin e marrëdhënieve
20 familjare potenciale që janë testuar, apo jo?

21 PË. Saktë.

22 PY. Nuk e dimë në qoftë se ka pasur të dhëna që përfshiheshin
23 në atë analizë që do t'ju bënin juve të vinit në pikëpyetje
24 përfundimet të cilat janë arritur, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Ne nuk kemi informacion të asnjë lloji se si mbi bazën e
2 të cilave informacione ose si është mbërritur në përfundimin
3 që kemi në këtë faqe, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe duke qenë kështu ju nuk jeni në mundësi, nuk keni
6 mundësi që të komentoni në mënyrë të njëmendtë ose që të
7 konfirmoni vërtetësinë e përfundimeve të dhëna këtu, apo jo,
8 Dëshmitar?

9 PË. Saktë.

10 PY. Përveç këtij raport, gjithsesi, në qoftë se keni nevojë
11 që ta lexoni me më tepër kujdes, mund të na e thoni këtë gjë.
12 Megjithatë, nga ajo çfarë mbani mend nga ky raport, a
13 pajtoheni me mua që ky raport nuk përmban shënime
14 laboratorike?

15 PË. E saktë.

16 PY. Nuk përmban as procedura standarde të operimit, apo jo?

17 PË. E saktë.

18 PY. Nuk përmban as mekanizma lehtësues për të trajtuar rastet
19 e mundshme të kontaminimit, apo jo?

20 PË. E saktë.

21 PY. Ky është një informacion i cili mungon për pjesën tjetër
22 të raporteve, por mungon edhe në këtë rastin e këtij raporti
23 konkret, kështu?

24 PË. Duhet të them që nuk e pres këtë informacion që të ishte
25 i pranishëm në asnjë prej raporteve, por pres që të ishte i

1 disponueshëm në qoftë se do kërkoja unë që të më jepej ky
2 raport.

3 PY. Por ju prisni që metodologjia dhe rezultatet të ishin
4 pjesë e raporteve, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Nuk e kam referencën për këtë, megjithatë në qoftë se
7 dëshironi që ta lexoni, z. Goodwin, mund ta lexoni dhe mund ta
8 gjej referencën për faqen. Megjithatë, në këtë raport thuhet
9 që profilet e ADN-së që merren nga kampionet e eshtrave në
10 këtë raport janë dorëzuar nga laboratorë të respektuar për
11 ADN-në për Identifikimin dhe në Qendrën e Koordinimit në Tuzlë
12 dhe thuhet gjithashtu që ato janë futur në bazën e të dhënave
13 dhe është bërë një kërkim. Pra, kur ka ndodhur përkimi me
14 profilin e ADN-së dhe kampionin e eshtrës dhe kampionët e
15 referencës së gjakut, atëherë, është bërë raporti përkatës për
16 ADN-në.

17 A pajtoheni ju me shpjegimin, me hapat, domethënë, hapat,
18 a janë këto hapat që duhet të ndiqen? A pajtoheni me këtë
19 shpjegim?

20 PË. Po. Kjo është mënyra e kuptuar se si duhet të ishte
21 proceduar.

22 PY. A është e saktë që juve nuk ju është lejuar të keni qasje
23 në bazën e të dhënave?

24 PË. E saktë.

25 PY. A keni qenë jo në gjendje që të verifikoni informacionin

1 vetë ju në vetë të parë, a është e saktë kjo dhe a nuk keni
2 qenë në gjendje që të bëni kërkimet përkatëse?

3 PË. E saktë.

4 PY. A keni qenë në gjendje ju që të verifikoni rezultatet e
5 këtyre kërkimeve?

6 PË. Jo.

7 PY. Në rregull. Përpara sesa ta heq këtë raport nga ekrani,
8 kam një pyetje të fundit me këtë raport, edhe katër tabelat.
9 Atëherë, lidhur me ato çfarë do të prisnit ju të shihnit në
10 raporte të tilla të kësaj natyre, ju mund të thoni që pamja
11 është ajo çfarë prisnit megjithatë, ju nuk mund të thoni me
12 saktësi ose nuk mund të konfirmoni që informacioni është i
13 saktë dhe nuk mund të konfirmoni që puna është bërë në mënyrë
14 të besueshme, apo jo?

15 PË. Jo, nuk mundem.

16 PY. Në rregull. Do ta bëj kështu pyetjen.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Për këtë arsye do i kërkoja
18 Sekretares të parë -- të paraqesë provën P1951 në faqen 5. Ju
19 kërkoj ndjesë, e thashë gabim. Është faqja 1952, është letra e
20 udhëzimeve.

21 PY. Do ta përdor këtë dokument në mënyrë të tillë që të
22 identifikoj një emër. Besoj që është më e thjeshtë që të
23 procedojmë në këtë mënyrë.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kështu që do i kërkoja Sekretares
25 të kalojmë në faqen 5 të letrës së udhëzimeve. Shumë

1 faleminderit.

2 PY. Z. Goodwin, do ju kërkoja që të shikonit rreshtin në
3 fillim, ku thotë "Viktimat".

4 Këtu kemi një listë viktimash të renditura.

5 PË. Po.

6 PY. A shikoni një listë të gjatë viktimash në atë listë?

7 PË. Po.

8 PY. A pajtoheni me mua që personat që renditen në listën e
9 viktimave në fakt nuk kanë raporte ADN-je që lidhen me ID-të e
10 mundshme?

11 PË. Jo, nuk kam parë asnjë raport të ADN-së që lidhet me këtë
12 individ përkatës.

13 PY. Ju falënderoj. Gjithsesi nëse doni që ta kontrolloni këtë
14 si informacion, mbasi të bëjmë pushimin e kafes -- pushimin e
15 drekës, më falni, në orën 13.00, mund ta lexoni më në hollësi
16 në mënyrë të tillë që të kontrolloni këtë informacion. Por për
17 momentin, domethënë, a pajtoheni me mua lidhur me këtë?

18 PË. Po.

19 PY. Në qoftë se keni nevojë që ta rishikoni siç e thashë mund
20 ta rishikoni dhe vetë.

21 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, u ngrita në këmbë
22 për t'i kujtuar Avokates udhëzimet të cilat janë dhënë nga
23 Gjykatësi, sepse nuk është detyra e Avokates që t'i caktojë
24 detyrat e shtëpisë dëshmitarit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

1 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

2 PY. Në rregull, do ju pyes përsëri në orën 14.30 në qoftë se
3 keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar lidhur me këtë pikë.

4 PË. Kjo nuk më çon në asnjë gjë që mund të mbaj mend sa i
5 takon profilit të ADN-së.

6 PY. Jam e sigurt që në qoftë se do bëjmë ndonjë gabim, kolegu
7 im i Prokurorisë do na korrigjojë.

8 Tani, në qoftë se do shikojmë dallimet mes këtyre dy
9 grupeve dokumentesh ose raportesh që diskutuam së bashku,
10 është e drejtë të thuhet që së pari kemi kategorinë e
11 raporteve të cilat nuk kanë të bëjmë me temën e diskutimit
12 sot.

13 PË. Po.

14 PY. Të gjitha këto raporte e kanë origjinën nga Komiteti
15 Ndërkombëtar për Personat e Humbur, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Katër prej këtyre raporteve në pamje të parë janë të
18 ndryshme në mënyrë thelbësore nga pjesa e tjetër e raporteve
19 që kemi diskutuar sot, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe ju nuk jeni në gjendje të na shpjegoni se pse janë
22 këto katër raporte të ndryshme.

23 PË. E saktë.

24 PY. Ne do shohim disa prej dallimeve që mund të shikojmë nga
25 këto dy kategori raportesh. Dhe disa dallime që mund të

1 ekzistojnë.

2 Për katër raportet që kemi parë, që kemi diskutuar deri
3 tani, dhe që janë objekt i raportit që kemi në ekran,
4 domethënë, mund ta shikoni raportin në ekran, pra, kemi një
5 dallim lidhur me këto raporte. Dhe ky dallim është që ne e
6 dimë që Gjykata, TPNJ-ja i ka kërkuar Komitetit Ndërkombëtar
7 për Personat e Humbur që të japë dëshmi eksperti për analizën
8 e kryer prej Komitetit Ndërkombëtar të Personave të Humbur nga
9 analiza e ADN-së.

10 PË. E keni fjalën për -- domethënë, mbështetur në vlerësimin
11 e raportit.

12 PY. Në qoftë se doni mund të shikojmë faqen e parë.

13 PË. Jo, nuk është e nevojshme, mund të vazhdojmë.

14 PY. Dallimi i dytë është që të katër raportet të cilat janë
15 marrë si bazë për këtë raport eksperti mbajnë datën 2002, apo
16 jo?

17 PË. Po.

18 PY. Megjithatë, raportet e tjera janë bërë më vonë, domethënë
19 data e tyre është 2005, 2006, 2009 etj.

20 PË. Po.

21 PY. A jeni në gjendje që të konfirmoni datat e këtyre
22 raporteve?

23 PË. Nuk i mbaj mend përmendësh, më duhet t'i kontrolloj,
24 megjithatë, në qoftë se ju thoni që janë këto datat, nuk kam
25 arsye për ta kundërshtuar.

1 PY. Një tjetër dallim që na shfaqet në pamje të parë është që
2 disa prej tyre, domethënë, janë, kanë qenë objekt shqyrtimi
3 nga kolegë të tjerë, domethënë janë parë nga më tepër se një
4 ekspert, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 PY. Do shikojmë një tjetër dokument. Nuk është i të njëjtës
7 natyre me dokumentin që kemi shqyrtuar sot bashkë.

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares
9 që të paraqesë në ekran dokumentin SPOE0068661, në faqen 1.
10 Faleminderit.

11 PY. Z. Goodwin, ose pretendoj që të jetë një Konfirmim i një
12 Dokumenti Identiteti që është lëshuar nga UNMIK-u, apo jo?

13 PË. Kështu duket.

14 PY. Pra, a ju kujtohet ta keni parë një dokument të ngjashëm
15 me këtë më përpara?

16 PË. Nuk më kujtohet që e kam parë, por kjo nuk do të thotë që
17 s'e kam parë.

18 PY. Këtë nuk do e keni parë besoj.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mund të kalojmë në fund të faqes.
20 Jo aq poshtë në faqe, jo deri tek data, në qoftë se është e
21 mundur. Në rregull.

22 PY. Do ju lejoj një moment që të riorientoheni me këtë
23 dokument se është një dokument i ndryshëm nga ai dokumenti që
24 kemi parë. Ju lutem, hidhini një sy dhe pastaj do ju bëj
25 pyetje.

1 PY. Ky është një tjetër formë e dëshmive ose vërtetimit të
2 ADN-së që ekziston, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Por ky nuk është një lloj dokumenti të cilin Prokurori ju
5 ka kërkuar që ta komentoni, apo jo?

6 PË. Po, e drejtë është kjo.

7 PY. Do ju kërkoj që ta komentoni pak. Domethënë, të shikojmë
8 në fakt në fund, pra, kemi vulën, shikojmë gjithashtu dhe
9 nënshkrimin dhe emrin e personit që e ka nënshkruar atë. Nuk
10 besoj që ka ndonjë arsye për të qenë konfidencial ky dokument.
11 Në të kundërt më thotë kolegu. Atëherë, këtu është z. Baraybar
12 në qoftë se nuk e kam gabim, dhe thuhet që është shefi i
13 zyrës.

14 PË. Po.

15 PY. Nuk besoj që e kemi parë këtë faqe, megjithatë mund të
16 them që e dimë ose mund të shohim në raporte që pamë bashkë më
17 herët që ai është antropolog forensik.

18 PË. Po, më kujtohet.

19 PY. Ju pajtoheni me juve që antropologu forensik nuk është
20 automatikisht ekspert ADN-je, është ekspert i një natyre
21 tjetër, apo jo?

22 PË. Po, keni të drejtë, sepse antropologu është antropolog,
23 nuk është ekspert ADN-je 100 për qind.

24 PY. Domethënë, këto janë dy profesione të ndryshme.

25 Antropologu dhe eksperti i ADN-së janë dy profesione të

1 ndryshme.

2 PË. Janë profesione të ndryshme, por zakonisht punojnë me
3 njëri-tjetrin në bashkëpunim me njëri-tjetrin. Pra dinë rreth
4 profesionit të njëri-tjetrit, por kanë profesione të ndara, të
5 veçanta. Pra, antropologu nuk është analist ADN-je.

6 PY. Domethënë, antropologu nuk duhet t'i kërkojë që t'i japë
7 përfundime, për një fushë që nuk është fushë e tija, apo jo,
8 siç në rastin tuaj, për shembull ju nuk mund të thirreni si
9 ekspert në fushën e antropologjisë, apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Unë nuk mund të jap opinione në cilësinë e ekspertit, por
11 mund të jap mendimet e mia për fushën e antropologjisë.

12 PY. Por në fakt e kemi parë një raport të ngjashëm, pyetjen
13 që pamë, raportin që pamë përpara, ishte një raport që ishte
14 shkruar nga tre ekspertë të ndryshëm. Dhe raporti ishte i
15 përbashkët, ku secili prej tyre kishte dhënë mendimin e vet.
16 Domethënë ata tre vetat kishin dhënë mendimin e tyre për këtë
17 raport, megjithatë siç e thatë dhe juve, ju nuk e konsideroni
18 veten si personin e duhur për të mbërritur në përfundime të
19 fushës së antropologjisë, apo jo?

20 PË. Po, e saktë.

21 PY. Edhe e kundërta është e vërtetë, domethënë antropologu
22 nuk mund të pretendohet të jetë ekspert apo analist i ADN-së,
23 apo jo, Dëshmitar?

24 PË. E saktë.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja tjetër.

1 PY. Do t'ju bëj disa pyetje shpejt e shpejt lidhur me kufijtë
2 e një informacionit, ose informacionin e kufizuar që kemi. A
3 pajtoheni që ky raport ka si synim që të japë një identitet
4 pozitiv nga kampionimi i marrë apo jo?

5 PË. Po kjo është, ky është përfundimi.

6 PY. Pra, këtu thuhet që:

7 "Rezultatet e ADN-së u fituan nga mostrat e eshtrave dhe
8 gjakut të anëtarëve të familjes të renditura në listë edhe ato
9 kanë dalë që të përkojnë me njëra-tjetrën."

10 PË. Po.

11 PY. Tani, duke parë kufizimet e një informacioni të tillë,
12 ose një dokumenti të tillë, dhe krahasuar me raportet dhe
13 përmbajtjen e raporteve që ne pamë më herët, a mund të
14 konfirmohet se ne nuk e dimë se kur dhe ku është bërë ky
15 testim, domethënë nga informacioni që kemi në këtë dokument?

16 PË. E saktë.

17 PY. A është e saktë që nuk e dimë që çfarë metodologji është
18 përdorur për të mbërritur në këtë përfundim?

19 PË. E saktë.

20 PY. Ne nuk dimë asgjë për EPG-në, në qoftë se nuk na jepet si
21 dokument shtesë apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Ne nuk dimë asgjë lidhur me prapun e aleleve, apo jo?

24 PË. Po, e vërtetë.

25 PY. Nuk e dimë se çfarë procedure është përdorur apo jo,

1 Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. Ne nuk mund të dimë se çfarë profili ADN-je është
4 përdorur dhe ky profil nuk është shqyrtuar nga një tjetër
5 ekspert, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Ne nuk dimë në qoftë se është bërë ndonjë testim për
8 përzierjet, ose për multipleksin. Në qoftë se është përdorur
9 multipleksi apo jo.

10 PË. Nuk e dimë. Nga kjo që kemi bërë para, nuk e dimë fare se
11 çfarë lloji analize ADN-je është bërë.

12 PY. Ne nuk e dimë çfarë kampioni është marrë si bazë analize,
13 nuk e dimë në qoftë se është marrë nga eshtrat ose është marrë
14 nga dhëmbët, se nuk thuhet këtu. Nuk thuhet qartazi në qoftë
15 se kampioni është marrë nga eshtrat ose është marrë nga
16 dhëmbët. Mund ta lexoni paragrafin.

17 PË. Po, e saktë.

18 PY. Ne nuk e dimë se në cilën pjesë të skeletit është marrë
19 kampioni, ose cila pjesë e skeletit është testuar, mbështetur
20 në informacionin që kemi në këtë material, në këtë dokument?

21 PË. E saktë.

22 PY. Ne nuk e dimë se çfarë cilësie ka pas kampioni i ADN-së
23 së marrë, apo jo?

24 PË. E saktë.

25 PY. Ne nuk e dimë në qoftë se kemi të bëjmë me një kampion të

- 1 miksuar, kompozitë, apo për një lloj cilësie tjetër të
- 2 kampionit të ADN-së, apo jo?
- 3 PË. Nga çfarë lexoj këtu, nuk duket sikur profili është
- 4 analizuar, nuk mund ta dimë.
- 5 PY. Nuk mund ta dimë?
- 6 PË. Nuk mund ta dimë, megjithatë do ishte shumë e pazakontë
- 7 që të përdoret një profil i miksuar i përzier për të bërë një
- 8 analizë të tillë.
- 9 PY. Ne nuk e dimë se sa alele janë testuar apo jo?
- 10 PË. Jo, nuk e dimë.
- 11 PY. Nuk e dimë se çfarë, sa gjene në pozicionet e tyre
- 12 përkatëse janë analizuar apo jo?
- 13 PË. Po.
- 14 PY. Ne nuk e dimë në qoftë se është konstatuar ose gjetur
- 15 ndonjë mutacion apo jo?
- 16 PË. Po.
- 17 PY. Nuk e dimë as përcaktimin e aleleve, apo jo?
- 18 PË. Po.
- 19 PY. Nuk e dimë në qoftë se kjo, këto janë shumë të pazakontë,
- 20 siç ishte cilësimi i dhënë në raportet e mëparshme?
- 21 PË. E drejtë.
- 22 PY. Ne nuk e dimë probabilitetin e mëparshëm, në qoftë se ky
- 23 probabilitet është zbatuar apo jo?
- 24 PË. Jo, nuk ka asnjë statistikë ky dokument, kështu që nuk
- 25 dimë gjë sa i takon probabilitetit të mundshëm.

1 PY. Pra, nuk kemi asnjë indikacion sa i takon probabilitetit
2 si pjesë e analizës, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Tani, le të trajtojmë pak shprehjen "në pajtim me", "në
5 pajtim me" nuk është një shprehje që përdoret me homostrajpin,
6 me tabelën e Hummel-it, ju kërkohet ndjesë.

7 PË. Me raportimin forensik.

8 PY. Pra, sa i takon tabela të zakonshme që ne pamë në
9 raporte, ky është nuk, domethënë, kjo lloj shprehjeje nuk
10 është zhargon ose nuk është formulim që përdoret në tabela të
11 tilla, apo jo.

12 PË. Jo, nuk është tregues.

13 PY. Sepse një konstatim mund të jetë pajtim me rezultatin,
14 megjithatë, rezultati mund të jetë me shumë pak gjasa
15 pavarësisht kësaj, apo jo? A kam të drejtë këtu, Dëshmitar?
16 Pra, në qoftë se nuk është në pajtim me ose në përputhje me
17 ose në konsistencë me.

18 PË. Problemi me këtë lloj formulimi është që nuk na jepet
19 asnjë informacion lidhur me sa i fortë është kjo konsistencë
20 ose kjo përputhshmëri.

21 PY. Kjo mund t'i referohet për shembull një pajtueshmërie 50
22 për qind ose 90 për qind, nuk e dimë se cili është dallimi,
23 nuk na jep ndonjë nivel dallimi, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Por nga, domethënë, nga përvoja juaj si profesionist, ju

1 thoni që ka një dallim shumë të madh midis përputhshmërisë,
2 probabilitetit 50 për qind dhe 90 për qind, apo jo?

3 PË. Sa i takon terminologjisë, nuk di t'ju them domethënë 50
4 për qind dhe 90 për qind ka diferencë të madhe.

5 PY. Probabilitetin, për probabilitetin e kisha fjalën.

6 Domethënë a kalohet pragu i nevojshëm në qoftë se do të jetë
7 90 për qind probabiliteti ose çfarë mund të na thoni lidhur me
8 këtë?

9 PË. 50 për qind nuk do ishte konsistent, por 60 për qind mund
10 të ishte konsistent, mund të ishte në përputhshmëri. Kjo mund
11 të jetë një mënyrë interpretimi në qoftë se mund të ketë
12 kuptim për juve.

13 PY. Po ka larmi të gjerë.

14 PË. Po, domethënë probabiliteti është në nivele të ndryshme.

15 PY. Ju nuk keni mundësi që të bëni një analizë tjetër të dytë
16 në një dokument të tillë, apo jo?

17 PË. Jo.

18 PY. Ju nuk keni shkak ose arsye për të vënë në pikëpyetje
19 këto konstatime me materialin bazë?

20 PË. Jo.

21 PY. Dhe për pasojë nuk keni as arsye për konstatuar anomali
22 apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe kjo do të thotë që nuk ia vlen as që t'ju bëjmë
25 pyetje lidhur me këtë dokument se ju nuk e keni idenë, nuk e

1 dini se nga janë marrë ose nga kanë rrjedhur, nga kanë buruar
2 këto përfundime, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Së fundi, do vazhdoj me pyetjet e
5 tjera.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka shkuar
7 ora, kështu që duhet të vazhdojmë me pushimin, duhet t'u japim
8 mundësinë për të pushuar përkthyesve dhe stenografit.

9 Mund të dilni nga salla, Dëshmitar, do të vazhdojmë
10 përsëri në orën 14.30.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë kisha
13 parashikuar që të përdorja një orë kohë, por ndërkohë një
14 pjesë e mirë e pyetjeve të mia u mbuluan nga kolegja, kështu
15 që nuk mendoj që do kem më shumë se sa 15, 20 minuta.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
17 Po kolegët e tjerë?

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk besoj që do kem pyetje.

19 Z. TULLY: [Përkthim] As unë nuk besoj që do të kem
20 pyetje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Do bëjmë pushim deri në orën 14.30. Dhe do të vazhdojmë
23 pastaj me seancën tjetër.

24 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

25 --- Seanca rifillon në orën 14.30

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
2 sillni dëshmitarin në sallë.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
5 uleni.

6 Znj. Rowan.

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, mirë se erdhët. Kam vetëm disa pyetje që më
9 kanë ngelur.

10 Seancën përgatitore që keni bërë me Prokurorin javën e
11 kaluar përmes Zoom-it, ju kujtohet?

12 PË. Po.

13 PY. Do të merrem vetëm me një koment që i keni bërë
14 Prokurorit gjatë asaj seance.

15 PË. Po, po.

16 PY. Ju u përmendët atyre, dhe kjo është në paragrafin 4, në
17 faqen 1, dhe pyetët ata nëse në statusin tuaj si dëshmitar
18 shihni ndonjë dobësi gjatë dhënies së dëshmisë suaj. Ju
19 kujtohet që keni kërkuar sqarim lidhur me këtë?

20 PË. Po.

21 PY. A mund të pyet, kur keni bërë këtë pyetje atyre për çfarë
22 dobësish e kishit fjalën, kishit në mendje?

23 PË. Të dhënat që m'u prezantuan në raport, sa i takon gjasave
24 dhe mundësive, ishin të bazuara në analizë që unë mendova
25 është bërë sipas ICMP-së, analizë e ngjashme, pra Prokuroria

1 preku një, theksoi një element që, të saj sot në mëngjes kur
2 bëri pyetje lidhur me nënstrukturën, me popullsinë e
3 nënstrukturës dhe, pra, me përfshirjen e popullsisë në
4 nënstrukturë zvogëlohet shkalla e mundësisë ku unë kam
5 llogaritur, pra shkallët e mundësisë.

6 Element tjetër është PowerPlex 16 që ka dy apo katër
7 lokuse. Dhe janë dy palë, dy çifte lokusi të të njëjtit
8 kromozom. Pra, në rrethana, në disa rrethana njëra prej tyre
9 nuk merret parasysh si provë, që edhe kjo redukton, pra
10 zvogëlon shkallën e gjasave të mundshme në përgjithësi.

11 PY. Duke u marrur tani thjesht me këtë pikën e fundit, pra --
12 a mund të na sqaroni pak më shumë në hollësi ndikimin që mund
13 të ketë kjo në rezultate?

14 PË. Po, fakti që dy lokuset gjenden në të njëjtin kromozom do
15 të thotë që janë fizikisht të lidhura, dhe për rrjedhojë nuk
16 mund të trashëgohen tërësisht në mënyrë të pavarur, pra janë,
17 këto gjinden në një distancë, distancë të madhe, relativisht
18 të madhe në kromozome. Që do të thotë që kombinimi, çdo
19 kombinim mes tyre është i zakonshëm gjatë miosizit, që të
20 përmendim një term teknik.

21 Por që të jemi të kujdesshëm kjo mund të merret parasysh
22 se lidhja mes tyre, lidhja fizike mes tyre, pra, të merret
23 parasysh.

24 PY. Ju përmendët se kjo është diçka që mund të ndodhë në
25 PowerPlex 16, në këtë sistem testimi, pra?

1 PË. Këto janë dy çifte të lokusit, të PowerPlex 16 që janë
2 zbatuar në këtë rast.

3 PY. Dhe arsyeja që kjo është relevante në këtë rast është
4 sepse gjatë, dhe pse kjo nuk përmendet në raportet që kemi ne,
5 që testi i përdorur, pra, mund të deduktohet nga testet ku
6 lokuset janë emërtuar se kjo, ky është me shumë gjasë testi që
7 është përdorur.

8 PË. E saktë.

9 PY. Dhe kjo është, pse ishte, ky ishte shqetësimi juaj që
10 mund të ishte relevant për testin, pra, që po shohim ne?

11 PË. Po.

12 PY. Faleminderit. A mund t'ju pyes tani duke patur parasysh
13 dëshminë që keni dhënë sot në mëngjes që keni patur mundësinë
14 të shqyrtoni të gjitha dobësitë që ju keni parë aty, mbi të
15 cilat mbështeten të dhënat?

16 PË. Besoj që po.

17 PY. Dhe përfundimisht lidhur me këtë pikë që ju ngritët me
18 Prokurorinë, Prokuroria ju pyeti juve, a ju kërkoi juve që të
19 shtjellonit më tej apo të sqaronit më shumë atyre dobësitë që
20 ju keni konstatuar?

21 PË. Në atë kohë, jo. Nuk ma kërkuan.

22 PY. Faleminderit. Dhe për të përfunduar, z. Goodwin, pyetja
23 ime është: A është e saktë që ju, ajo që ju keni bërë është,
24 ka ndihmuar këtë Gjykatë, keni ndihmuar Gjykatën për aq
25 mundësi sa kishit ju për t'iu përgjigjur pyetjeve që ju janë

1 bërë juve konkretisht?

2 PË. Këtë gjë kam bë, pikërisht.

3 PY. Dhe ju kishit të dhënat e databazës që ju janë dhënë juve
4 pra, dhe pajtoheni që kjo ishte në njëfarë mënyre e kufizuar,
5 kjo bazë të dhënash?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe se të gjitha përgjigjet tuaja janë dhënë bazuar në të
8 dhënat që keni parë me kufizimet që ato përmbanin?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe nuk është faji juaj që të dhënat e bazës, databaza
11 ishte e kufizuar dhe në qoftë se mund të bëj një përmbledhje
12 të kësaj mënyrë. Për shkak të kufizimeve që keni patur gjatë
13 mëngjesit të sotëm lidhur me mungesën e informacionit që, dhe
14 pamundësia që rezulton nga kjo për të bërë një ritestim apo
15 për të shqyrtuar, ekzaminuar, informacionin, qëndrimi juaj
16 është në qoftë se pajtoheni, që nuk jeni në gjendje të
17 konfirmoni përfundimet e ndonjërit prej raporteve që keni parë
18 si faktuale të vërteta apo të mbështetshme?

19 PË. Dhe nuk mund t'i krahasoj ato me të dhënat origjinale me
20 qëllim që të, për të bërë një gjë të tillë. Do të thotë unë
21 qëndroj në përfundimet e përgjithshme që kemi bërë sa i takon
22 kësaj. Kjo, ajo që kam dhënë unë është ajo që mbi të cilën jam
23 bazuar.

24 PY. Dhe ju nuk jeni në gjendje që të shikoni raportet për
25 përmbajtjen e tyre të saktë?

1 PË. Kjo është e saktë.

2 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Kjo pyetje u bë dhe u
3 përgjigj disa herë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

5 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ndoshta mund të marrim një
6 përgjigje nga kjo fillimisht.

7 Z. Gjykatës e hodhi poshtë, e rrëzoi kundërshtimin,
8 ndoshta mund të përgjigjeni.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
10 përgjigjet pyetjes.

11 DËSHMITARI: Po, bëjeni pyetjen.

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

13 PY. Nuk mund të testoni dokumentet mbështetëse dhe do të --
14 që ta lexoj pyetjen, që si nuk jeni në gjendje që të shikoni
15 raportet për përmbajtjen e tyre, dhe që të cilat ju i keni,
16 për të cilat ju konfirmuat që ju jeni në gjendje ta bëni. Dhe
17 ju gjithashtu konfirmuat që mund të merrni me mend ato që janë
18 të sakta, të supozoni. Por pyetja që u kundërshtua ishte, ju
19 nuk mund t'i testoni ato.

20 PË. Kjo është e saktë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje nga
22 palët.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

24 Z. TULLY: [Përkthim] Dhe për ne nuk kemi pyetje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 z. Ellis.

2 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

3 Z. ELLIS: [Përkthim]

4 PY. Quhem z. Ellis dhe po përfaqësoj të pandehurin e katërt,
5 z. Jakup Krasniqi. Nuk dua të hyj, të trajtoj tema të tjera që
6 ju shpjeguat gjatë ditës së sotme. Dua t'ju pyes lidhur me, do
7 ju bëj disa pyetje të kufizuara lidhur me dy çështje. E para
8 ka të bëjë me probabilitetin --

9 PË. Po.

10 PY. -- dhe e dyta ka të bëjë me rregullimet sa i takon
11 nënstrukturës së popullsisë.

12 PË. Po.

13 PY. Sa i takon probabiliteteve, a ju kam kuptuar saktë që
14 raportet e ADN-së kur ne shohim përfundimin e shprehur në
15 përqindje, reflekton, pasqyron një kombinim të shkallës së
16 gjasave me probabilitetin e mëparshëm?

17 PË. E saktë.

18 PY. Dhe siç e shpjeguat, mendoj në raportin e parë, se në
19 qoftë se kemi qindra, njëqind persona të vrarë, themi në një
20 avion që rrëzohet, pastaj atëherë probabiliteti i mëparshëm që
21 mbetjet konkrete të përputhen me një person të caktuar, do të
22 jetë 1 në 100?

23 PË. Për t'u përgjigjur thjesht, po.

24 PY. Dhe supozimi juaj do të ishte në një situatë pas
25 konfliktit se mund të bazohemi në probabilitetet e mëparshme

1 bazuar në numrin e përafërt të personave të zhdukur --

2 PË. Po.

3 PY. -- nga konflikti, pra është ajo?

4 PË. Kjo do të jetë, pra kjo do të ishte praktika e zakonshme.

5 PY. Në terma të thjeshtë, sa më shumë persona të zhdukur që

6 kemi aq më e ulët është probabiliteti i mëparshëm.

7 PË. Po. Saktë.

8 PY. Dhe së fundmi, dhe kjo do të rezultonte në një përqindje

9 më të ulët të përfundimeve që shprehen.

10 PË. E saktë.

11 PY. Dhe për të përcaktuar probabilitetin e mëparshëm është

12 diçka që duhet të bazohet në informacione faktike lidhur me

13 konfliktin. Nuk është çështje e ekspertizës së ADN-së.

14 PË. Është, bazohet në, nuk bazohet në ekspertizën e ADN-së

15 dhe po, bazohet në informacionin e ditur gjatë konfliktit dhe

16 skenarët që, me të cilët ju punoni.

17 PY. Dhe në qoftë se mund të nxjerrim një shembull në ekran,

18 ju lutem.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] U15-4164 [Sipas përkthimit].

20 PY. Ajo që shohim këtu është thjesht jep një përqindje të,

21 duke përdorur probabilitetin e mëparshëm.

22 PË. Saktë.

23 PY. Por nuk na, aty ku thuhet se nga buron kjo 1 në 3000, kjo

24 shifër, dhe se si është arritur aty?

25 PË. Saktë.

1 PY. Nëse mund të kalojmë tek një raport tjetër, që duhet të
2 jetë SPOE00072678 në faqen SPOE0072691.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A është me, përfundon
4 me RED apo me RED2?

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Njëri apo tjetri, të dy mund të
6 përdoren. Në qoftë se mund të shohim pjesën e poshtme në
7 mënyrë që të jemi në gjendje të lexojmë përfundimin.

8 PY. A po lexoj saktë, se këtu kemi raportin që përdor, raport
9 ku përdoret probabilitetin e mëparshëm 1 në 3000?

10 PË. E saktë, kështu lexohet kështu.

11 PY. Dhe nuk kemi shpjegim kështu se si është arritur shifra
12 11 -- 1/3000?

13 PË. Nuk e shoh dot as unë.

14 PY. Dhe në fakt bazuar në informacionin që ju është dhënë
15 juve, ju nuk jeni në gjendje të na thoni se si disa prej
16 këtyre raporteve dhe pse disa prej këtyre raporteve kanë
17 përdorur shkallën 1 në 3000 dhe disa në 1 në 1300.

18 PË. Nuk jam i sigurt për kronologjinë e raporteve dhe këtu
19 është praktikë e pranuar që probabilitetet e mëparshme mund të
20 ndryshojnë me zhvillimin e programit të identifikimit dhe që
21 ka, dhe ka më pak persona të zhdukur. Por mund të jetë,
22 supozoj që është informacion i përditësuar dhe apo më
23 konservativ me 3000.

24 PY. Pa dhënë shpjegimin kjo është supozim.

25 PË. Po. Është supozim, absolutisht.

1 PY. Dhe natyrisht në qoftë se 1 në 3000, shifra 1 në 3000
2 është përdorur për këto raporte, atëherë përqindja do të ulet,
3 zvogëlohet, apo jo?

4 PË. Po. Impakti, ndikimi do të jetë i -- do të, në këtë rast
5 të veçantë do të kishte qenë minimal sepse gjasat janë të
6 larta, duhet të ishte ndoshta ndryshim i një, me shifër
7 përqindjeje të 99.9999 për qind. Mund të ndërrojë shumë, shumë
8 pak, lehtë. Mund të jetë 1/9 e tij, por duhet të kishte,
9 ndonjë sipas mendimit tim, ndikim domethënës në këtë rezultat.

10 PY. E kuptoj. Në qoftë se mund të shohim tani dhe një tjetër,
11 ju lutem, që është 110668, deri në 110674, faqja 671. Në këtë
12 shembull mund të shohim se probabiliteti i mëparshëm është
13 lënë në nivelin 0.5, dhe mendoj se e keni diskutuar këtë me
14 Prokurorinë në seancën përgatitore në korrikun e kaluar, 2023,
15 në korrik të 2023. Dhe do ta lexoj një prej gjërave që keni
16 thënë aty.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Për nevojat e procesverbalit është
18 faqja 114018, në paragrafin 6.

19 PY. Dhe ju thoni:

20 "... 0.5 është vlerë e arsyeshme në këtë kontekst duke
21 pasur parasysh rrethanat e zhvarrimit të mbetjeve nga varri."

22 A ju kujtohet që keni dhënë këtë shpjegim?

23 PË. Më duket se e kam thënë.

24 PY. Dhe në këtë rast fakti që kufoma është zhvarrosur nga një
25 varr me emër, zvogëlon mundësitë, probabilitetin e mëparshëm

1 në 0.5 për qind?

2 PË. Po. Në, probabiliteti i mëparshëm 1 në 3000 është
3 supozuar që nuk kishte informacion lidhur me individin, se
4 kush ishte individi, dhe ka qenë komplet i rastësishëm. Ndërsa
5 në rastin kur është bërë identifikimi, kur identifikimi është
6 bërë, është bërë, mund të argumentohet që duhet të jetë 0.5
7 ose pak më ndryshe, do të thoja që është në përputhje me
8 praktikën normale.

9 PY. Pra, natyrisht ju nuk keni informacion lidhur me
10 rrethanat faktike që kanë çuar një, që një kufomë të caktuar
11 në një vendvarrim të caktuar?

12 PË. Jo.

13 PY. Faleminderit. Nuk kam -- dhe pra, në mënyrë, ajo që ndodh
14 me probabilitetin e mëparshëm është se supozimi faktik është
15 futur në, ka qenë pjesë e përllogaritjeve apo jo?

16 PË. Kjo është e saktë.

17 PY. Ju nuk jeni në gjendje sot të verifikoni nëse supozimi
18 faktik është i saktë apo jo?

19 PË. Saktë. Kështu është.

20 PY. Kalojmë te një temë tjetër tani. Sa i takon, pra,
21 nënstrukturës së popullsisë dhe rregullimeve që janë bërë aty,
22 axhustimeve.

23 PË. Po.

24 PY. Në kontekst të kësaj ju shpjeguat në poshtëshënimin, në
25 raportin tuaj të parë, që nuk janë bërë korrigjime të

1 nënstrukturës së popullsisë.

2 PË. E saktë.

3 PY. Dhe ju keni shpjeguar qëndrimin tuaj pak më poshtë, në
4 shënimin përgatitor, dhe dua ta lexoj këtë pjesë:

5 "Korrigjimi për nënstrukturën e popullsisë do të
6 zvogëlonte shifrën në një farë mënyre, pak. Në përgjithësi në
7 një raport identifikimi korrigjimi për nënstrukturën e
8 popullsisë nuk përfshihet. Nga perspektiva e ndjekjes penale,
9 korrigjimi për nënstrukturën e popullsisë do të bëhen në
10 mënyrë më të zakonshme -- do të përfshihej në mënyrë të
11 zakonshme, zakonisht, por kjo ndryshon nga juridiksioni në
12 juridiksion."

13 Ju kujtohet kjo?

14 PË. Po. Kështu e kam kuptuar.

15 PY. Dhe a mund të sqaroni pse nga pikëpamja e ndjekjes
16 penale, nga perspektiva e ndjekjes penale kjo do të zbatohet?

17 PË. Unë do të isha më shumë në anën e, më i kujdesshëm dhe do
18 ta zvogëloja shkallën e gjasave të mundshme, pra.

19 PY. Dhe me sa mund të na thoni ju, pra bazuar në këtë që keni
20 përballë, të gjitha këto raporte që janë siguruar, asnjë në
21 këto raporte, asnjë korrigjim nuk është bërë.

22 PË. Nuk mendoj që është bërë ndonjë korrigjim në këtë kohë,
23 në kohën kur raportet janë bërë, pra. Dhe, këtë nuk e di, nuk
24 e besoj që ata kanë bërë korrigjime, që janë bërë korrigjime
25 të tilla, nuk besoj që kjo bëhet në këtë lloj pune në veçanti.

1 PY. Sepse ka, sepse bëhet fjalë për raporte identifikimi dhe
2 nuk janë raporte penale, kriminale.

3 PË. Pikërisht.

4 PY. E kuptoj. Dhe ju dhatë një shembull sot në mëngjes kur po
5 flisnit për një shembull konkret me z. Pace nga Prokuroria dhe
6 shembulli që ju thatë mendoj që është në transkript në faqen
7 20, kishte efektin që të zvogëlonte shifrën e 216 000 si
8 shkallë e gjasave të mundshme në rreth 15 000.

9 PË. E saktë.

10 PY. Dhe natyrisht ky korrigjim nuk është zbatuar në gjithë 25
11 të tjerët, apo, nuk e di sa kanë qenë saktësisht.

12 PË. Kjo është kështu.

13 PY. Por sikur të ishte zbatuar aty, ne do të shihnim
14 zvogëlimin në të gjitha këto raste.

15 PË. Sigurisht që do të ishte kështu.

16 PY. Faleminderit. Nuk kam më pyetje të tjera.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë pyetje
18 nga ana e Prokurorisë?

19 Z. PACE: [Përkthim] Po, faleminderit. Mund ta heqim
20 dokumentin nga ekrani.

21 Pyetje vijuese nga z. Pace:

22 Z. PACE: [Përkthim]

23 PY. Mirëdita, z. Goodwin.

24 PË. Mirëdita.

25 PY. Në faqen 88, 93 të dokumentit në tre kopjet e sotme ju

1 thatë gjatë marrjes në pyetje nga Mbrojtja e Veselit, në
2 pyetje për komentet e përgjithshme lidhur me një numër
3 dokumente, edhe këto komente të përgjithshme gjenden në
4 transkriptin e sotëm dhe dokumentet e shënuara me numër
5 provizor.

6 Ndërkohë që po shfaqim dokumentin, Avokati bëri një
7 përmbledhje apo parafrazoi në pyetjen e tyre njërin nga faqet
8 që janë shpjeguar, ku janë shpjeguar disa prej aspekteve të
9 raporteve të cilat nuk janë standarde. Ju kujtohen pyetjet?
10 PË. Po, më kujtohet.

11 PY. Pra, kalojmë tek i pari, faqen 103384, dhe faqja tjetër,
12 dhe shohim në krye të faqes, dhe në fund të faqes, në fund të
13 faqes shohim një pjesë ku u përmend, por nuk u lexua dhe këtu
14 shohim:

15 "Elementi kyç i një raporti të ADN-së, elementet kyçe të
16 raportit kanë qenë të pranishëm, por ka disa aspekte që nuk
17 janë standarde ..."

18 Tani, Dëshmitar, ju konfirmuat gjatë marrjes në pyetje
19 nga Mbrojtja këtë pjesë të dytë të kësaj fjalie. Pyetja ime
20 është, nëse pjesa e parë e kësaj fjalie është e saktë, pra që
21 elementët kyç të raportit të ADN-së janë të pranishëm në
22 raportet e ndryshme të ADN-së të cilëve iu referuat?

23 PË. Kur flasim për elementët kyçë, flasim për profilin e ADN-
24 së, për ata që janë të disponueshëm, që zbatohen në,
25 mospërputhja më e madhe me krahasimisht me raportin standard

1 është aspekti i kodimit.

2 PY. Dhe përveç kësaj mospërputhje, ajo që keni thënë këtu, që
3 thatë dhe sot, a është e saktë, pra që elementët kyç në
4 raport të ADN-së janë të pranishëm?

5 PË. Kjo varet. Këto, këto janë raporte përmbledhëse, raporte
6 ku ICPM-ja [Sipas përkthimit] ka bërë punën që i është kërkuar
7 të bëjë dhe kanë informacionet që priteshin nga, mbi të cilat
8 ata duhej të punonin. Pra, profilet janë aty, a janë të
9 koduara apo jo, pavarësisht kësaj, përmbledhja është aty, e
10 koduar apo jo, emrat janë aty, marrëdhënia, ndërlidhja
11 familjare është aty dhe informacioni kyç është aty, por me
12 kujdesin dhe paralajmërimin që kodimi e bën të vështirë të
13 interpretohet dhe të, pa e dekoduar atë.

14 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument.

15 PY. Në faqen 114 të transkriptit të sotëm, Mbrojtja e Veselit
16 ju pyeti lidhur me dokument të cilin do të kërkoj të shfaqet
17 në ekran.

18 Z. PACE: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00668661 [Sipas
19 përkthimit] deri në 0068678, nga dokumentet e paraqitura nga
20 Mbrojtja e z. Veseli. Dhe të kalojmë në faqen e parë të
21 dokumentit që do t'ju tregohet. Tani, pak më poshtë në fund të
22 faqes, ju lutem.

23 PY. A ju kujtohet avokati që vërejti që personi që ka
24 nënshkruar këtë dokument ishte antropolog i forensikës?

25 PË. Po.

1 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se mund të zmadhojmë pjesën
2 e nënshkrimit, ju lutem.

3 PY. E shikoni që ai ka nënshkruar si kryetari apo shefi i
4 zyrës së personave të zhdukur?

5 PË. Po.

6 PY. Në qoftë se lexojmë paragrafin paraardhës, pararendës të,
7 mbi nënshkrimin, lexon:

8 "Zyra për Personat e Zhdukur dhe Forensikës, ka krahasuar
9 informacionet para dhe pas vdekjes dhe rezultatet
10 bashkëpunojnë me të sipërmen."

11 Pra, ndoshta këtu duhet të thonim "mbështesin" dhe jo
12 "bashkëpunojnë".

13 PË. Saktë, kështu është. Është më logjike.

14 PY. Dhe sipër është analiza e ADN-së që janë të përmbledhura
15 aty.

16 PË. ADN-ja besoj është antropologji. Bëhet fjalë për të
17 dhënat e përgjithshme para dhe pas vdekjes.

18 PY. Tani ju si ekspert i gjenetikës forensike sipas asaj që,
19 njohurisë tuaj, është një krahasim i tillë përpara dhe pas
20 vdekjes, pra informacioni, informacioni i tillë para dhe pas
21 vdekjes dhe rezultateve të ADN-së, diçka që pritet të bëhet në
22 një raport identifikimi?

23 PË. Në një situatë ideale, të gjithë informacioni i vlefshëm
24 duhet të përdoret për të krijuar një mendim, opinion të
25 identifikimit dhe kjo do të përfshinte të dhëna përpara, pas

1 vdekjes, rrethanore, çdo informacion që konsiderohet,
2 vlerësohet si provë, do të ishte një situatë ideale i
3 përfshirë në vlerësim.

4 PY. Faleminderit. Nuk kam më pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
6 Barthe.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
8 Smith.

9 Pyetje nga Trupi Gjykses:

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Trupi Gjykses ka disa pyetje
11 për të kuptuar më mirë dëshminë tuaj. Pyetja ime e parë është:
12 Besoj që ju njihni punën e Komisionit Ndërkombëtar për
13 Personat e Zhdukur?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund t'ju kërkoj të jepni
16 një koment të përgjithshëm mbi punën e Komisionit për Personat
17 e Zhdukur dhe analizën e tyre gjenetike dhe metodologjinë e
18 përdorur?

19 PË. Po. Ata janë krijuar në fund të viteve 1990 si përgjigje
20 ndaj konfliktit në Ballkan. Janë bërë operacionalë, pra, në
21 fillim të viteve 2000, janë pionierë të përdorimit të
22 identifikimit përmes ADN-së në këto lloj pune. Përpara kësaj
23 kjo bëhej vetëm, përdorimi i ADN-së bëhej vetëm për të --
24 testimi përmes ADN-së bëhej vetëm për identifikim. Ata janë të
25 parët, pra, në veçanti që kanë përdorur këtë në kontekst pas

1 konfliktit si për identifikimin e viktimave në konflikte apo
2 në raste të tjera fatkeqësish të mëdha. Kjo përbënte,
3 paraqiste shumë sfida.

4 Pra janë organizatë që gëzojnë respekt të madh, kanë bërë
5 publikime të shumta dhe ne të tjerët i ndjekim ata kur bëjmë
6 nxjerrjen e kampioneve të ADN-së nga eshtrat për të bërë
7 krahasime të profileve të ADN-së nga kampione eshtrash si
8 referencë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Goodwin. E
10 kuptoj rezervat që ju keni shprehur lidhur me atë që ju mund
11 të thoni apo mund të mos thoni lidhur me ekzaminimet
12 individuale të ADN-së, por gjatë përgatitjes së raporteve
13 tuaja keni patur, dhe a keni, kishit ndonjë dyshim lidhur me
14 standardet dhe metodat e përdorur nga ICMP-ja në raportet e
15 tyre përkatëse?

16 PË. Në përgjithësi jo, në përgjithësi do të thoja që ata kanë
17 standarde të mirëvendosura për sa i përket metodologjisë së
18 përdorur në këto lloj pune. Jo vetëm këtë. Ka laboratore të
19 tjera, nuk janë vetëm këta në gjithë botën. Si për shembull në
20 Forcat Ushtarake të Amerikës, Laboratori për Identifikim i
21 cili ka krijuar edhe precedentë në mënyrën se si të përdoret
22 ADN-ja për qëllime identifikimi dhe, sigurisht, sa i takon
23 proceseve, nuk kam arsye që të vë në pikëpyetje atë që ata
24 bëjnë dhe mënyrën se si e bëjnë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe a keni

1 ndonjë informacion sa i takon të metave, mangësive apo
2 mospërputhjeve në analizat e kampioneve të ADN-së që do të
3 ndikonin në përfundimet e ICMP-së, dhe në qoftë se keni, a
4 mund t'ju bëj një pyetje të -- mund të përbëjë ndonjë
5 përmbledhje të këtyre?

6 PË. Nuk kam.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam më
8 pyetje.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirëdita, a mund të na
11 ndihmoni ta kuptojmë edhe më mirë dëshminë që keni dhënë
12 lidhur me vlerat alelike apo përcaktimet alelike?

13 Besoj se ju thatë se vlerat të llojit 4.9 janë shumë herë
14 më të rralla se sa vlerat 4.0, 4.1, apo jo?

15 PË. Po, 4.9 si rregull nuk ekziston. 4.0 ekziston.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po pse?

17 PË. Sepse nëse do të kishim një alel me vlerë 4, do t'i
18 shtonim një bazë tjetër, do kishim 4.1, dhe t'i shtonim dy
19 baza, do të kapte vlerën 4.2, dhe kështu me radhë. Por shkon
20 deri në tek baza 3. Nuk kalon asnjëherë bazën e 3-të.
21 Përndryshe do të kishim përsëritje të vlerave Penta.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa u takon tabelave të të
23 dhënave që pamë më herët.

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pamë një shembull, për

1 shembull, ku vlerat alelike 7.9, dhe 4.9, shfaqeshin në këtë
2 tabelë, si ka mundësi? A mund të ndodhë kjo?

3 PË. Unë për këtë mendoj që është kodim. Besoj që nuk janë
4 alelet e sakta, por janë koduar.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ta shohim më konkretisht
6 përmes një dokumentit.

7 I lutem Sekretarisë së seancës të nxjerrë në ekran
8 materialin me numër SPOE00291803.

9 Besoj se në këtë kampionim këtu shohim vlerën tek ICMP 3,
10 shohim 7.6 [Sipas përkthimit] dhe tek 13, ICMP 13, shohim
11 vlerën 4.9.

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në këtë kampionim konkret
14 shohim, pra, dy vlerat. Vlerën 7.9 dhe vlerën 4.9. Ju po më
15 thoni që kjo s'është e mundshme?

16 PË. Nuk është, ky është profil i koduar, nuk është profil
17 STR-je, jam i bindur që është i koduar.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa i takon kodimit, pse
19 duhet të kodohen vlerat alelike? Unë e kuptoj që duhen fshehur
20 emrat e personave, datëlindjet, të dhënat personale, por pse
21 duhen fshehur vlerat alelike?

22 PË. Në mënyrë që profili i ADN-së të mos përdoret për qëllime
23 që nuk lidhen me identifikimin. Për shembull, të gjendet
24 atësia, mëmësia, pra, apo të gjenden lidhje mes personave në
25 procesin e identifikimit me faktorë të tjerë.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në të dhënat që po shohim
2 ne, rreshti lart flet për kampionimin e personit të vdekur,
3 apo jo?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe më pas janë kampionimet
6 që janë marrë nga personat e afërm, apo jo? Që janë ende,
7 jetojnë ende?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani tek kampionimi për
10 personat që jetojnë ende, shohim vlerat 7.9, për tre syresh,
11 dhe 4.9 për katër syresh.

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të na shpjegoni pak
14 këtë?

15 PË. Unë thjesht po supozoj këtu, por unë besoj se kur --
16 tani, kodi për alelen STR është i njëjti. Në fakt do të doja
17 ta vizatoja sepse mund t'ju ndihmoja më shumë.

18 Pra, ju thatë 7.9. Shohim dhe 7.6 dhe 7.9. Këto janë dy
19 alelet. Një nga këto alele domosdoshmërisht është i
20 trashëguar. Këtu kemi 7.6 poshtë prapë. Edhe më poshtë shohim
21 7.9. Për secilën -- më falni një sekondë ta fshij këtë.

22 Pra, çfarë mendoj unë se ka ndodhur në këtë rast, prapë
23 supozim, e theksoj këtë, është që për çdo rast kur kemi një
24 vlerë alelike të ICMP 3, kur e ka kodimin 7.6, ky kodim mbetet
25 i njëjti për këtë rast, jo nga një rast tek tjetri, por për

1 këtë rast mbetet e njëjta vlerë. Pra, nëse vlera alelike është
2 7.6, mbetet me vlerën 7.6.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, ju po thoni që vlera e
4 vërtetë alelike nuk është vendosur në këtë tabelë as për
5 personin e vdekur dhe as për personat që jetojnë ende?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E kuptoj. Shohim pjesën e
8 përfundimeve.

9 I lutem Sekretares -- më falni, keni diçka për të thënë?

10 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
11 këshillohen]

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Fillimisht ruajmë materialin
13 që shënoi eksperti dhe t'i japim numrin provizor.

14 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
15 këshillohen]

16 DËSHMITARI: Më lejoni të shtoj diçka. Nëse shikojmë
17 gjenotipin e bashkëshortes, do ta shihni që për bashkëshorten
18 vlera është 8.7. Po ashtu edhe djali edhe vajza e kanë vlerën
19 8.7, sepse si rregull fëmijët kanë alelet e dy prindërve.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po vlera 8.7, a është e
21 pazakontë?

22 PË. Vlera 8.7 në këtë rast nuk i referohet aleles STR dhe
23 normal, është normale në këtë rast. Prandaj po them që nuk e
24 di a është kjo një vlerë e koduar.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Shohim më poshtë

1 te pjesa e përfundimeve. Thuhet që:

2 "Probabiliteti i lidhjes farefisnore siç përshkruhet në
3 këtë raport është më i lartë se 99 për qind, pra është një
4 shkallë shumë e lartë probabiliteti."

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Që ta kuptojmë ne sa më
7 mirë, ky përfundim kur kemi një probabilitet shumë të lartë,
8 është bazuar në vlera alelike që në fakt nuk janë pasqyruar në
9 dokumentin që ne shohim?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, në thelb ne po i
12 besojmë ICMP-së, KNP-së pra, Komisionit, ekspertëve të
13 Komisionit, dhe ne mendojmë që ata e kanë kryer punën siç
14 duhet. Dhe kanë dalë në këto përfundime. Por ne nuk po
15 mbështetemi në shifrat që shohim.

16 PË. Po. Ne duhet të bazohemi në përfundimet e tyre -- nuk
17 mund t'i vlerësojmë të dhënat për të thënë a pajtohemi apo jo,
18 duhet t'u besojmë asaj që kanë nxjerrë ekspertët. Ta marrim
19 për të mirëqenë.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në fakt këto ishin pjesa më
21 e madhe e pyetjeve të mia, por kam dhe diçka të fundit. Vlerat
22 alelike a ndryshojnë nga saponizimi apo nga dëmtimet që i
23 kryhet, që pësojnë eshtrat? Degradimi pra, i materialit?

24 PË. Vlerat alelike nuk ndryshojnë. Mund të ndryshojë fakti a
25 e përcaktojmë dot çfarë është aleli në këtë rast, por vlera

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: William Goodwin (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 146

1 alelike nuk ndryshon.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni ndonjë dijeni nëse
3 personelit të KNPH-së që ka punuar për këtë raport e ka pasur
4 përvojë me Bosnjën?

5 PË. Me sa kuptoj unë, ata kanë punuar dhe në Bosnjë. Dhe
6 laboratorët e KNPH-së në fakt ishin të vendosura në Bosnjë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Nuk ka përkthim].

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka pyetje
9 të tjera?

10 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
11 këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëhet fjalë
13 për materialin 00291803? Ky material duhet të marrë një numër
14 provizor?

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju faleminderit.
16 Materiali me shënimet që bëri dëshmitari W4875 përndryshe
17 dokumenti SPOE00291803, do të marrin numrin e Zyrës
18 Administrative REG01198, dhe merr numrin provizor c00001.
19 Klasifikimi është konfidencial.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
21 Ka pyetje vijuese nga Prokurori?

22 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj. Rowan:

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

24 PY. Z. Goodwin, kam dy pyetje të shkurtra që burojnë nga
25 pyetjet e Gjykatësve.

1 E para lidhet me një pyetje që bëri Gjykatësi Barthe në
2 fillim, kur ju pyeti nëse keni parë ndonjë defekt, mangësi,
3 mospërputhshmëri në këto raporte. Ju kujtohet pyetja?

4 PË. Po.

5 PY. A pajtoheni me mua se duke mos pasur EPG-të ju nuk jeni
6 në gjendje të konfirmoni se rezultatet e përfundimet nuk kanë
7 mangësi, defekte apo mospërputhshmëri për këto raporte, sepse
8 ju nuk mund ta verifikoni materialin?

9 PË. Absolutisht po. Unë nuk po them që ka diçka të gabuar në
10 pamje të parë, por pajtohem me ju, unë do më duhet të shikoja
11 EPG-të dhe të thoja nëse raportet janë korrekte.

12 PY. Po pra. Ju thoni që në pamje të parë s'ka mangësi, por ju
13 s'mund ta konfirmoni këtë?

14 PË. Jo në bazë të të dhënave që kam.

15 PY. Ju bëri disa pyetje Gjykatësi Gaynor, po ashtu për
16 raportet që kemi parë në ekran.

17 Dua të flasim për një nga përgjigjet që dhatë ju. Ju
18 thatë se jeni i bindur se profilet janë të koduara.

19 PË. Po.

20 PY. Të flasim për këtë. Pra, ju mund të jeni i sigurt, edhe
21 siguria është shumë e rëndësishme të paktën në fushën tonë
22 tani, në një proces gjyqësor, pra ju mund të jeni i sigurt që
23 shifrat që shohim të pasqyruara në raporte nuk mund të jenë
24 përcaktime alelike. Për këtë jeni i sigurt, apo jo?

25 PË. Po. Me të drejtë.

1 PY. Pra, për këtë jemi 100 për qind të sigurt që një vlerë
2 4.9 nuk mund të jetë një përcaktim alelik?

3 PË. Saktë.

4 PY. Ju besoni se shpjegimi për këtë është se ky është një --
5 kjo është një shifër e koduar?

6 PË. Po.

7 PY. Pra, ju nuk jeni i sigurt për kodimin, por ju besoni se
8 ky është shpjegimi më i logjikshëm për një vlerë të këtillë që
9 nuk mund të jetë vlerë alelike.

10 PË. Po.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

12 Tavakoli? Keni pyetje?

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

15 Z. TULLY: [Përkthim] Jo.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
19 e përfunduat dëshminë tuaj. Faleminderit që erdhët, që ndatë
20 informatat. Tani mund të largoheni nga salla e gjyqit bashkë
21 me Sekretaren dhe ju urojmë gjithë të mirat në të ardhmen.

22 DËSHMITARI: Ju faleminderit të gjithëve.

23 [Dëshmitari largohet]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,

25 besoj se në shënimin përgatitor i kishit përfshirë të gjitha

1 provat materiale që synonit, që donit që të pranoheshin,
2 kështu?

3 Z. PACE: [Përkthim] Po. Shtojca 1, shënimi përgatitor,
4 përmban të gjitha provat materiale që ne duam të pranohen,
5 përfshirë dhe materialet që morën numrat provizorë sot. Edhe
6 do të donim të shtonim edhe që kemi vendosur faqet përkatëse
7 të këtyre materialeve.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
9 kundërshtime?

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po, kemi shumë kundërshtime.

11 Ne kemi shkruar kolektivisht si ekipe të Mbrojtjes për
12 këtë më përpara.

13 Do të doja që të na jepni mundësinë që të përgjigjemi me
14 shkrim për secilin nga materialet individuale dhe më pas ju si
15 Trup Gjykses mund të merrni vendim përkatës. Ju lutem, ta
16 merrni parasysh kërkesën tonë duke marrë parasysh çfarë
17 dëgjuam në dëshminë e dëshmitarit sot. Sigurisht kjo nuk do
18 ketë asnjë ndikim në dëshmitë e ardhshme. Nuk do vonojë fare
19 procesin gjyqësor.

20 Z. PACE: [Përkthim] Sikurse e dini, Mbrojtja e ka pasur
21 mundësinë që të komentojë lidhur me pranueshmërinë e këtyre
22 materialeve, vendimi i Trupit Gjykses ka dalë, nuk thotë që
23 pasi Mbrojtja të bëjë parashtrime të mëtejshme, por thotë pasi
24 të përfundojmë pyetjet për këtë dëshmitar. Kështu që, nëse
25 kishte ndonjë informacion që Avokatja donte ta nxirrte nga

1 dëshmitari sa i takon pranueshmërisë së këtyre materialeve,
2 mund ta kishte bërë këtë gjatë kohës që kishim dëshmitarin.

3 Tani kjo kërkesë është e tejkaluar.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shkurtimisht. Ne jemi të ndaluar
5 shprehimisht që të komentojmë apo të bëjmë parashtime gjatë
6 kohës që i bëjmë dëshmitarit pyetje për dokumentet në fjalë.
7 Pra, deri tani nuk kemi qenë në pozicion të komentojmë për
8 dokumentet, por kemi qenë në pozicion sot të përcaktojmë
9 faktet që burojnë nga dëshmia e këtij dëshmitari. Dhe kjo
10 është ajo që na lejohet. Dhe ne tani duhet të kemi mundësinë
11 të komentojmë për faktet dhe provat që janë paraqitur para
12 këtij Trupi Gjykses.

13 Të na jepet mundësia të diskutojmë lidhur me
14 pranueshmërinë e dëshmisë së këtij dëshmitari pasi përfundoi
15 dëshminë, dhe ne patëm mundësinë t'i bënim pyetje. Nuk ka
16 asnjë pengesë, nuk do vonohet procesi gjyqësor, nuk ka pse të
17 mos i jepet mundësia ekipeve të Mbrojtjes që t'u përgjigjet
18 materialeve, të përgjigjet lidhur me këto materiale, sepse ky
19 është i vetmi ekspert ADN-je që ne kemi në këtë lëndë
20 gjyqësore.

21 Z. PACE: [Përkthim] Më duket se Mbrojtja ka harruar që ka
22 dorëzuar një material ku kishin shprehur kundërshtimet për të
23 gjitha materialet në fjalë, dhe kishin një kod që përdorëm për
24 të gjitha këto kundërshtim, dhe kjo është e shpjeguar gjatë e
25 gjerë në shtojcën përkatëse.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Pajtohem me znj. Rowan. Janë kërkuar
2 shumë dokumente që të pranohen. Dhe duke marrë parasysh që
3 dëshminë e kemi dëgjuar sot, ne mendojmë që mënyra më e drejtë
4 për ta trajtuar këtë, duke marrë parasysh se kemi edhe fakte
5 dhe parashtrime ligjore është e nevojshme që të jepet mundësia
6 që ne të komentojmë të paktën për disa nga dokumentet. Edhe
7 unë mendoj që është e drejtë që të na jepet mundësia të
8 përgjigjemi me shkrim.

9 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Sapo më kujtuan dhe më thanë se
10 kur është dëgjuar një ekspert ADN-je në një nga lëndët e tjera
11 gjyqësore përpara kësaj Gjykate, ekipit të Mbrojtjes në atë
12 rast iu dha mundësia të përgjigjej me shkrim. Pra, është
13 praktikë e vetë kësaj Gjykate sepse konkretisht është lejuar
14 kjo gjë në çështjen e z. Shala.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mbështes edhe unë kolegen time,
16 edhe mendoj që ka një arsye sepse ju nuk keni vendosur ende
17 lidhur me pranueshmërinë e këtyre provave materiale. Dhe
18 mendoj që znj. Rowan dha arsye të vlefshme dhe ne po ashtu
19 gjykojmë që ne duhet të përgjigjemi me shkrim dhe më pas ju të
20 merrni vendimin tuaj.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë një
22 pushim të shkurtër tani dhe do kthehemi për t'ju dhënë
23 përgjigje në lidhje me këtë.

24 Pra, 15 minuta pushim.

25 --- Seanca ndërpritet në orën 15.16

1 --- Seanca rifillon në orën 15.28

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta lejojmë
3 ekipin e Mbrojtjes së z. Veseli që të dorëzojnë një parashtrim
4 me shkrim plotësues brenda të premtes. Ju lutem, mos
5 përsërisni informacionet që keni pasur në parashtrimin e
6 mëhershëm, por thjesht shtoni informacionet e reja që kanë
7 dalë sot. ZPS-ja mund të përgjigjet të hënën, s'kam ndonjë gjë
8 më shumë për të shtuar.

9 Seanca mbyllet këtu. Shihemi nesër në orën 9.00.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] E keni fjalën për të gjitha ekipet?
11 E keni fjalën vetëm për ekipin e z. Veseli, apo për të gjitha
12 ekipet e Mbrojtjes? Se ju fjalë për fjalë thatë do lejojmë
13 ekipin e Mbrojtjes së z. Veseli, por dhe ne kemi parashtrime
14 për të bërë lidhur me këtë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju thatë fjalë për fjalë, do lejojmë
17 ekipin e Mbrojtjes së Veselit të dorëzojë materialet brenda së
18 premtes.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Do ta bëjmë, po.

21 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, a mund të na e caktoni
22 afatin për të premtën në orën 16.00 në mënyrë që ta marrim ne
23 brenda orës, para orës 16.00 dhe të punojmë me materialin?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Nuk kam gjë tjetër për të thënë. Shihemi nesër.

1 --- Seanca përfundon në orën 15.30

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25